



CENTRAL BANKING AUTHORITY OF KOSOVO
AUTORITETI QENDROR BANKAR I KOSOVËS
CENTRALNI BANKARSKI AUTORITET KOSOVA

RAPORT VJETOR

2006

AQBK
RAPORT
VJETOR

Prishtinë
Qershor
2007

PËRMBAJTJA

Fjala Përshëndetëse e Drejtorit të Përgjithshëm drejtuar PSSP-së dhe Kryetarit të Kosovës	1
Anëtarët e Bordit Drejtues, Komitetit të Auditimit dhe Komitetit Ekzekutiv	3
Struktura organizative e AQBK- së (më 31 dhjetor 2006)	4
1. Përmbledhje ekzekutive	5
2. Mjedisi i jashtëm ekonomik	8
2.1. Ekonomia botërore	8
2.2. Bashkimi evropian	9
2.3. Evropa Jug-Lindore	10
3. Ekonomia e Kosovës	15
3.1. Sektori Real	17
3.1.1. Produkti i Brendshëm Bruto	17
3.1.2. Çmimet	19
3.1.3. Papunësia	19
3.1.4. Privatizimi	21
3.2. Sektori Fiskal	21
3.2.1. Të ardhurat buxhetore	22
3.2.2. Shpenzimet buxhetore	23
3.2.3. Skema Pensionale	25
3.3. Sektori Financiar	25
3.3.1. Karakteristikat e Përgjithshme	25
3.3.2. Zhvillimet ne Sektorin Bankar	27
3.3.3. Zhvillimet në Kompanitë e Sigurimeve	41

PËRMBAJTJA

3.3.4. Zhvillimet ne Fondet Pensionale -----	41
3.3.5. Zhvillimet në Ndërmjetësuesit e Tjerë Financiar -----	42
3.4. Sektori i Jashtëm -----	43
4. Mbikëqyrja Financiare -----	48
4.1. Veprimtaria Rregullative e Sektorit Financiar -----	48
4.2. Licencimi dhe Struktura-----	49
4.3. Veprimtaria e Mbikëqyrjes Financiare-----	52
4.4. Veprimet detyruese -----	56
5. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun -----	57
5.1. Operacionet dhe Menaxhimi i Parave të Gatshme-----	57
5.2. Shërbimet e siguruara për Thesarin -----	62
5.3. Menaxhimi i mjeteve financiare -----	63
5.4. Shërbimet për Komunitetin Financiar -----	64
5.4.1. Sistemi i Pagesave -----	64
5.4.2. Kos-Giro-----	67
5.4.3. Regjistri i Krediteve të Kosovës -----	68
5.5. Aktivitet kërkimore dhe statistikore -----	69
6. Zhvillimet e brendshme -----	70
6.1. Rregullorja e re për AQBK-në-----	70
6.2. Projekti i ngritjes së sigurisë fizike-----	71
6.3. Qeverisja dhe kontrolli i brendshëm -----	71
6.4. Zhvillimi i burimeve njerëzore -----	73

PËRMBAJTJA

6.5. Ngritja strukturës organizative të AQBK-së gjatë vitit 2006-----	73
7. Pasqyrat financiare të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës-----	74
8. Shtojca Statistike-----	108

LISTË E FIGURAVE

1. Inflacioni (ndryshimi në IHÇK vjetore) në Euro-zonë -----	9
2. PBB-ja reale e Kosovës -----	17
3. PBB-ja reale e Kosovës, sipas përbërësve -----	18
4. Investimet si pjesëmarrje e PBB-së në EJL -----	18
5. Inflacioni, mesatarja vjetore -----	19
6. Numri i punëkërkesve të ri të regjistruar sipas grupmoshave -----	20
7. Buxheti i konsoliduar i Kosovës -----	22
8. Struktura e shpenzimeve të BKK -----	23
9. Struktura e shpenzimeve të BKK -----	24
10. Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) -----	25
11. e sektorit financiar në Kosovë (duke përjashtuar AQBK-në) -----	26
12. Kërkesat neto të Korporatave Financiare -----	27
13. Bankat komerciale Indeksi i Herfindahl-Hirschman -----	29
14. Rritja e kredive vit-më-vit -----	31
15. Struktura e kredive dhe depozitave me afat sipas maturitetit -----	32
16. Raporti i Kredive ndaj Depozitave -----	33
17. Asetet, kreditë dhe depozitat totale të sektorit bankar në SEE, si % ndaj PBB-së -----	34
18. Mesatarja e normave efektive të interesit mbi kreditë dhe depozitat -----	35
19. Neto të ardhurat e Bankave Komerciale -----	36
20. Treguesit e Profitabilitetit në SEE* -----	37
21. Treguesit e efikasitetit në SEE -----	38
22. Raportet e Likuiditetit dhe te Aftësisë Paguese -----	39
23. Raporti i kredive ndaj depozitave në SEE -----	40

LISTË E FIGURAVE

24. Aktivitetet e huadhënies të ndërmjetësive tjera financiare -----	43
25. Eksportet dhe Importet sipas grupmallrave -----	45
26. Eksportet dhe Importet sipas shteteve -----	46
27. Furnizimi me kartëmonedha euro (numri i denominimeve)-----	57
28. Furnizimi me monedha euro (numri i denominimeve) -----	58
29. Kartëmonedhat euro të pranuara (numri i denominimeve)-----	59
30. Monedhat euro të pranuara (numri i denominimeve)-----	59
31. Kartëmonedhat e vjetërsuara të hequra nga qarkullimi (2006 kunder. 2005) -----	60
32. Raporti i furnizimit të kartëmonedhave të reja euro me furnizimin gjithsej në 2006 -----	61
33. Furnizimi me kartëmonedha të reja (2006 perkunder 2005) -----	61
34. Evoluimi i depozitave të Thesarit dhe IPVQ-ve të tjera dhe të AKM-së -----	62
35. Vëllimi dhe vlera vjetore e transaksioneve të SKN-së -----	64
36. Vëllimi dhe vlera mesatare ditore e transaksioneve të SKN-së-----	65
37. Vëllimi vjetor i transaksioneve të SKN-së sipas llojeve të tyre-----	65
38. Vlera vjetore e transaksioneve të SKN-së sipas llojeve të tyre -----	66
39. Vëllimi dhe vlera vjetore e transaksioneve të SKN-së: Neto me Bruto -----	67

LISTË E TABELAVE

1. Indikatorët kryesor makroekonomik në EJL -----	10
2. Investimet e huaja të drejtpërdrejta, neto -----	11
3. Bilanci i buxhetit vjetor dhe bilanci i Llogarisë Rrjedhëse-----	12
4. Treguesit kryesor makroekonomik në Kosovë -----	16
5. Struktura e pronësisë së mjeteve të sektorit bankar -----	28
6. Bilanci i gjendjes së bankave komerciale -----	30
7. Treguesit e performancës së bankave -----	37
8. Kreditë e pa arkëtuara si përqindje e totalit të kredive -----	39
9. Struktura e kapitalit të aseteve të sektorit të sigurimeve -----	41
10. Bilanci i Pagesave të Kosovës-----	44
11. Aktiviteti i Licensimit të Bankave -----	50
12. Aktiviteti i Licensimit të Institucioneve Jo Bankare Financiare -----	50
13. Aktiviteti i Licensimit të Agjensioeneve të Transferit të Parave-----	50
14. Aktivitetet e Licensimit të Zyreve të Këmbimit të Valutave-----	51
15. Veprimtaria e licencimit të kompanive të sigurimit-----	51
16. Veprimtaria e licencimit të ndërmjetësve të sigurimit -----	51
17. Veprimtaria e licencimit të fondeve pensionale -----	52
18. Mbikëqyrja Bankare: Ekzaminimet në vend -----	54
19. Mbikëqyrja e Sigurimeve: Ekzaminimi i kryer në vend -----	55
20. Mbikëqyrja e pensioneve: Ekzaminimi në vend -----	56

LISTË E KUTIVE

1. Asetet, kreditë dhe depozitat e sektorit bankar si përqindje të PBB-së në shtetet SEE -----	34
2. Profitabiliteti i sektorit bankar në shtete të zgjedhura të SEE-se-----	37
3. Efikasiteti i Sektorit Bankar në shtete të zgjedhura të SEE-se -----	38
4. Likuiditeti dhe RMK (CAR) të sektorit bankar në shtete të zgjedhura të SEE-së -----	40
5. Fondet e Pensioneve të cilat veprojnë në Kosovë dhe ndarja e tyre -----	42
6. Likuidimi i Bankës Kreditore të Prishtinës (BKP) -----	56

LISTË E SHKURTESAVE

AER	Agjencia Evropiane për Rindërtim
AQBK	Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës
ATK	Agjencia e Trustit të Kosovës
ATM	Bankomat
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BKP	Banka Kreditore e Prishtinës
BQE	Banka Qendrore Evropiane
EJL	Evropa Juglindore
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
EUR	Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimit të Konsumit
IHÇK	Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IHH	Indeksi Herfindalf – Hirschman
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes
IRJM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
KD	Korporatat Depozituese
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KF	Korporatat Financiare
KR	Kompanitë e reja

LISTË E SHKURTESAVE

KTD	Korporata te Tjera Depozituese
KTF	Korporata te Tjera Financiare
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MM	Memorandumi i Mirëkuptimit
MTL	Marrëveshje e Tregut te Lire
MTLEQ	Marrëveshjet e Tregut te Lire te Evropës Qendrore
NP	Ndërmarrjet Publike
NSH	Ndërmarrjet Shoqërore
NTF	Ndërmjetësuesit e Tjerë Financiar
NJIFV	Njësia Investiguese e Falsifikimit te Valutës
OJSHEF	Organizata Jo fitimprurëse ne Shërbim te Ekonomive Familjare
ONMP	Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrjes se Pensioneve
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit te Përgjithshëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PSH	Pikat e Shitjes
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, SH. A.
RKK	Regjistri i Kredive te Kosovës
SNK	Sistemi Ndër-bankar i Kleringut
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale te Kosovës
TPL	Përgjegjësitë e Palës se Trete
UNMIK	Misioni i Kombeve te Bashkuara ne Kosovë
V-n-V	Vit në Vit

I nderuari zoti Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara,
I nderuari zoti President i Kosovës,

Sektori financiar i Kosovës sërish ka arritur përparim të vërtetë në ofrimin e shërbimeve financiare, duke mbështetur në këtë mënyrë zhvillimin e vazhdueshëm ekonomik dhe shtytjen drejt ekonomisë së tregut. Në vitin 2006, sikur në vitet paraprake, sektori financiar shënoi ngritje të cilësisë dhe vëllimit të ofertës drejt akterëve ekonomik, duke ngritur Kosovën në një nivel përkatës me vendet fqinje. Edhe pse zhvillimi ekonomik është i pamjaftueshëm për të adresuar sfidat me të cilat Kosova po përballet, sektori financiar vë në dispozicion një ofertë themelore për mbështetje të projekteve të ekonomive familiare dhe kompanive.

Në këtë vështrim, sektori financiar duhet të konsiderohet si një nga pasuritë e Kosovës.

Pas një norme të ultë të rritjes së PBB-së në vitin 2005 (përfundimisht e vlerësuar si 0.3%), aktiviteti ekonomik u përmirësua në vitin 2006, me një rritje reale të PBB-së, aktualisht të vlerësuar në shkallë prej 3%. Natyrisht, niveli i rritjes ekonomike duhet të forcohet në mënyrë që të tejkaloj rritjen demografike dhe sfidat e vështira që Kosova ka përpara vetes; sidoqoftë, është pozitive që në vitin 2006, përkundër ndikimit negativ të zvogëlimit të ndihmës nga ana e donatorëve dhe linjave kreditore investive të pashpenzuara nga buxheti i Kosovës, PBB-ja është rritur duke iu falenderuar kontributit të sektorit privat.

Aktiviteti kreditor i bankave komerciale ishte akoma i lartë edhe në vitin 2006, kështuqë me rritjen gjithsej të kredive për 24% solli raportin e gjithsej kredive ndaj PBB-së në 27%, që është nivel shumë më i lartë se në shumë vende fqinje. Kërkesat për kredi shfaqin një lëvizje të vogël nga financimi për importe në drejtim të financimit për pajisje.

Sidoqoftë, edhe pse akoma kemi një ofertë të vogël për nevoja afatgjate dhe një kosto relativisht të lartë të kredisë, duhet të theksohet se projektet e mira bankare si dhe iniciativat nga ndërmarrësit në sektorët me vlerë të shtuar, janë ende të pakta. Për më tepër, do të ishte iluzion të mbështetemi kryesisht në zgjidhjen e statusit të Kosovës për tërheqjen e investitorëve të huaj, dhe se në të njëjtën kohë duhet punuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe imazhit ndërkombëtar për Kosovën. Me fjalë të tjera, një ngritje e komponenteve të ndryshme të mjedisit të biznesit duhet të ecë në hap me efikasitetin e tërësishëm aktual të sistemit financiar.

Me kapacitetet e një banke qendrore dhe autoriteti mbikëqyrës, AQBK-ja është e përcaktuar për të kontribuar pozitivisht në zhvillimin ekonomik, duke forcuar sektorin financiar dhe duke iu ofruar partnerëve të ndryshëm dhe publikut në përgjithësi shërbimet më të mira. Rregullorja e lëshuar më 24 gusht, 2006, i ka siguruar AQBK-së statusin e ri, duke i rritur kompetencat dhe duke krijuar shtegun për ndërrime institucionale. Rregullat prudenciale të aplikueshme në sektorin financiar janë ndryshuar me qëllim të ngritjes së kornizës rregullative dhe kalimit në mbikëqyrje të bazuar në rrezik.

Nga ana praktike, AQBK-ja ka shfaqur gatishmërinë për të shfrytëzuar tërë suazat e autorizimeve të saja për të forcuar rregullativën dhe për të avancuar praktikat profesionale dhe menaxheriale. Kjo ka çuar në atë që Bordi i AQBK-së, në mars të vitit 2006, të revokoj licencën e një banke

komerciale, e cila ende gjendet në procesin e likuidimit. Si rezultat i kompenzimit të shpejtë të depozitave të vogla, efektet e papritura nuk patën ndonjë peshë të madhe për sektorin bankar.

Sa i përket fondeve pensionale, është realizuar një ristrukturim gjithëpërfshirës i institucioneve të specializuara, kryesisht në bashkëpunim të plotë me vetë institucionet, i cili do të sjellë mbylljen e gjashtë fondeve pensionale përbrenda këtyre institucioneve, ku shumica prej tyre duhet transferuar mjetet të siguruesit e përgjithshëm të pensioneve.

Së fundi, AQBK –ja ka zhvilluar një çasje praktike ndaj investitorëve të huaj, në mënyrë që të sjellë akterë të fuqishëm dhe me përvojë, shumicën nga rajoni, për të investuar në sektorin financiar të Kosovës. Në lidhje me këtë, kemi shembullin e një institucioni të madh bankar slloven, i cili bleu dy bankat më të mëdha me pronësi vendore, në çerekun e parë të vitit 2007.

Sa u përket aktiviteteve bankare qendrore, AQBK-ja ka ndërmarrë një varg iniciativash për përmirësimin e shërbimeve të saj ndaj akterëve ekonomik dhe autoriteteve publike. Në veçanti, është forcuar mëtutje funksioni i analizave ekonomike dhe statistikave duke publikuar për herë të parë bilancin e pagesave si dhe studime tjera mbi sektorin financiar të Kosovës; regjistri i ri i krediteve është vënë në funksionim të plotë; informatat mbi pagesat e realizuara nga AQBK-ja janë zgjeruar dhe i janë vënë në dispozicion Thesarit në kohë reale; është realizuar një riparim i tërësishëm i sigurisë së ndërtesës së AQBK-së.

Ndërkombëtarisht, AQBK-ja tashmë ka arritur të përfshihet në organizatat dhe qarqet kryesore profesionale rajonale dhe ndërkombëtare. Tutje, në kontekst të ndërrimeve institucionale në vend, të cilat priten në muajt e ardhshëm, AQBK-ja do t'ia kushtoj mjetet e saj integritit të Kosovës me botën e jashtme, në veçanti në lëminë e njohjes reciproke të polisave të sigurimit, si dhe lidhjeve përkatëse me sistemet kryesore të pagesave.

Ndryshimet e pritura në lidhje me statusin ndërkombëtar të Kosovës, duhet të merren si pasuri dhe si sfidë për sektorin financiar, si dhe për vetë AQBK-në. Si pasuri, sepse integrimi rajonal mund të shpejtohet në të mirë të ekonomisë; si sfidë, sepse pavarësia dhe profesionalizmi i AQBK-së – të ndërtaura duke iu falenderuar ndihmës së madhe financiare dhe teknike të komunitetit ndërkombëtar – duhet jo vetëm mirëmbajtur por edhe forcuar mëtutje. Edhe njëherë, duhet theksuar se kompanitë e huaja dhe akterët financiar do të investojnë në Kosovë vetëm nëse mjedisi i biznesit vlerësohet si i sigurt dhe miqësor, dhe nëse mbikëqyrja financiare dhe aktivitetet bankare qendrore do të realizohen në mënyrë neutrale, të pavarur dhe profesionale.

Në këtë kontekst, kam kënaqësinë, t'ua dorëzoj Raportin Vjetor 2006 të AQBK-së.



Michel Svetchine

Më 31 dhjetor, 2006 Këshilli Drejtues i Autoritetit Qendror Bankar i Kosovës përbëhej nga anëtarët e mëposhtëm:

Këshilli Drejtues i AQBK-së:

Z. Ajri Begu, Kryetar i Këshillit Drejtues të AQBK-së,
Z. Michel Svetchine, Drejtor i Përgjithshëm i AQBK-së,
Z. Gazmend Luboteni, Profesor, Fakulteti Ekonomik – Universiteti i Prishtinës
Znj. Chiara Bronchi, Kryesuese e Zyrës për Çështje Fiskale – shtylla e BE e UNMIK-ut
Mr. Lulzim Ismaili, Drejtor i Thesarit

Komiteti i Auditimit të Këshillit Drejtues të AQBK-së :


Z. Gazmend Luboteni, Profesor, Fakulteti Ekonomik – Universiteti i Prishtinës
Znj. Chiara Bronchi, Kryetare e Zyrës për Çështje Fiskale – Shtylla BE e UNMIK-ut
Z. Agron Dida, Inspektor Gjeneral

Komiteti Ekzekutiv i AQBK-së:

Z. Michel Svetchine, Drejtor i Përgjithshëm i AQBK-së
Z. Hashim Rexhepi, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Mbikëqyrjen e Sektorit Financiar
Mr. Gani Gërguri, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Sistemin e Pagesave
Z. Agron Dida, Inspektor Gjeneral

Struktura organizative e AQBK- së (më 31 dhjetor 2006)

Mr. Rucker, Mr. Gerguri and Mr. Rexhepi were members of the GB until 23 August 2006. Effective from 24 August 2006, Mr. Lulzim Ismajli has been appointed ex officio as a member of the GB.



1. Përmbledhje ekzekutive

1. Përmbledhje ekzekutive

Rregullorja e re e UNMIK-ut 2006/47 mbi Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës (AQBK) paraqet objektivat parësore të AQBK-së: Të kujdeset për mbarvajtjen, solventitetin dhe funksionimin efikas të sistemit financiar të bazuar në tregun stabil, duke inkurajuar daljen në treg të instrumenteve të sigurta financiare dhe pa paragjykuar për këtë, të përkrah politikat e përgjithshme ekonomike në Kosovë për të kontribuar në një alokim efikas të resurseve në pajtim me parimet e një ekonomie të tregut të hapur. Një nga kompetencat kryesore të AQBK-së me rregulloren e re është të kryejë analiza të rregullta ekonomike dhe monetare të ekonomisë së Kosovës, t'i publikoj rezultatet dhe në bazë të tyre të dërgoj propozimet e saj në Administratën e Përkohshme të KB në Kosovë si dhe te Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes. Kështu që, AQBK rregullisht botoj Raportin Vjetor të saj ku përshkruan zhvillimet në ekonominë e Kosovës me një fokus të veçantë në sektorin financiar, si dhe zhvillimet në ekonominë botërore dhe regjionale. Raporti Vjetor i AQBK gjithashtu trajton çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimet e brendshme në AQBK duke përfshirë edhe raportet e audituara financiare.

Ekonomia globale gjatë vitit 2006 u karakterizua me një rritje të prodhimit për 5.1% si rezultat i rritjes së investimeve. Vendet të cilat ndikuan në këtë ngritje ishin SHBA, Japonia, Kina dhe India. Ekonomia globale gjatë vitit 2006 ka qenë subjekt i presioneve inflatore si rrjedhojë e kërkesës në rritje për naftë nga njëra anë dhe në anën tjetër nga furnizimi i pamjaftueshëm me naftë që shkaktoi rritje të çmimit të naftës ndërkombëtarisht, e po ashtu edhe rritjen e inflacionit.

Vendet e Evropës Jug-Lindore (EJL) janë duke mbajtur hovin sa i përket rritjes ekonomike me një rritje mesatare të BPP prej 5.7%. Kjo rritje ekonomike në këto vende është shtyrë kryesisht nga kërkesa vendore, mjedisi i favorshëm për investime dhe rritja e eksportit. Vendi i cili ka pasur realizimin më të mirë ekonomik ka qenë Rumania, Bullgaria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia. Përkundër performancës së favorshme ekonomike, papunësia e lartë dhe disbalanci në sektorin e jashtëm janë brengosëse për vendet e Evropës Jug-Lindore.

Ekonomia e Kosovës u rimëkëmb nga ngecja e vitit të kaluar, duke shënuar një rritje reale të BPP për 3.0% në vitin 2006. Rritja e BPP u ndikua kryesisht nga investimet e sektorit privat të cilat kryesisht u mbështetën nga kreditë e sektorit bankar dhe investimet e huaja direkte. Sidoqoftë, shkalla e lartë e papunësisë dhe deficitit i llogarisë rrjedhëse mbetet si preokupim i politikbërësve. Deficitit i llogarisë rrjedhëse vazhdon të jetë i financuar në rend të parë nga paratë e dërguara nga diaspora e Kosovës dhe donatorët.

Pas deficiteve në 2004 dhe 2005, buxheti i konsoliduar i Kosovës në 2006 ka shënuar rekordin e bilancit pozitiv prej 3.4% të BPP nominale (76.5 milion euro). Bilanci pozitiv ka rezultuar nga teprica e të ardhurave vjetore mbi të ardhurat vjetore të buxhetuara në njërin anë, dhe në anën tjetër nga nën-shpenzimi substancial i kapitalit të buxhetuar që ka ndodhur kryesisht për shkak të zbatimit të joadekuat të procedurave buxhetore në disa agjenci shpenzuese.

Në përgjithësi, niveli i çmimeve në Kosovë ka mbetur stabil. Shkalla e inflacionit në 2006 ka qenë 0.7%, që është më e ultë se mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Një nga arsytet e stabilitetit të çmimeve është përdorimi i valutës Euro. Sidoqoftë, deri në një masë nivelet e çmimeve në Kosovë janë të ndikuara nga rritja e pranisë ndërkombëtare dhe ndihmës së donatorëve që ndikon

çmimet në sektorin e tregtueshëm dhe atë jo të tregtueshëm. Si rrjedhojë, zvogëlimi i paraparë i pranisë ndërkombëtare do të ndikoj në nivelin e çmimeve në afat të mesëm.

Gjatë vitit 2006, Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) vazhdoi të realizon me vendosmëri privatizimin e Ndërmarrjeve në Pronësi Shoqërore (NPSH). Ky proces i privatizimit është iniciuar me qëllim që të rrisë vlerën dhe udhëheqjen e NPSH dhe NPP. 213 kompani janë tenderuar vitin e kaluar dhe nëse privatizohen me sukses, të ardhurat vjetore do të arrijnë vlerën prej 154 milion Euro. Nëse marrim gjendjen e fund të vitit 2006, numri i tërësishëm i kompanive të privatizuara u ngrit në 216, kështu që të ardhurat nga privatizimi arritën shumën 275 milion.

Sektori financiar në Kosovë ka mbetur stabil dhe profitabil në vitin 2006. Struktura e sistemit financiar vazhdoi të jetë e dominuar nga bankat komerciale që në vitin 2006 përbëjnë 89% të totalit të mjeteve të sektorit financiar. Sektori bankar i Kosovës përbëhet nga gjashtë banka me pronësi private të cilat operojnë nëpërmes 220 njësive bankare nëpër Kosovës. Sektori bankar i Kosovës ka shënuar një rritje të aktiviteteve dhe një rritje të besimit në tregun vendor gjatë vitit 2006, duke lansuar produkte të reja siç janë kreditë me afat deri në dhjet vite si dhe kredi me hipotekë. Roli ndërmjetësues i bankave në Kosovë vazhdimisht po përmirësohet gjë që reflektohet me rritjen e kredive dhe depozitave. Kreditë në sektorin bankar janë rritur për 24% në 2006, duke arritur vlerën prej 636.6 milion euro, ose 26.1% të BPP.

Duke pasur parasysh shërbimet financiare, AQBK ka vazhduar të furnizoj ekonominë e Kosovës me bankënota dhe monedha për të mundësuar transaksionet me para të gatshme. AQBK po ashtu ka vazhduar të ofroj mirëmbajtjen e llogarive dhe shërbimet e pagesave për entitetet siç janë Thesari, IPVQ, AKM si dhe për kompanitë e mëdha publike. Në mënyrë që të ketë një sistem të sigurt dhe efikas të pagesave, AQBK ka vazhduar të menaxhoj dhe të operoj me Sistemin Ndër bankar të Pastrimit (SNP). Vëllimi dhe vlera e transaksioneve gjatë vitit 2006 ka vazhduar trendin e një ngritjeje të qëndrueshme.

Po ashtu, projekti Kos-gjiro i lansuar në vitin 2005 vazhdon të lehtësoj pagesën e faturave nëpërmes standardizimit dhe automatizimit të një skeme efikase për të gjithë pjesëmarrësit e involvuar: AQBK-në, bankat komerciale, për faturuesit e mëdhenj dhe dërgesat e mëdha të parave. Në pajtim me Rregulloren e AQBK-së dhe Politikën e Investimeve, menaxhimi i matur i rrezikut që vë sigurinë dhe likuiditetin para fitimit, ka vazhduar të udhëheq menaxhimin e mjeteve që është edhe një funksion tjetër i AQBK_së.

Në fillim të vitit 2006, AQBK ka lansuar Regjistrin e Kredive të Kosovës (RKK) në mënyrë që të lehtësoj këmbimin e informatave për kreditë në mes të institucioneve kredi-dhënëse. RKK u siguron institucioneve kredi-dhënëse informata për huamarrësit potencial. Ky avancim i procesit për këmbim të informative duhet të siguroj informata më të shpejta dhe më të sakta mbi plotësimin e kushteve nga huamarrësit potencial duke përmirësuar në këtë mënyrë qasjen në kredi si dhe marrjen e vendimeve të duhura për huadhënie.

Mbikëqyrja si dhe menaxhimi rregullator i institucioneve financiare që do të siguronte një sistem financiar të shëndoshë, të arritshëm dhe konkurrues, është një nga përgjegjësitë kyçe të AQBK-së. Objektivat kryesore të mbikëqyrjes bankare janë mbrojtja e fondeve të depozituesve dhe mirëmbajtja e sistemit stabil financiar. Në ndërlidhje me këtë, AQBK-ja ka revokuar licencën e

bankës Kreditore të Prishtinës (BKP) pasi që është konstatuar se BKP më nuk i përmbush standardet e solvencës së domosdoshme dhe likuiditetit për mbrojtjen e depozituesve. Procedura e likuidimit të BKP është duke vazhduar. Të gjithë depozituesit kanë marrë një kompensim prej 3,500 euro, që pagoi 97% të depozituesve. Pagesat tjera janë duke u bërë me anë të likuidimit të mjeteve të BKP. Përkundër mbylljes së kësaj banke, bankat tjera kanë vazhduar të operojnë me efikasitet, me një stagnim në rritjen e depozitave fillimisht për t'u rritur në mënyrë konstant mëpastaj.

2. Mjedisi i jashtëm ekonomik

2. Mjedisi i jashtëm ekonomik ¹

2.1. Ekonomia botërore

Përkundër një ngadalsimi të rritjes në 2005, prodhimi botëror shenoi një rritje të theksuar në gjysmën e parë të vitit 2006. Edhe pse pak e ngadalësuar në gjysmën e dytë, rritja globale është vlerësuar në 5.1%. Rritja e investimeve (në industri) dhe rritja e eksportit të vendeve që ka shënuar rritjen më të madhe të prodhimit, kanë qenë shtytës të rëndësishëm në ekonominë botërore. Në kuadër të sektorëve, industria përpunuese dhe sektori i shërbimeve janë rritur në vazhdimësi. Rritja e ekonomisë vendore është ndikuar nga rritjet e fuqishme në SHBA, Japoni, Kinë, Indi dhe disa vende të tjera në zhvillim. Kina është njëra nga vendet që ka tejkaluar shkallën e parashikuar të rritjes ku prodhimi është rritur për 10.4%. Ndërsa, për dallim nga Kina, vendet tjera kanë shënuar rritje prej 5.5%. Rritja e investimeve si dhe rritja e madhe në eksportet neto kanë kontribuar në rritjen e Kinës, përderisa në Japoni reformat e sektorit financiar, eksporti i fuqishëm dhe investimet e qëndrueshme në sektorin e biznesit kanë sjellë një zhvillim të shëndosh ekonomik. Performancë të fortë ekonomike hasim edhe në vendet e Lindjes së Mesme si dhe në euro-zonë.

Kërkesa globale për naftë dhe furnizimi i mangët kanë ndikuar në rritjen e çmimeve të naftës në tërë botën. Kjo ka ndikuar në rritjen e çmimit të produktit, i ka ngritur çmimet vendore dhe ka ndikuar në inflacionin e shumë vendeve, edhe pse inflacioni themelor ka qenë kryesisht nën kontroll. Norma e inflacionit në të shumtën e rasteve ka qenë më e lartë se sa shënjestrimi i tentuar nga bankat qendrore. Bazuar në vlerësimet e FED-it, Indeksi i Çmimit të Konsumit (IÇK) i SHBA-ve më 2006 ishte 2.3%, përderisa zona e shënjestruar e inflacionit bazë ishte 1.5 përqind. Mjeti kryesor për të ulur inflacionin, që është përdorur nga shumica e bankave qendrore, në veçanti nga FED-i ka qenë ngritja e normave afatshkurta të kamtës. Instrumenti i njëjtë është shfrytëzuar edhe nga Banka Qendrore Evropiane, përderisa banka e Japonisë përmbylli politikën e saj me zero-kamatë në Korrik 2006.

Deficiti i Llogarisë Rrjedhëse të SHBA-ve (LLRR) që ende konsiderohet si burimi kryesor i jobarazpeshës globale, tejkaloi nivelin prej 800 miliardë dollarë. Përkundër rritjes së eksportit, kërkesa e madhe për importe ka mbajtur deficitin e lartë të LLRR. Sidoqoftë, suficiti i LLRR në Azinë Lindore dhe vendet që janë eksportuese të naftës, vazhdojnë të balancojnë deficitin e SHBA-ve. P.sh Kina, ka shënuar bilanc të madh pozitiv në 2006 që është rreth 4.5% e PBB-së të saj. Dollari amerikan është zhvlerësuar pak në krahasim me Euron, Funtën dhe Jenin gjatë dy viteve të fundit. Nga ana tjetër në shumë vende aziatike (posaçërisht Kina) dhe në vendet që janë prodhuese të naftës, kursi devisor është ngritur. Nga fundi i vitit 2006, 1 euro ishte baraz me 1.33 dollar amerikan, që është 6.9% më e lartë se mesatarja në 2005. Ndërsa 1 euro është këmbyer me 153 JPY, që është 11.5% mbi mesataren në 2005. Euro u ngrit në krahasim me funtën angleze dhe në 2006 është këmbyer me 0.68 GBP, për gjysmë përqindje më pak se mesatarja në 2005.


¹ Seksioni mbi zhvillimet e mjedisit të ekonomisë së huaj është bazuar në publikimet e ndryshme të FMN (2006), EBRD (2006), monitorimi Ndërkombëtar i Biznesit (2007), Këshilli Evropian (2006), ECB (2007) dhe Eurostat (2007).

2.2 Bashkimi evropian

Bashkimi Evropian ka qenë i suksesshëm në përmbushjen e qëllimit duke sjellë benificione ekonomike nëpërmes të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së një tregu të vetëm efikas. Duke u bazuar në vlerësimet e Eurostat-it, rritja reale vjetore e PBB-së në vendet e BE-së sillej mesatarisht prej 2.5% dhe 2.9% në 2006, duke shënuar një përmirësim në krahasim me rritjen prej 1.3% në 2005, për derisa PBB për banor ishte 25,913 \$ amerikan. Kërkesa vendore konsiderohet si shtytës kryesor i rritjes ekonomike. Kushtet e financimit ishin të favorshme në 2006 dhe mundësuan një rritje të konsumit dhe investimeve, e cila pastaj kontriboi në rritjen ekonomike.

Bazuar në ECB, mesatarja e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) ishte 2.2% në 2006, duke treguar një nivel të ngjashëm me vitin paraprak. Zhvillimet në çmimet e energjisë dhe në veçanti në çmimet e naftës janë shkaktarë të një ngritjeje të vogël të inflacionit. Gjatë vitit 2006, shkalla e inflacionit ishte re paqëndrueshme kryesisht për shkak të ndryshimeve afatshkurta në çmimet e energjisë dhe ushqimit. Sidoqoftë, ashtu siç paraqitet në figurën 2, duke mos përfshirë ushqimin dhe energjinë e papërpunuar, IHÇK ka mbetur mjaft e qëndrueshme në vitin 2006.

Figura 1. Inflacioni (ndryshimi në IHÇK vjetore) në Euro-zonë (2003-2006)



Burimi: Eurostat (2007).

Bilanci i pagesave tregon rritje të fuqishme në eksport dhe import të të mallrave në euro-zonë. Për shkak të rritjes së deficitit tregtar, CA kumulative a regjistruar një deficit prej 28.8 miliard euro, krahasuar me tepricën prej 23.6 miliard euro në 2005. Lëvizja prej tepricës në deficit ka ndosur kryesisht për shkak të rritjes së importit që ka rezultuar në ngritjen e çmimit të naftës dhe importimet e ndërlydhura me energjinë. Importet e mallrave kanë përjetuar një ngritje të përnjëhershme në vitin 2006, për shkak të rritjes së kërkesës vendore.

Duke pasur parasysh kërkesat në vendet individuale të euro zonës, Irlanda është veçuar për rritjen e PBB-së reale, me një rritje vjetore prej 5.8%, e pasuar nga Greqia dhe Finlanda që shënuan rritjen e PBB-së reale, prej 3.7% respektivisht 3.5%. Italia, në anën tjetër ka shënuar rritjen më të vogël të PBB-së reale prej 1.5%. Ndërsa, nga vendet që nuk bëjnë pjesë në euro-zonë, Britania e Madhe ka shënuar rritje të PBB reale prej 2.7% në 2006. Ngadalësimi i PBB-së të BE është shkaktuar nga konsumi privat. Sidoqoftë, kërkesa vendore ka vazhduar të jetë shtytësi kryesor i ekonomisë.

IHÇK vjetor është llogaritur në 2.4% (krahasuar me 2.0% në 2005) ndërsa ngritja shpjegohet me rritjen e çmimeve të energjisë. Danimarka ka shënuar rritje të PBB-së reale prej 2.7% në 2006, ndërsa Suedia 4.0%. Si shtytës kryesor i aktivitetit ekonomik të këtyre dy vendeve ka qenë kërkesa vendore. Inflacioni i IHÇK vjetor është zbutur deri në 1.4% në Danimarkë, ndërsa ka mbetur e pandryshuar si 1.2% në Suedi.

Duke përmendur disa vende në tranzicion, tani anëtare të BE, siç janë Republika Çeke, Polonia dhe Hungaria, kanë shënuar rritje të PBB-së prej 6.2%, 5.0% dhe 3.5%. Rritja e prodhimit në republikën Çeke dhe Poloni kanë qenë të shtyra nga kërkesat vendore, përderisa në Hungari kjo është ndikuar nga neto eksportet. Për shkak të rritjes së tatimeve dhe çmimeve të administruara, IHÇK u ngrit dukshëm në Hungari (6.3%), ndërsa ka pësuar rënie në Republikën Çeke dhe Poloni. PBB reale në Slloveni është stabil që nga viti 2001, me një mesatare prej 3.4% (krahasuar me 1.4% në euro-zonë, për periudhën e njëjtë).

2.3 Evropa Jug-Lindore

Edhe pse vendet e Evropës Jug-Lindore (EJL) në vitet e fundit kanë pasur një rritje të favorshme, ende ndodhen para një rruge të gjatë. Sa i përket nivelit të PBB, vetëm Shqipëria, Kroacia dhe Rumania kanë arritur nivelin e PBB para-transicional; përderisa papunësia dhe disbalancat e jashtme mbesin si brengë për krijuesit e politikave në regjion. Rritja mesatare e PBB real për regjionin është duke ruajtur vrullin, duke arritur 5.7% në vitin 2006 krahasuar me 4.9% sa ishte në 2005. Rumania ka pasur rritjen më të madhe të PBB real, pastaj Bullgaria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia (Table 1).

Siç paraqitet në Tabelën 1, sa i përket PBB *për banor*, Kroacia duke llogaritur me 9540\$ amerikan veçohet nga vendet e regjionit që kanë arritur një mesatare të PBB *për banor* prej 4,439\$ amerikan. Rumania është e dyta, duke arritur nivelin e PBB *për banor* prej 5793\$ amerikan. Përveç Bullgarisë që ka arritur PBB *për banor* prej 3,981\$ amerikan, vendet tjera në rajon konsiderohen të varfëra, me nivel mesatar të PBB *për banor* prej vetëm 2,952\$ amerikan, që është vetëm pak më i lartë se pragu i vendeve me të ardhura të ulta prej 2,500\$ amerikan.

Tabela 1. Treguesit kryesor makroekonomik në EJL

Vendi	Zhvillimi PBB real		PBB për kokë banori		Inflacioni % V-n-V		Papunësia	
	2005	2006	2005	2006	2005	2006	2005	2006
Shqipëria	5.5	5.5	2,710.0	2,955.0	2.3	2.5	14.7	na
B & H	5.5	6.0	2,612.0	2,992.0	2.4	7.8	44.5	na
Bullgaria	5.5	6.4	3,465.0	3,931.0	6.6	6.5	10.7	9.2
Kroacia	4.3	4.6	8,568.0	9,540.0	3.6	2.0	12.3	na
IRJM	3.8	4.1	2,797.0	2,967.0	1.2	2.9	36.5	na
Mali i Zi	4.1	5.5	2,383.9	na	2.6	3.5	27.3	na
Rumania	4.1	7.7	4,577.0	5,793.0	8.6	4.9	5.9	5.2
Serbia	6.2	5.7	2,469.0	2,893.0	17.7	6.6	31.7	na
Mesatarja	4.9	5.7	3,697.7	4,438.7	5.6	4.6	23.0	7.2

Burimi: Business Monitor International (2007); EBRD (2006).

Sidoqoftë, përkundër zhvillimeve të favorshme në rajon, si çështje brengosëse mbetet niveli i lartë i papunësisë. Bosna dhe Hercegovina veçohen për nivelin e lartë të papunësisë që ishte 44.5% në fund të vitit 2005. IRJM është vendi i dytë me shkallë të lartë të papunësisë që është 36.5%. Niveli më i ultë i papunësisë (5.9%) është shënuar në Rumani.

Mund të konsiderohet se inflacioni në rajon është mbajtur në kontroll gjatë vitit 2006 (shih Tabelën 1). Kërkesat e mëdha vendore dhe çmimet e larta të energjisë dhe ushqimit kanë bërë presion në inflacion. Shkalla mesatare e inflacionit në rajon gjatë vitit 2006 ka qenë rreth 5.5%. Shumica e vendeve, gjatë vitit 2006, është bazuar në politikat e tarifave të këmbimit, si një instrument për t'iu përgjigjur presioneve të inflacionit. Në vazhdim, një regjim stabil është evidentuar në shumicën e vendeve nëpërmes të tabelave të parave (rasti i Bosnës dhe Hercegovinës si dhe Bullgarisë), euroizimi i (Malit Të Zi dhe Kosovës) dhe kursi fiks devizor (në IRJM).

Kërkesa e madhe vendore, e mbështetur nga rritja e kredive bankare si dhe e rritja e pagave në disa vende, kanë qenë treguesit kryesor të rritjes ekonomike. Për më tepër, rritja ekonomike është mbështetur poashtu nga kushtet e volitshme të investimit që kanë inkurajuar investimet e huaja të drejtpërdrejta (IHD), si dhe rritjen e eksportit. Zbatimi i marrëveshjeve për tregti të lirë, duke iu bashkuar CEFTA (Marrëveshjet për Tregti të Lirë në Evropën Qëndrore) kanë stimuluar një përtëritje të tregjeve të eksportit, duke zgjeruar mundësitë për eksport në vendet e rajonit. Sidoqoftë, kërkesa e madhe vendore ka reflektuar kërkesën e madhe për import në rajon, duke kompensuar deri në një masë rritjen e madhe të eksportit.

Rajoni ka përjetuar një ripërtëritje industriale nga të hyrat e konsiderueshme të IHD-ve, të realizuara nga një klimë e përmirësuar e investimeve, të arritur kryesisht nga reformat e ndërmarra për anëtarësim në BE, masat e stabilitetit ekonomik për mbajtjen e një pozite të shëndoshe të sistemit monetar dhe fiskal. Neto IHD është ngritur prej 13 miliard \$ amerikan në 2005 në 19.3 miliard\$ amerikan në 2006, që tregon një rritje prej 48.5% në rajon. Të hyrat kanë qenë kryesisht të ndërlidhura me programet e privatizimit në disa vende të investimet në bujqësi. Niveli më i lartë i IHD është shënuar në Rumani ku neto IHD ishte 8.65 miliard \$ amerikan, në Serbi 3.5 miliard\$ amerikan dhe në Bullgari 3 miliard\$ amerikan. Niveli më i ultë i IHD është shënuar në Mal të Zi me IHD neto prej 150.2 milion \$ amerikan (Tabela 2).

Tabela 2. Neto Investimet e huaja direkte (miliona dollarë),

Vitet	Shqipëria	B & H	Bullgaria	Kroacia	IRJM	Mali i Zi	Rumania	Serbija
2001	204.0	130.0	803.3	1,178.5	440.7	10.0	1,154.0	165.0
2002	135.0	266.0	876.3	585.6	77.7	84.0	1,080.0	475.0
2003	178.0	382.0	2,070.3	1,932.0	96.0	44.0	2,156.2	1,360.0
2004	332.2	490.0	2,777.1	870.9	155.9	63.3	6,368.0	966.0
2005	264.8	300.0	2,297.9	1,509.1	97.0	474.3	6,587.3	1,481.0
2006	350.0	570.0	3,000.0	2,824.8	300.0	150.2	8,652.0	3,500.0
Mesatarja	244.0	356.3	1,970.8	1,483.5	194.5	137.6	4,332.9	1,324.5

Burimi: Business Monitor International (2007); EBRD (2006).

Mesatarja e deficitit të LLRR në vendet EJL ka qenë 8.3% e PBB në vitin 2006 (Tabela 3). Kontribuesit kryesor për disbalancet e mëdha janë Bullgaria, Bosna dhe Hercegovina dhe Rumania, me një PBB mesatar prej 13.4%. Kroacia dhe Mali i Zi mbesin dy vendet me më shumë të hyra nga jashtë për shkak të rritjes së të hyrave nga turizmi dhe hyrjeve të medha te IHD si mjete financiare për deficitin e LLRR. Deficitetet e mëdha të të LRR mbesin një sifidë për qeveritë edhe gjatë viteve të ardhshme duke kërkuar reformat të reja strukturale. Reformat strukturale do të ndihmojnë ruajtjen e ritmit të tanishëm të IHD, duke pasur parasysh që ato paraqesin njësinë kryesore financiare të disbalancës së jashtme. Paratë e dërguara dhe sektori i donacioneve në anën tjetër, kanë qenë factor i rëndësishëm në financimin e deficiteve të LLRR në disa vende tjera të rajonit.

Në përgjithësi, vendet e EJL kanë zbatuar politika të shëndosha fiskale gjatë 2006. Si faktor kontribues duhet të përmenden programet e FMN dhe Institucionet tjera Financiare Ndërkombëtare. Përkundës mbajtjes se nje pozite te rregullt fiskale në rajon, shpenzimet qeveriatere janë ende të larta në relacion me PBB në shumë vende (p.sh Bosna dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi dhe Serbia). Bilanci i buxhetit në rajon ka qenë relativisht nën kontroll gjatë vitit 2006, me një mesatare prej 0.3% të PBB (Tabela 3). Kroacia paraqet vendin me deficitin më të lartë të buxhetit, 3.0% të PBB, përderisa Bullgaria ka shënuar tepriçën më të lartë buxhetore, të vlerësuar si 3.6% të PBB.

Tabela 3. Bilanci i buxhetit vjetor dhe bilanci i Llogarisë Rrjedhëse (2005-2006)

Vendi	Bilanci i buxhetit (% of PBB)		Bilanci i llogarisë rrjedhëse (% e PBB)	
	2005	2006	2005	2006
Shqipëria	-3.3	-0.6	-6.6	-6.4
Bullgaria	2.3	3.6	-11.3	-16.0
B & H	2.6	2.1	-21.8	-11.8
Kroatia	-4.1	-3.0	-6.4	-7.5
IRJM	0.2	0.4	-1.4	0.8
Mali i Zi	-1.7	-0.3	-8.6	-5.0
Rumania	-0.8	-1.6	-8.7	-10.7
Serbija	1.4	1.5	-9.7	-9.7
Mesatarja	-0.4	0.3	-9.3	-8.3

Burimi: Business Monitor International (2007), EBRD (2007).

Ekonomia e Shqipërisë ka pasur realizim të mirë gjatë vitit 2006, me një rritje të PBB prej 5.5% që është i ngjashëm me atë të vitit 2005. Kontribues kryespr i rritjes së PBB real mbetet konsumi privat dhe investimi, i financuar kryesisht nga remitancat dhe rritja e kredive banakre. Inflacioni, përgjithësisht, është mbajtur nën kontroll, duke qenë nën kufirin e caktuar prej 2% ne 4% nga Bankës e Shqipërisë. Inflacioni mesatar vjetor ka qenë 2.5% në 2006, duke shënuar një rritje të vogël krahasuar me 2.3% sa ishte në 2005. Leku shqiptar ka qenë relativisht stabil gjatë vitit 2006, duke krahasuar ngritjen e tij në vlerë ndaj euros përafërisht 3% gjatë 2005. Deficiti i LLRR është vlerësuar si 6.4% të PBB në 2006 dhe ka qenë kryesisht i financuar nga të hyrat e mëdha ne forme te remitancave si dhe fitimet nga turizmi. IHD është vlerësuar si 3.1% e PBB në 2006 që është mjaft mbrapa vendeve tjera të rajonit. Gjendja e bilancit buxhetor është përmirësuar dukshëm. Vlerësimet tregojnë se deficitin ka zbritur në 0.6% të PBB në 2006 krahasuar me 3.3% te PBB në

2005. Kreditë në sektorin privat kanë shënuar një zgjerim të theksuar, me një rritje prej 74% gjatë vitit 2006.

Bosna dhe Hercegovina shënuan një rritje relativisht të madhe në vitin 2006, të vlerësuar si 6.0%, krahasuar me 5.5% sa ishte në vitin paraprak. Rritje e madhe ekonomike ka rezultuar nga investimet e konsiderueshme si dhe rritja e madhe e eksportit. Inflacioni ka arritur deri në 7.8% në 2006 dhe arsyeja kryesore e kësaj rritjeje ishte aplikimi i TVSH-se në janar 2006 dhe çmimet e larta të naftës. Deficiti i LLRR ende konsiderohet si i lartë, edhe pse gjatë vitit 2006 ka pasur një rënie të dukshme, rreth 11.8% të PBB (nga 21.8% në 2005). Deficiti është financuar kryesisht nga transferet e kapitalit, IHD dhe hyrjet e tjera të kapitalit. Hyrjet e IHD janë ngritur pak gjatë 2006 dhe kanë arritur shumën prej 570.0 milion \$ amerikan (US\$ 300 milion në 2005). Për shkak të regjimit strikt kufitar valuator në lidhje me euron, BAM – valuta e BeH (Marka e konvertuar) ka qenë stabile gjatë vitit 2006.

PBB real i Bullgarisë është rritur prej 5.5% në 2005 në 6.4% gjatë 2006. Rritja e shpejtë e kredive ka stimular investimet dhe konsumin, duke qenë forcë shtytëse për rritjen ekonomike. Inflacioni vjetor ka pasur zbritje të vogël prej 6.6% në 2005 në 6.5% gjatë 2006, kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të ushqimit. Deficiti i LLRR substancialisht u rrit në 16.0% të PBB, dhe ka qenë i financuar nga hyrjet e mëdha të IHD dhe kredive bankare. Neto IHD ende konsiderohet si e lartë, duke shënuar US\$ 3 miliard, edhe pse pati një ngritje të vogël në krahasim me 2005. Në anën tjetër bilanci i buxhetit shënoi një tepricë prej 3.6% të PBB.

PBB real i Kroacisë është rritur për 4.6% në vitin 2006 krahasuar me 4.3% në 2005. Kërkesa vendore ka qenë shtytës kryesor për rritjen ekonomike. Investimet, eksport dhe turizmi mbesin faktorë të rëndësishëm të një realizimi të mirë ekonomik. Mesatarja e IÇK vjetore zbriti në 2.0% nga 3.3% sa ishte në 2005. Deficiti i LLRR u ngrit pak në 7.5% të PBB krahasuar me 6.4% të vitit 2005. Neto IHD u ngrit prej US\$ 1.5 miliard sa ishte në 2005 në US\$ 2.8 miliard në 2006, dhe pa i llogaritur të hyrat nga turizmi, vazhdoi të jetë një mjet i rëndësishëm financimi për deficitin e LLRR. Deficiti i buxhetit i regjistruar në 2006 ishte 3.0% e PBB, duke shënuar një zbritje në krahasim me 2005 kur deficiti i llogaritur i buxhetit ishte 4.1% e PBB.

Rritja e PBB real në IRJM arriti deri në 4.1% gjatë vitit 2006 nga 3.8% sa ishte në vitin 2005. Edhe pse konsumi privat dhe investimet patën një ngritje, rritja ekonomike u ndikua mbi të gjitha nga eksportet. IÇK pati një rritje prej 2.9% gjatë vitit 2006, krahasuar me 1.2% sa ishte në vitin 2005. Bilanci i jashtëm u përmirësua gjatë vitit 2006, kryesisht nga rritja e eksportit dhe rritja e neto transfereve të rrjedhshme. Bilanci vjetor i LLRR arriti tepricën prej 0.8% të PBB në 2006 duke lëvizur nga deficiti prej 1.4% sa ishte në vitin 2005. Neto IHD edhe pse shënoi rritje në krahasim me vitin 2005 ende konsiderohet si i ultë, duke shënuar 300.0 million US\$. Tarifa e këmbimit të denarit mbeti stabile kundrejt euros, në nivelin prej 61.3 MKD/EUR.

Mali i Zi arriti një rritje reale të PBB prej 5.5% (4.1% në 2005) kryesisht nga rritja në sektorin e shërbimeve dhe sektorit të turizmit. Sidoqoftë, investimet janë një faktor i rëndësishëm në rritjen ekonomike të Malit të Zi. Në gjysmën e parë të vitit 2006, prodhimi industrial u rrit prej 2.9%. IÇK vjetore u rrit prej 2.6% sa ishte në 2005, në 3.5% gjatë vitit 2006. Deficiti i LLRR pësoi ulje deri në 5.0% të PBB krahasuar me 8.6% të PBB në 2005, kryesisht për shkak të rritjes së eksportit dhe shërbimeve (të lidhura me turizëm). Si rezultat i procesit të privatizimit, neto IHD arriti përafërsisht deri në 150.2 milion US\$ krahasuar me 474.3 milion US\$ sa ishte në 2005, duke shënuar

një rënie prej 324.1 milion US\$. Deficiti buxhetor në 2006 zbriti prej 1.7% të PBB sa ishte në 2005 në 0.3% të PBB gjatë vitit 2006.

Rumania vazhdoi të realizoj rritje të fuqishëm ekonomike. Rritja e PBB real shënoi 7.7%, krahasuar me 4.1% sa ishte në 2005. Rritja e madhe e konsumit privat dhe investimeve ishin shtytësit kryesor të përmbushjes së suksesshme. Shkalla e inflacionit vjetor zbriti në 4.9% gjatë viti 2006 nga 8.6% sa ishte në 2005. Ngritja e vlerës së valutës, shtyrja e rritjes së çmimeve të administruara, dhe zbritjet në çmimet e bujqësisë ishin arsytet e reduktimit të mesatares së inflacionit vjetor. Deficiti buxhetor shënoi ngritje nga 0.8% e PBB sa ishte në 2005 në 1.6% të PBB të vitit 2006. Tutje, deficiti i LLRR u përkeqësua duke arritur deri në 10.7% të PBB në 2006, krahasuar me 8.7% të PBB sa ishte në 2005. Neto të hyrat e IHD vazhduan të mbesin burimi kryesor financiar për disbalancet e jashtme, duke shënuar 8.65 miliard US\$.

Rritja e PBB real në Serbi u vlerësua si 6.2% në 2006 krahasuar me 6.3% sa ishte në 2005. Rritja e kredive stimuloi konsumin vendor i cili tutje ndikoi në rritjen ekonomike. Rritje e eksportit në anën tjetër, në mënyrë të konsiderueshme kontribuoi në rritjen e PBB real. Inflacioni u ngadalësua në 6.6% nga viti në vit gjatë 2006 krahasuar me 17.7% sa ishte në 2005. Deficiti i LLRR është ende i lartë, në shumë prej 9.7% të PBB në 2006 dhe është pjesërisht i financuar nga të hyrat nga rritja e eksportit. IHD u ngrit në 2006, duke shënuar US\$3.5 miliard krahasuar me US\$ 1.5 miliard në 2005 dhe rritja kryesisht ka rezultuar nga procesi i privatizimit.

Per te konkluduar, mjedisi ekonomik rajonal, gjatë vitit 2006 ka qenë në përgjithësi i volitshëm, me shkalle të larte të rritjes ekonomike, inflacion dhe tarifa këmbimi stabile dhe një klimë të përmirësuar investimi. Si sfidë për rajonin mbetet zvogëlimi i deficitit të LLRR si dhe zvogëlimi i shkallës së papunësisë.

3. Ekonomia e Kosovës

3. Ekonomia e Kosovës

Në vitin 2006, ekonomia e Kosovës u rimëkëmbë nga stagnimi i vitit paraprak duke shënuar një rritje të PBB-së reale prej 3.0%. Ndrsyhe nga rritja e vitit 2004, rritja në 2006 është mbështetur kryesisht nga investimet e sektorit privat. Investimet e sektorit privat kanë qenë kryesisht të mbështetura nga kreditë e sektorit bankar dhe investimet e huaja direkte. Pavarësisht nga rënia e sektorit të donatorë, 'përbërja vendore' e PBB-së ka shënuar një rritje prej 5%, e cila është e krahasueshme me rritjen e PBB-së reale në EJL.

Edhe pse është e qartë se Kosova ka nevojë për një shkallë më të lartë të rritjes ekonomike për të adresuar sfidat me të cilat përballlet – dhe financimin e infrastrukturës publike, si dhe reduktimin e papunësisë – niveli i rritjes ekonomike në vitin 2006 duhet të konsiderohet si inkurajuese, për shkak se është arritur përkundër efekteve kufizuese që kanë rezultuar nga reduktimi i ndihmës së donatorëve (nga 426 milion euro në 343 milion euro) si dhe reduktimi i shpenzimeve të kapitale të qeverisë.

Në përgjithësi, niveli i çmimeve në Kosovë mbetet stabil. Shkalla e inflacionit në 2006 ishte 0.7%, që është më i ultë sesa mesatarja në EJL. Një nga arsytet e stabilitetit të çmimeve është përdorimi i valutës euro. Sidoqoftë, niveli i çmimeve në Kosovë deri në një masë është i ndikuar nga prania ndërkombëtare dhe ndihmës së donatorëve, e cila ka ndikim edhe në çmimet e tregtueshme dhe jo të tregtushme. Si rrjedhojë, zvogëlimi i dukshëm i pranisë ndërkombëtare ka ndikuar në nivelin e çmimeve në aspektin afatmesëm.

Për shkak të mungesës së kapaciteteve huamarrëse, si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, e poashtu edhe mungesa e instrumenteve për të financuar deficitin buxhetor, Qeveria duhet të ndjek politikat restriktive fiskale në mënyrë që të ruaj deficitin buxhetor që mund të financohet nga teprica fiskale e akumuluar që nga viti 2000. Realizimi i buxhetit të vitit 2006 paraqet tepricën prej 3.4% të PBB-së, për shkak të të hyrave fiskale shtesë dhe zërave të pashpenzuar buxhetor, përderisa deficitet e viteve 2004-2005 janë financuar nga tepricat buxhetore të viteve paraprake. Nevojiten reformat të mëtutjeshme në kuptimin e zgjerimit të bazës tatimore si dhe rregullimet e shpenzimeve në mënyrë t'i përmbushin nevojat për investime për adresimin e shumë problemeve strukturale të ekonomisë.

Për shkak të mungesës së infrastrukturës adekuate, niveli i papunësisë në Kosovë është njëra nga çështjet më brengosëse të ekonomisë. Shifrat e papunësisë lëvizin prej rreth 30% (FMN, 2004) deri në 40% (ESK, 2006). Kosova ka një popullsi relativisht të re, prandaj nevojitet shumë më shumë investim për të zbutur shkallën e papunësisë. Zgjidhja e statusit politik të Kosovës, por mbi të gjitha avancimi i kornizës ligjore të biznesit që bazohet në sundimin e ligjit si dhe reformat strukturale, përpjekja substanciale për përmirësimin e arsimit dhe trajnimit, modernizimi i infrastrukturës publike, me një ndërlidhje të duhur me partnerët afaristë, etj, do të ndihmonte krijimin e një mjedisi të volitshëm për investime. Për më tepër, rimëkëmbja e bujqësisë, minierave dhe sektorit të energjisë, të cilët kanë qenë forcë shtytëse për ekonominë e Kosovës, e edhe më shumë zhvillimi i nënkontraktiveve, janë të rëndësishme për realizimin afatmesëm ekonomik.

Tabela 4. Treguesit kryesor makroekonomik në Kosovë

Përshkrimi	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Rritja reale e PBB-së, në %	36.00%	0.40%	2.60%	2.10%	0.30%	3.00%
PBB për banorë (në EUR)	1,187	1,182	1,164	1,161	1,120	1,117
Çmimet(CPI), mesatarja vjetore në %	11.7	3.6	1.1	-1.1	-1.5	0.7
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, në % të PBB						
Të hyrat	16.4%	23.2%	28.0%	27.5%	28.5%	31.4%
Shpenzimet	12.1%	19.1%	25.3%	33.3%	31.1%	28.0%
Bilanci	4.3%	4.0%	2.8%	-5.8%	-2.6%	3.4%
Korporatat financiare (FC), në mijëra EUR						
Kërkesat neto në sek. e jashtëm	-	-	-	642,608	685,096	965,246
Kërkesat neto në sektorin fiskal	-	-	-	-221,347	-229,676	-482,499
Kërkesat në sektorin real	-	-	-	-253,463	-259,123	-184,288
Kërkesat	-	-	-	417,993	527,226	704,299
Obligimet	-	-	-	671,457	831,349	888,587
Llogaria rrjedhëse (CA) balanca, në % të PBB						
CA para asistencës së jashtme	-	-	-	-35.0%	-37.9%	-44.2%
CA pas asistencës së jashtme	-	-	-	-8.8%	-11.9%	-17.3%
Mallërat dhe shërbimet	-	-	-	-45.9%	-50.1%	-54.5%
Remitancat	-	-	-	15.0%	17.2%	18.7%

Burimi: FMN (2006, 2007), ESK (2006), MEF (2006), AQBK (2006).

Sektori financiar ka vazhduar të rris kreditë për sektorin privat duke mbështetur konsumin dhe në veçanti investimet gjatë vitit 2006. Kërkesat e sektorit financiar u llogaritën 704.3 milion euro, duke treguar një rritje vjetore prej 23.1%. Sektori financiar në Kosovë mbetet stabil dhe profitabil. Kryesisht për shkak të investimeve të AQBK-së, Mjetet e Huaja Neto (MHN) të sektorit financiar në vitin 2006 në krahasim me 2005 u rritën për 40.9%, duke shënuar 965.2 milion euro. Përkundër ndikimit të AQBK-së në sektorin financiar, MHN-të e bankave komerciale u rritën për 11.9%, duke arritur në 336.6 milion euro.


Disbalancet e jashtme të larta mbesin një brengë për ekonominë e Kosovës. Deficiti i lartë i llogarisë rrjedhëse pas ndihmës nga jashtë, që është vlerësuar të jetë 17.3% e PBB-së, mbetet një nga më të lartat në rajon. Para ndihmës nga jashtë, deficiti i llogarisë rrjedhëse duke shënuar 44.2% të PBB-së në 2006 është më shumë se shqetësues. Kjo nënkupton rëndësinë e sektorit të donatorëve, edhe pse në rënie, për ekonominë e Kosovës. Burimi kryesor i deficitit mbetet niveli i lartë i importeve. Mbulesa e importit me eksport është ende mjaft e vogël, diku rreth 8%. Transfertat prej kosovarëve që punojnë jashtë janë financimi më i rëndësishëm të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Remitancat në 2006 janë vlerësuar në 424 milion, në krahasim me 386 milion euro në 2005. Përveç të hyrave, një burim tjetër i financimit është edhe sektori i donatorëve dhe investimet e huaja direkte.

3.1. Sektori Real

3.1.1 Produkti i Brendshëm Bruto

Pas stagnimit në 2005, PBB-ja reale e Kosovës në vitin 2006 vlerësohet të jetë rritur 3%, duke shënuar 2.4 miliard euro (Grafiku 2). Kjo rezulton në PBB-në për banor në shumë prej 1.118 euro, që është nën mesataren e EJL-së. Rritja e PBB-së në 2006 është mbështetur nga rritja e investimeve në sektorin privat, përkundër rënies në sektorin e donatorëve dhe atë qeveritar, gjë që ka pasur ndikim negativ në ekonominë e Kosovës.

Figura 2. PBB-ja reale e Kosovës sipas çmimeve konstante të vitit 2002




Burimi: FMN (2006).

Bazuare në çasjen sektoriale, kërkesa e sektorit privat (konsumi dhe investimet) në 2006 shënuan gjithsej përafërsisht 2.7 miliard euro, duke u rritur 8.9% krahasuar me 7.7% sa ishte rritja në 2005. Rritja në sektorin privat ishte e mbështetur nga konsumi dhe investimet. Përderisa konsumi u rrit me një ritëm të ngadalshëm prej 4.1%, investimet private në 2006 u rritën në 32.9%. Me anë të kësaj rritjeje, investimet e sektorit privat e rritën edhe pjesëmarrjen e vet në PBB në 22.4%, duke shënuar kështu majën historike. Sa i përket kërkesës së sektorit qeveritar në shumë prej 400 milion, kjo shënoi rënie prej 12.1% në 2006, që është thujtë e njëjtë me rënien e vitit 2005. Burimi i rënies qëndron në shpenzimet e kapitale të qeverisë. Sektori i donatorëve në 2006 pati rënie në 448 milion euro nga 1.143 milion euro në 2000.² Në vitin 2000, sektori i donatorëve përbënte 70% të PBB-së së Kosovës, përderisa në 2006 përbën pak se 20% të PBB-së. Kjo rënie mund t'i adresohet rënies së shpejt në konsum (nga 871 milion euro në 2000 në 405 milion euro në 2006) dhe investime (nga 272 milion euro in 2000 to 43 milion euro).

² Sektori i donatorëve përfshin UNMIK-un, KFOR-in, dhe shpenzimet tjera donatore nën ombrellën e "programit të investimeve publike", dhe shpenzimeve të financuara nga grantet e caktuara. Këtu përjashtohen pagat e personelit të KFOR-it dhe mallrave të importuara drejtpërdrejt nga KFOR-i.


Grafiku 3. PBB-ja reale e Kosovës, sipas përbërësve, në çmime konstante të vitit 2002 (2000-2006)



Burimi: FMN (2006).

Bazuar në përbërësit e PBB-së, konsumi me një rritje vjetore prej 2.0% shënoi 2.8 miliard euro në 2006. Si përqindje në PBB-së, konsumi shënoi rënie të vazhdueshme nga maja 169% në 2000 në 115.3% të PBB në 2006 (Grafiku 3). Për shkak të konsumit të lartë ndaj PBB-së, kursimet vendore në Kosovë janë negative duke shënuar 15.3% të PBB-së. Duke shënuar vlerën prej 690 milion euro në 2006, gjithsej investimet u rritën në 14.0% në krahasim me 1.3% në 2005. Përveç rritjes në kuptimin e vëllimit, investimet u ngritën edhe si pjesë në PBB-së, në 28.3% në 2006, që është nga më të lartit në rajon (Grafiku 4). Burimet e investimeve në Kosovë janë kreditë nga sektori bankar dhe investimet e huaja direkte. Mesatarisht, për çdo vit, që nga viti 2002 rrjedha e kredive të sektorit bankar pati shtrirje në ekonominë vendore rreth 140 milion euro, ku pjesa më e madhe i është dhënë kompanive private. Investimet e huaja direkte në vitin 2006 janë vlerësuar në 266.3 milion euro krahasuar me 59 milion euro sa ishte në vitin 2005. Me eksportin dhe importin e mallrave në shumë prej 244 milion euro, respektivisht 1.324 milion, neto eksporti kosovar në vitin 2006 shënonte -1.080 milion euro. Deficiti i lartë tregtar në Kosovë ka kontributin negativ më të madhin në PBB.

Figura 4. Investimet si pjesëmarrje e PBB-së në EJL, në vitin 2006



Burimi: EBRD (2006), AQBK (2006).

Shënim: Të dhënat për B&H janë të vitit 2004, për Kosovën të vitit 2006, ndërsa për vendet tjera të vitit 2005.

3.1.2. Çmimet

Zvogëlimi i pranisë së komunitetit ndërkombëtar në Kosovë, duke sjellë rënie në kërkesën e përgjithshme, kanë shtyrë zbritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve, me gjasë duke zhvlerësuar normën reale të këmbimit. Kjo mund të konsiderohet si shenjë pozitive me ndikime të mundshme në aspektin e rritjes së konkurrencës dhe promovimit të eksportit. Arsye shtesë që mbështet stabilizimin e çmimeve është fakti që ekonomia e Kosovës është plotësisht e euroizuar. Siç paraqitet në grafikun 5, niveli i çmimeve që nga viti 2002 vlerësohet si mjaft stabil. Pas deflacionit prej 1.5% në 2005, inflacioni vjetor mesatar në Kosovë për vitin 2006 ishte 0.7%. Në aspektin e kategorive që përbëjnë IÇK-në, ritmi i çmimeve në shkallë të lartë është i ndikuar nga ushqimi dhe pijet joalkoolike që në vitin 2006 u rritën për 0.7%, nga -3.9% sa ishte në vitin 2005. Ndikimi i konsiderueshëm i çmimeve të ushqimit në IÇK, mund të shpjegohet me pjesëmarrjen e lartë të ushqimit në shportën e konsumatorit.

Figura 5. Inflacioni, mesatarja vjetore (2001-2006)



Burimi: FMN (2006), ESK (2007).

Sa i përket çmimeve të naftës, të cilat ndikuan në stabilitetin global të çmimeve, ato u rritën për 10.0% në vitin 2006. Rritja ishte më e vogël se në 2005 (13.9%). Duke pasur parasysh praninë e madhe ndërkombëtare në Kosovë, çmimet e qirasë në periudhën 2000-2003 shënuan rritje, duke arritur në dyshifrore. Por, me reduktimin e personelit ndërkombëtar dhe pjesërisht për shkak të rritjes së ofertës, këto çmime patën një rënie të ndjeshme. Në mënyrë konkrete, çmimet e qirasë ende vazhdojnë të bien, me një zbritje prej 0.4% në 2006, por në shpejtësi shumë më të vogël se vitet paraprake (-7.4% në 2004, dhe -1.7% në 2005).

3.1.3. Papunësia


Papunësia në Kosovë është e lartë. Sidoqoftë, janë vlerësues të ndryshëm në lidhje me shkallën e papunësisë në Kosovë. Bazuar në FMN, shkalla e papunësisë në Kosovë është 30%, ndërsa bazuar në Statistikat e Tregut të Punës, shkalla e papunësisë është rreth 41.4%, duke qenë nga më të lartat

në rajon.³ Ndërsa duke u bazuar në studimin e njëjtë, shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore në Kosovë në vitin 2005 ishte rreth 50.0% e popullsisë në moshën e punës.⁴

Një nga faktorët që pengon konkurrencën e sektorit privat në Kosovë është kostoja relativisht e lartë e prodhimit (p.sh kostoja e punës).⁵ Sidoqoftë, duke pasur parasysh politikat fleksibile të tregut të punës, mungesa e programeve sociale për të papunët, mungesa e sindikatave të forta të punëtorëve, dhe në të njëjtën kohë shkalla e lartë e papunësisë mund të bëj presion në zvogëlimin e pagave gjë që do të kishte implikime pozitive në rritjen e konkurrencës, duke tërhequr investimet e huaja direkte dhe promovimin e eksportit.

Numri i paraqitur i punëkërkuessve të regjistruar në fund të vitit 2006 ishte 326 mijë persona, prej të cilëve 46.7% janë femra. Siç paraqitet në Grafikon 6, punëkërkuessit e moshës 25-39 përbëjnë pjesën dominante të punëkërkuessve (44.1%). Krahasuar me vitin paraprak, në 2006 numri i gjithmbarshëm i kësaj kategorie ishte rreth 144 mijë. Përveç rritjes në kategorinë e sipërpërmendur, përafërsisht rritje e njëjtë në numrin e punëkërkuessve të regjistruar është shënuar edhe në kategoritë e moshave 15-24 dhe 40-54.

Figura 6. Numri i punëkërkuessve të ri të regjistruar sipas grupmoshave, në vitin 2006



Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (2006).

Numri i punëkërkuessve të regjistruar në Prishtinë është gjithsej 66.933, pasuar nga rajoni i Mitrovicës me 62.871. Sidoqoftë, duhet të mirret parasysh dendësia e lartë e popullsisë në Prishtinë. Vetëm në këto dy regjione janë të koncentruar 40% të numrit të tërësishëm të punëkërkuessve të regjistruar. Duke përjashtuar rajonin e Prizrenit, ku numri i tërësishëm i punëkërkuessve të regjistruar është 53.255, rajonet tjera të Kosovës nuk kalojnë numrin prej 40 mijë të punëkërkuessve të regjistruar. Aktualisht, numri më i madh paraqitet në rajonin e Gjakovës me 37.564 dhe numri më i vogël është regjistruar në rajonin e Ferizajt me numrin e tërësishëm prej 33.868 punëkërkuessve të regjistruar.

³ Shkalla e papunësisë është paraqitur si përqindje e personave të papunësuar në fuqinë punëtore

⁴ Pjesëmarrja e fuqisë punëtore e barabartë me shumën e personave të punësuar dhe atyre të papunësuar që kanë moshën e duhur për punë

⁵ FMN Aide Memoire, shkurt 2007

3.1.4. Privatizimi

Gjatë vitit 2006, Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) vazhdoi që me vendosmëri të përmbyll privatizimin e Ndërmarrjeve në Pronësi Shoqërore (NPSH), proces i inicuar me qëllim të ngritjes së vlerës dhe qeverisjes korporative të NPSH-ve dhe NPP-ve. Në vitin 2006, janë shpallur rezultatet e tenderëve për 11 valë të privatizimit, ku u inkorporuan rreth 213 Ndërmarrje të reja⁶, potenciale për privatizim të suksesshëm, prej të cilave 15 kaluan nëpërmes metodës së spin off-it special të privatizimit. Bazuar në ofertat e tenderit të fituesve të përkohshëm, shuma që do të akumulohet nga këto të ardhura pritet të jetë rreth 154.0 milion euro. Në mes tjerash, një arritje e veçantë gjatë vitit 2006 ishte ratifikimi i kontratës për Ndërmarrjen e re Ferronikeli, si një kompani prodhuese mjaft premtuese në sektorin e minierave me një ndikim potencial në ekonominë e Kosovës në aspektin e punësimit dhe eksportit.

Nëse konsiderojmë procesin e privatizimit si tërësi, në fund të vitit 2006, numri total i valëve të lansuara të privatizimit ishte 22, me mbi 350 Ndërmarrje të reja të tenderuara. Sidoqoftë, numri i kontratave për shitblerje të nënshkruara ishte 216, që paraqet numrin total të Ndërmarrjeve të reja që mund të konsiderohen si të privatizuara në mënyrë komplete. Shuma e akumuluar nga kompanitë e privatizuara ishte 275.0 milion euro- shumë e depozituar në AQBK në fund të vitit 2006. Të ardhurat janë rritur në mënyrë konstante gjatë vitit 2006, kështu që shuma kumulative llogaritet si 11.3% e PBB – nivel i krahasueshëm me vendet e rajonit (p.sh në vitin 2005 ky nivel ishte 11.4% në Shqipëri, 17.0% në Kroaci, 21.5% në Bullgari, etj).

Në mesin e 216 kontratave të ratifikuara deri në fund të vitit 2006, gjashtëmbëdhjetë i referohen kompanive të privatizuara nëpërmes procedurës së spin off-it special, duke përfshirë 30.0% të totalit të të ardhurave nga privatizimi. Kushtet e veçanta të kontratave të spin off-it special (zotimet për investime dhe punësim) rrisin rëndësinë e procesit të privatizimit. Shuma e investimeve të zotuarra e ndërlidhur me këto kontrata arrin vlerën prej 121.8 milion euro, përderisa numri total i punësimit të garantuar është 6,000 punëtorë në gjashtëmbëdhjet kompanitë. Implementimi i kushteve brenda kohës së caktuar në kontratën e spin off-it special, mbikëqyret dhe ekzaminohet tutje nga AKM-ja.

3.2. Sektori Fiskal


Kosova vazhdon të ndjekë politikat fiskale bazuar në një sistem modern të tatimeve. Të hyrat buxhetore kanë arritur rreth 30% të PBB, duke i mundur Kosovës që të krahasohet me vendet e rajonit. Duke u përballur me kufizime specifike, qeveria duhet të ndjek politika të shtrënguara fiskale në mënyrë që të ruaj buxhetin e balancuar apo të zvogëloj deficitin deri në një shumë të përafërt me tepricat e mëparshme të akumuluarra. P.sh dy deficite buxhetore të njëpasnjëshme që kanë ndodhur në 2004 dhe 2005 janë financuar nga tepricat buxhetore të viteve para 2004.

Nevojiten edhe reformat të reja në aspektin e zgjerimit të bazës tatimore dhe rregullimit të shpenzimeve siç janë pagat, mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe transfertat, në mënyrë që të rriten shpenzimet kapitale dhe të adresohen nevojat për investime, që nevojiten për të përballuar

⁶ AKM mund të krijoj një ndërmarrje të re në formë të ndërmarrjes me Pronësi të Përbashkët apo Ndërmarrje me Përgjegjësi të Kufizuar dhe të transferoj te këto ndërmarrje të reja një pjesë apo tërë mjetet e ndërmarrjes së vjetër shoqërore

me sukses problemet strukturale të ekonomisë. Për më tepër, pas zgjidhjes së statusit, duhet të zbatohen politika të shëndosha fiskale për të ruajtur qëndrueshmërinë buxhetore nga ngarkesat shtesë të cilat mund të dalin nga çmimi i bartjes së funksioneve nga UNMIK-u, pa i përmendur borxhet e jashtme që Kosova mund t'i trashëgoj nga ish Jugosllavia.

Figura 7. Buxheti i konsoliduar i Kosovës (2000-2006)



Burimi: MEF.


Pas deficitit të vitit 2004 dhe 2005, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në 2006 ka shënuar një tepricë prej 3.4% të PBB (76.5 milionë euro). Suficiti nuk ka qenë në pajtim me buxhetin a planifikuar që parashikonte deficit prej 3.1% të PBB nominal (71.1 milionë euro). Suficiti buxhetor rezultoi, në një rën të anë, nga të hyrat shtesë (të ardhurat shtesë tejkaluan parashikimet për 8.5% duke arritur në 712.0 milionë euro krahasuar me shumën e parashikuar 656.2 milionë euro) dhe, në anën tjetër, nga shpenzimi më i vogël se sa i paraparë në buxhet. Në fakt, janë shpenzuar vetëm 70% e shpenzimeve kapitale të planifikuara .

Te hyrat shtesë ishin drejtuar pjesërisht nga imponimi i një skeme speciale të dividendës në monopolin e telekomunikacionit dhe nga grumbullimi më i mirë i taksave të brendshme të cilat regjistruan 30% më shumë se sa që ishte planifikuar. Grumbullimi më i mirë i taksave është tregues i mirë pasi që tregon një përmirësim në kapacitetin administrativ për grumbullimin e taksave. Në anën tjetër, niveli më i ulët, se sa ishte parapare, i shpenzimeve kapitale (56.75 milionë euro) ishte si pasojë e mos zbatimit përkatës të procedurave si dhe planifikimit jo-adekuat buxhetor në disa agjenci shpenzuese. Efektet negative të nën-shpenzimit nuk duhet neglizhuar, pasi që ekonomia nuk do të përfitojë nga efekti i shumëfishimit të investimeve kapitale.

3.2.1 Të hyrat buxhetore

Të hyrat buxhetore në 2006 regjistruan shumën prej 712 milionë euro, një rritje prej 11.5% krahasuar me vitin paraprak. Në kushte nominale të PBB, të hyrat e tërësishme ishin 31% e PBB, tri pikë të përqindjes rritje (pp) krahasuar me 2005. Pjesa më e madhe e të hyrave të buxhetit të konsoliduar vjen nga tatimet, që përbëjnë 87% të gjithsej të hyrave, duke u pasuar nga të hyrat jo-tatimore dhe tatimet e grumbulluara nga qeveritë komunale me 8%, respektivisht 5%.

Figura 8. Struktura e shpenzimeve të BKK, 2005 - 2006



Burimi: MEF.

Duke arritur shumën prej 456.4 milionë euro, tatimet kufitare shënuan një rritje prej 7.1% krahasuar me 2005, por si pjesë e të hyrave të tërësishme, kanë pësuar një rënie nga 67% në 64%. Si faktor kontribues për ngritjen e vëllimit të tatimeve kufitare mund të jetë rritja e vëllimit të importeve (për 11.4%) që pjesërisht mund të jetë ndikuar nga marrëveshjet për Tregti të Lirë (MTL) me Shqipërinë dhe IRJM, prej të cilave importi ka shënuar një rritje prej 28.7% dhe 18.4%, krahasuar me 2005. Sidoqoftë, rritja e vëllimit të importit nuk është reflektuar si e tërë në tatimet kufitare, gjë që mund të jetë pjesërisht rezultat i ndikimit negativ që mund të kenë MTL në tatimet kufitare, përmes lirimit prej 10% nga taksat për të mirat materiale të importuara nga vendet me të cilat MTL-të janë në fuqi.

Tatimet kufitare, përkundër rënies si pjesë e të hyrave të tërësishme, mbesin kategoria që paraqet burimin kryesor për të hyrat buxhetore. Pjesa e madhe e tatimeve kufitare në të hyrat e tërësishme buxhetore kryesisht rezulton nga mbështetja e madhe e ekonomisë së Kosovës në importe dhe në veçanti për shkak të sistemit tatimor të Kosovës që kërkon që TVSH për mallërat e importuara të paguhet në kufi. TVSH e grumbulluar në kufi paraqet kategorinë më të madhe (46.1%) të të hyrave kufitare.


Një rritje substanciale është vërejtur në 2006 në grumbullimin e tatimeve vendore, të cilat u ngritën prej 127.2 milionë euro, sa ishin në 2005, në 164.1 milionë euro në vitin 2006. Kjo paraqet një rritje prej 29% në vëllim, përderisa si pjesë e të hyrave të tërësishme kjo rritje ishte 3 pp. Kategoritë kryesore në tatimet vendore janë TVSH e grumbulluar përbrenda vendit që përbënë 29% të tërësisë, pastaj tatimet në të ardhurat e korporatave dhe tatimet në të ardhurat personale me 19% respektivisht 18% të gjithsej tatimeve vendore.

3.2.2 Shpenzimet buxhetore

Në shumë prej 635.5 milionë euro, shpenzimet buxhetore shënuan një rënie prej 8.7% krahasuar me 2005, duke ruajtur kështu trendin e rënies që nga viti 2005 kur shpenzimet buxhetore shënuan një rënie prej 9.5% krahasuar me 2004. Si pjesë e PBB nominal, shpenzimet buxhetore zbritën prej 31% në 2005 në 28% në 2006. Rënia në shpenzimet e tërësishme buxhetore të vitit 2006 rezultoi nga

rënia e subvencioneve dhe transfereve në NPP për 27.3%. Subvencionet dhe transferet shënuan rënie edhe si pjesë e shpenzimeve të tërësishme (prej 30% në 24%).

Figura 9. Struktura e shpenzimeve të BKK , 2005 - 2006



Burimi: MEF.

Struktura e shpenzimeve buxhetore ndryshoi në favor të mëditjeve dhe pagave. Edhe pse ‘Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2006-2008’ parasheh që numri i shërbyesve civil do të ulet për 10% deri në 2008, fatura e pagave buxhetore, në aspektin e vëllimit, është rritur për 4.8% në 2006 krahasuar me 2005.⁷ Prandaj, pas një rënie të shpejtë në transfere dhe subvencione, kryesisht në kompanitë në pronësi publike, që në vitin 2005 paraqisnin pjesën më të madhe në shpenzimet buxhetore, mëditjet dhe pagat u bënë kategoria më e madhe në shpenzimet buxhetore, duke arritur 32% të gjithë shpenzimeve buxhetore (duke shënuar një rritje prej 4pp në strukturën e shpenzimeve). Kjo tregon vështirësitë substanciale në kontrollimin e rritjes së shpenzimeve aktuale. Njëkohësisht, me gjithë parashikimin e rritjes së shpenzimeve kapitale të cituar në ‘Kornizën e Shpenzimeve Afatmesme për 2006-2008’, në vitin 2006 shpenzimet kapitale shënuan një rënie prej 8.1% krahasuar me vitin 2005, të shoqëruara me efektet negative në ekonomi, ashtu siç është përmendur tanimë.

Sa i përket buxhetit të aprovuar për 2007, parashihet një deficit prej 34.2 milionë euro ose 1.5% e PBB. Deficiti i paraparë buxhetor rezulton nga rënia e paraparë në të hyrat buxhetore dhe rritja e paraparë në shpenzimet buxhetore. Të hyrat buxhetore parashihet të jenë 682.8 milionë euro në 2007, duke paraqitur një rënie prej 4.1% krahasuar me të hyrat e mbledhura në vitin 2006, kurse, shpenzimet pritet të arrijnë shumën prej 717.4 milionë euro, që nënkupton një rritje prej 12.9%. Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore nuk duket se do të jetë objekt i ndryshimeve të rëndësishme në vitin 2007. Tatimet kufitare do të mbeten kategoria më e madhe në të hyrat buxhetore duke paraqitur 64.1% të tërësisë, përderisa pagat dhe mëditjet do të mbeten kategoria më e madhe në shpenzimet buxhetore duke paraqitur 28.4% të tërësisë.


⁷ MEF (2006).

3.2.3 Skema Pensionale

Skema e sigurimit social përbehet nga Skema Pensionale Bazë dhe Skema Pensionale e Kursimeve Individuale. Skema Pensionale Bazë financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe përbehet nga një shume prej 40 euro e cila u paguhet banorëve me te vjetër se 65 vjeç. Skema Pensionale e Kursimeve Individuale e cila është paraqitur ne vitin 2002 menaxhohet nga Trusti i Kursimeve Pensionale te Kosovës (KPST), bazuar ne kontributin e detyrueshëm nga punëdhënësit dhe punonjësit (5% secili).

Natyra e detyrueshme e kontributeve pensionale të paguara ne Skemën Pensionale të Kursimeve Individuale, ne përputhje me standardet ndërkombëtare të klasifikimit të statistikave e klasifikon TKPK-në si “fond i sigurimit shoqërorë” dhe si të tille, pjesë të qeverisë së përgjithshme. Shuma kumulative e mbledhur përmes kësaj skeme, në fund të vitit 2006, ishte 213 milion euro, që paraqet një rritje prej 49% krahasuar më vitin 2005.

Figura 10. Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), shumat kumulative (2004-2006)



Burimi: TKPK.

Një rritje është vërejtur gjithashtu në numrin e kontribuuesve të cilët janë rritur për 17%, duke arritur shumen rreth 215 mijë në vitin 2006 (nga rreth 183.7 mijë në vitin 2005). Rritja në numrin e kontribuuesve rrjedh pjesërisht nga përmirësimet në mënyrën që punëdhënësit i raportojnë punonjësit e tyre për kontributet pensionale dhe gjithashtu për shkak të numrit të rritur të personave të punësuar jashtë “ekonomisë joformale”. Fondet e mbledhura përmes kësaj skeme vazhdojnë të investohen në tregjet e huaja në instrumente financiare të ranguar lartë, gjë që thekson parimin e sigurisë të këtyre mjeteve. Si i tillë, përveç sektorit financiar, sektori qeveritar mbetet kreditori neto i sektorit të jashtëm.


3.3 Sektori Financiar

3.3.1 Karakteristikat e Përgjithshme

Totali i mjeteve të korporatave financiare (duke përjashtuar AQBK-në) në fund të vitit 2006 arriti vlerën 1.270,7 milion euro, një rritje prej 17.8% krahasuar me vitin 2005. Sektori financiar në Kosove

vazhdon të dominohet nga bankat komerciale të cilat menaxhojnë rreth 89.0% të mjeteve totale të sektorit financiar dhe struktura si e tillë nuk është përbërur me ndonjë ndryshim të dukshëm (Figura 11). Pjesa e mbetur e mjeteve shpërndahet ndërmjet kompanive të sigurimeve (5.0%), ndërmjetësuesve të tjerë financiarë (5.0%), dhe fondeve pensionale (1.0%).

Figura 11. Struktura e sektorit financiar në Kosovë (duke përfshirë AQBK-në), (2005 – 2006)




Burimi: AQBK (2007).

Për sa i përket numrit të korporatave financiare në fund të vitit 2006 në Kosovë operonin 6 banka komerciale, 9 kompani të sigurimeve, 1 fond privat pensional, 16 ndërmjetësues tjerë financiarë (NTF) dhe 23 ndihmës financiarë. Ndërmjetësuesitë tjerë financiarë janë kryesisht institucione mikro-huadhënëse të përfshira ekskluzivisht në aktivitetet e huadhënies pa leje për marrjen e depozitave, përderisa ndihmësitë financiarë zakonisht veprojnë si byrotë për këmbimin e parave, dhe pjesëmarrja e tyre ndaj mjeteve totale të sektorit financiar është shumë e vogël.

Përkrahur nga rritja e depozitave të sektorit qeveritar në AQBK (kryesisht të hyrat nga privatizimi), mjetet e huaja neto (MHN) arritën shumën 965.2 milion euro në fund të vitit 2006. Krahasuar më vitin 2005, shuma totale e MHN-ve u rrit për 41.0%, duke arritur kulmin historik, e cila bënë që sektori financiar në Kosovë të mbetet neto kreditor i sektorit të jashtëm. AQBK-ja si pjesëmarrës kryesor menaxhon rreth 66.3% të totalit të MHN-ve të korporatave financiare. Në përgjithësi, derdha e kapitalit financiar jashtë vendit vjen si pasojë e domosdoshmërisë për mbajtje të sigurt të shumave të mëdha të fondeve (mjetet e TKPK-së, të hyrat nga privatizimi), disa nga to në intervale të shkurtëra (si fondet e privatizimit), përderisa ka pak mundësi të investimit ose të plasimit në Kosovë.

Pasi që sektori financiar nuk ka asnjë kërkesë mbi sektorin fiskal, depozitat qeveritare në korporatat financiare (kryesisht në AQBK) paraqesin lidhjen e vetme ndërmjet këtyre dy sektoreve. Kryesisht, kërkesat neto mbi sektorin fiskal kishin shumën prej 482.5 milion euro në vitin 2006, krahasuar më 230.0 milion euro të vitit paraprak (Figura 12). Kjo i atribuohet kryesisht (i) të hyrave nga privatizimi gjatë vitit 2006 dhe, (ii) rritjes së depozitave qeveritare në AQBK (për shkak të tepricës buxhetore për vitin fiskal 2006). Në të vërtetë, të ardhurat nga privatizimi arritën shumën prej 275.0 milion euro në fund të dhjetorit 2006, që përbën 58.4% të depozitave të sektorit qeveritar në AQBK.

Figura 12. Kërkesat neto të Korporatave Financiare, (2004 – 2006)



Burimi: AQBK (2007).

Sektori financiar lidhet me sektorin real (kryesisht korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare) më anë të kërkesave dhe detyrimeve. Kërkesat mbi sektorin real, kryesisht të përbëra nga kreditë, janë rritur për 23.3% krahasuar me fundin e vitit 2005. Shuma kumulative e kredive të sektorit financiar në vitin 2006 qëndroi në 694.3 milion euro, duke paraqitur një rritje vjetore prej 22.5%. Detyrimet e sektorit real me vlerën prej 888.6 milion euro në vitin 2006, e klasifikojnë sektorin financiar si neto debitor ndaj sektorit real (Figura 12).

3.3.2 Zhvillimet ne Sektorin Bankar

Rrjeti dhe përbërja. Sektori bankar i Kosovës përbëhet nga gjashtë banka komerciale më pronësi private, të cilat operojnë përmes 220 njësive bankare në tërë Kosovën. Bankat janë të përqendruara në aktivitetet tradicionale bankare dhe shërbimet e tyre janë të kufizuara me veprimtaritë që ndërlidhen me depozitat dhe kreditë. Megjithatë, se fundi bankat kanë treguar ambicie për zgjerimin e llojllojshmerisë së produkteve dhe të shërbimeve që u ofrojnë klienteve.

Në fund të vitit 2006, gjashtë banka komerciale operonin në Kosovë, prej të cilave dy më pronësi të plotë të huaj dhe katër të tjerat më pronësi kryesisht vendore. Në mars të vitit 2006, AQBK-ja i revokoi licencën Bankës Kreditore të Prishtinës (BKP-së) pas vlerësimit se BKP-ja nuk i përmbushte më kushtet e nevojshme, për sa i përket kapitalit dhe mjeteve likuide, që të mbrojnë depozitorët e saj. Procesi i likuidimit të BKP-së ende po vazhdon. Të gjithë depozitorët kanë marrë kompensim të menjëhershëm në shumë prej 3,500 euro gjë që tregon se rreth 97% të depozitorëve janë rimbursuar plotësisht dhe shpejtë. Pagesat e mëtejme bëhen duke u bazuar në procesin e rikthimit të mjeteve.

Pavarësisht nga mbyllja e kësaj banke vendore, bankat tjera vazhduan të operojnë në mënyrë efektive dhe asnjë ndikim i theksueshëm përcjellës nuk ishte i dukshëm gjatë kësaj periudhe. Depozitat e tërësishme bankare nuk pësuan ndonjë rënie, mirëpo përjetuan një periudhë “ngrirjeje” gjatë tre muajve të ardhshëm. Megjithatë, pas kësaj periudhe të shkurtër të “ngrirjes” depozitat vazhduan të rriten me një rritje mesatare mujore prej 1.7% (ngjashëm me rritjen mesatare mujore të vitit 2005). Për më tepër, në fund të vitit 2006 rritja vjetore e tërësisë së depozitave ishte 10.7%

përderisa depozitat e mbetur të BKP-së, që nga marsi 2006 u kategorizuan si detyrime të tjera në bilancin e gjendjes të sektorit të tërësishëm bankar.

Bankat komerciale ende po zgjerojnë rrjetin e degëve në tërë Kosovën. Në fund të vitit 2006 ishin 220 njësi bankare, me përafërsisht 2,416 punonjës. Në fund të vitit 2006 rrjeti bankar i gjashtë bankave në funksion numëronte 15 njësi më shumë se në vitin 2005, me përafërsisht 280 më shumë punonjës. Dukshëm, rreth 30.0% të rrjetit të degëve, përfshirë edhe zyrat qendrore, përqendrohet në Prishtinë, në kryeqytetin e Kosovës. Pastaj pason rajoni i Gjilanit më 22.3% apo 49 njësi bankare, përderisa njësitë tjera shpërndahen në mënyrë të barabartë ndër tre rajonet kryesore të mbetura: Pejë, Prizren dhe Mitrovicë.

Numri i bankomateve deri në fund të vitit 2006 është rritur për 23 (duke numëruar 123) dhe numri i pikave të shitjes është rritur për 64 duke numëruar gjithsejtë 1470. Numri i llogarive rrjedhëse ka arritur në 664,734 nga 635,394 në vitin 2005, gjë që tregon se rreth 30% të popullsisë së Kosovës ka llogari bankare. Plasimi i sistemit bankar përmes internetit në vitin 2005 u shënuar me rezultate pozitive në vitin 2006, pasi që 3,316 llogari përdornin internetin në sistemin bankar në fund të vitit 2006, krahasuar me 837 në fund të vitit 2005. Si pasojë, numri dhe vlera e transaksioneve të kryera përmes këtij sistemi janë rritur pesë herë më shumë krahasuar më fundin e vitit 2005 (rreth 11,588 transaksione në vlerë prej 25.8 milion euro, në fund të vitit 2006). Sistemi bankar përmes internetit ofrohet vetëm nga tri banka.

Rritja e besimit të bankave në tregun vendor shihet nga paraqitja e produkteve të reja gjatë vitit 2006. Katër bankat më të mëdha filluan të ofrojnë kredi me afat të kthimit deri në 10 vite, si dhe kredi hipotekare. Veç kësaj, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006, një bankë vendore filloi të lëshojë certifikata të depozitit, një instrument i ri financiar brenda sektorit bankar të Kosovës.

Për sa i përket strukturës së pronësisë së sektorit bankar nuk ka pasur ndryshim në vitin 2006. Dy bankat e huaja vazhduan të kryesojnë tregun, rritën dominimin e tyre në sektorin bankar, duke menaxhuar rreth 71.2% të tërësisë së mjeteve. Andaj, pothuajse tërë rritja vjetore e mjeteve të sektorit bankar rezultonte nga bankat e huaja (më një rritje prej 27.0%), përderisa mjetet e tërësishme të bankave vendore (duke përfshirë BKP-në në likuidim) janë rritur vetëm për 5.4% në krahasim më vitin 2005.

Tabela 5. Struktura e pronësisë së mjeteve të sektorit bankar, në mijëra euro (2004-2006)


Përshkrimi	Dhjetor 2004		Dhjetor 2005		Dhjetor 2006	
	Vlera	Aksione(%)	Vlera	Aksione (%)	Vlera	Aksione (%)
Bankat e huaja	500,832	61.6	652,866	66.3	828,604	71.2
Bankat vendore	312,067	38.4	331,546	33.7	334,710	28.8
Gjithsej mjetet	812,899	100	984,412	100	1,163,314	100

Burimi: AQBK (2007).

Ndonëse treguesitë e koncentrimit të sektorit bankar, siç është pjesëmarrja në treg e dy bankave më të mëdha (C2) dhe Indeksi Herfindahl-Hirschman (IHH), mund të mos supozojnë konkurrencën në treg, të dyja tregojnë se sektori bankar i Kosovës është i koncentruar. Pjesëmarrja e dy bankave të huaja në tërësinë e kredive (73.2%, në fund të dhjetorit 06) dhe depozitat (75.1%, në fund të dhjetorit 06) ilustron koncentrimin e sektorit bankar të Kosovës. Pamje e ngjashme tregohet edhe kur koncentrimi i sektorit matet me anë të IHH-në të kalkuluar veçmas për mjetet, kreditë dhe

depozitat (Figura 13). Indeksi tregon se tregu është më i koncentruar tani se në periudhat e mëparshme, me një koncentrim të kredive prej 2,871 pikëve, dhe koncentrim të depozitave i cili qëndron në 3,047 pikë.

Figura 13. Indeksi Herfindahl-Hirschman i bankave komerciale, (2004 – 2006)



Burimi: AQBK (2007)

Bilanci i i gjendjes. Viti 2006 nuk shënoj asnjë ndryshim të rëndësishëm për sa i përket strukturës së mjeteve të sektorit bankar krahasuar me vitin e mëparshëm. Kreditë vazhdojnë të paraqesin më shumë se gjysmën e tërësisë së mjeteve të sektorit bankar, përderisa depozitat paraqesin pothuajse 80.0% të tërësisë së detyrimeve.

Me një rritje vjetore prej 18.2%, në tërësi mjetet bankare arritën shumën prej 1,163.3 milion euro në fund te vitit 2006. Raporti i tërësisë së mjeteve të sektorit bankar ndaj PBB-së në vitin 2006 u rrit në 47.7%, krahasuar me nivelin e 41.7% të vitit 2005. Raporti është më i lartë se në disa ekonomi fqinje dhe po i afrohet mesatare së shteteve të EJT-së – duke e konsideruar rastin e Kroacisë si rast më të veçantë me raport prej 109%. (Shiko Kutinë 1).

Sektorit bankar ka rritur veprimtarinë e vet huadhënëse ndaj tregut vendor. Shuma kumulative e kredive përbën 54.7% të tërësisë së mjeteve, që paraqet rritje në krahasim më vitin 2005 (52.2%). Paratë e gatshme dhe bilanci më AQBK-në përbëjnë 12.3% të tërësisë së mjeteve të sektorit bankar, kryesisht si pasojë e rezervave të detyrueshme të likuiditetit që bankat duhet të mbajnë më AQBK-në. Ndërsa 29.4% e mjeteve të sektorit bankar janë investuar jashtë (kryesisht plasmanet në bankat korresponduese apo bankat amë jashtë vendit, si dhe plasmanet likuide në letra më vlerë).

Tabela 6. Bilanci i gjendjes së bankave komerciale, në mijëra euro (2004 – 2006)


Përshkrimi	Dhjetor 2004		Dhjetor 2005		Dhjetor 2006	
	Vlera	% në total	Vlera	% në total	Vlera	% në total
Paraja e gatshme dhe gjendja me CBAK-në	116,490	14.3	131,738	13.4	143,528	12.3
Bilancet me bankat komerciale	186,009	22.8	221,936	22.5	243,105	20.9
Garancionet	112,281	13.8	82,946	8.4	99,428	8.5
Bruto kreditë dhe lizingu financiar	373,661	45.8	513,856	52.2	636,613	54.7
Mjetet fikse	15,878	1.9	16,933	1.7	22,872	2.0
Mjetet fikse	12,219	1.5	17,003	1.7	17,767	1.5
Gjithsej mjetet	816,538		984,412		1,163,314	
Bilancet me bankat tjera	14,276	1.7	23,034	2.3	30,245	2.6
Borxhet ndaj klientëve	695,932	85.2	843,048	85.6	930,537	80.0
<i>Depozitat</i>	694,533	85.1	836,657	85.0	926,370	79.6
<i>Huazimet tjera</i>	1,399	0.2	6,391	0.6	4,167	0.4
Detyrimet tjera	27,891	3.4	37,344	3.8	103,219	8.9
Borgjet vartëse	9,318	1.1	6,999	0.7	7,003	0.6
Burimet vetanake	69,122	8.5	73,988	7.5	92,310	7.9
Gjithsej detyrimet	816,538		984,413		1,163,314	

Burimi: AQBK (2007).

Detyrimet nuk pësuan ndonjë ndryshim të dukshëm në strukturën e tyre (Tabela 6). Depozitat e klientëve mbesin komponenti kryesor i detyrimeve të bankave, megjithëse pjesëmarrja e tyre ndaj detyrimeve totale zbriti në 79.6% në fund të vitit 2006 krahasuar më 85.0% të vitit 2005. Kjo zbritje pason nga likuidimi i BKP-së, pasi që depozitat e tyre janë klasifikuar si ‘detyrime tjera’, çka edhe sqaron rritjen e këtij zëri bilancor. Burimet vetanake të sektorit bankar janë rritur për 24.8% duke arritur vlerën prej 92.3 milion euro në fund të vitit 2006, si pasojë e disa rritjeve të kapitalit. Megjithatë, si pasojë e zhvillimit të përgjithshëm të aktiviteteve bankare, raporti i burimeve vetanake ndaj tërësisë së detyrimeve mbetet pothuajse i pandryshuar.

Në fund të vitit 2006 shuma kumulative e kredive të sektorit bankar arriti vlerën prej 636.6 milion euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 24.0%. Raporti i kredive të sektorit bankar ndaj PBB-së u përmirësua gjithashtu, duke paraqitur 26.1% të PBB-së në vitin 2006, krahasuar më 21.7% në vitin 2005. Kjo e sjellë Kosovën në një pozitë më të mirë në krahasim më disa shtete në rajon (shiko Kutinë 1). Megjithatë, rritja vjetore e kredive pak mbi 20% në vitin 2006, tregon se rritja e kredive është duke u stabilizuar në krahasim me nivelet mbi 40% të arritura në vitet e mëparshme (kryesisht për shkak të bazës së ulët të aktivitetit huadhënës). Rritja e kredive kryesisht është ndikuar nga rritja e kredive të bankave të huaja, përderisa mesatarisht rritja e kredive të bankave vendore ishte shume e ulët (Figura 14).

Figura 14. Rritja vjetore e kredive, (2004 – 2006)




Burimi: AQBK (2007).

Në fund të vitit 2006, korporatat jo financiare (KJF) vazhdojnë të marrin pjesën më të madhe të tërësisë së kredive të lëshuara nga sektori bankar, rreth 77.1% apo 490.5 milion euro. Në fakt, pjesa kryesore e aktivitetit huadhënës ka për qëllim kompanitë e vogla dhe të mesme, si dhe ekonomitë familjare, të cilat tërheqin pjesën e mbetur, 22.9%. Më një rritje prej 26.5%, kreditë ndaj KJF-ve ishin kontribuesitë më të mëdhenjë të rritjes së përgjithshme të kredive. Kjo është pjesërisht për shkak të përfshirjes së disa bankave në privatizimin e kompanive, përderisa shuma e kredive të lëshuara ekonomive shtëpiake u rrit për 16%, duke arritur shumën prej 146.1 milion euro në fund të vitit 2006.

Sektorizimi i kredive ndaj KJF-ve përmes veprimtarisë ekonomike mbetet i ngjashëm krahasuar me vitet e mëparshme. Për më tepër, llojllojshmëria e tërësisë së portfolios së kredive në industri të ndryshme është në harmoni më gjendjen momentale të veprimtarisë ekonomike në Kosovë. Tregtia, si veprimtaria kryesore ekonomike në Kosovë, vazhdon të përfitoj 62.7% të tërësisë kumulative të kredive të lëshuara, përderisa 'shërbimet tjera' përfitojnë 13.8% të kredive. Kreditë ndaj firmave prodhuese përbëjnë 23.4% të tërësisë së kredive – me 20.0% të përfituara nga sektori i energjisë dhe ndërtimitarisë, dhe vetëm 3.4% nga sektori i bujqësisë (ngjashëm me vitin 2005). Në veçanti, rritja prej 31.5% e kredive të lëshuara ndaj sektorit prodhues është shenjë e rimëkëmbjes së veprimtarisë në këtë sektor.

Rritja e kredive afat-gjate shpreh besimin e përforcuar të sektorit bankar ndaj ekonomisë vendore. Rreth 52.8% e shumës kumulative të kredive në fund të vitit 2006 kishte afat kthimi më të gjatë se 2 vite, përderisa kreditë afat-shkurtëra deri në 1 vjet paraqesin vetëm 23.3% të tërësisë së kredive. Gjithashtu kreditë me maturitet mbi 2 vite u rriten më shpejtë se kreditë afat-shkurtëra. Si pasojë, rritja e tërësishme e kredive kryesisht ndodhi si rezultat i kontributit pozitiv prej 20.6% të kredive me maturitet mbi 2 vite, përderisa kreditë me maturitet më të shkurtër kontribuan me vetëm 3.3% ndaj rritjes së përgjithshme të kredive.

Figura 15. Struktura e kredive dhe depozitave të afatizuara, sipas maturitetit, Dhjetor 2006




Burimi: AQBK (2007).

Kreditë kryesisht financohen nga depozitat afat-shkurtër (të transferueshëm dhe me maturitet deri në 1 vit) të cilat paraqesin 88.0% të tërësisë së depozitave. Megjithatë, depozitat e afatizuara dhe të kursimeve (depozitat tjerë përveç të transferueshëm) arrijnë shumën prej 615.5 milion euro duke mbuluar kështu 96.7% të shumës së tërësishme të kredive. Mëgjithëse në fund të vitit 2006 vëllimi i kredive tejkalon pakëz vëllimin e depozitave të afatizuara (Figura 6), raporti është duke u përmirësuar meqë në qershor 2006 depozitat e afatizuara mbulonin vetëm 84.0% të tërësisë së kredive.

Më një vlerë prej 926.4 milion euro, depozitat janë rritur për 10.7% në baza vjetore, që paraqet një rritje modeste krahasuar me 20.4% and 35.2% të vitit 2005, përkatësisht 2004. Megjithatë, duhet kujtuar se rritja e depozitave fillimisht është ndikuar nga adaptimi i euro valutës në vitin 2002, përderisa veprimtaria e huadhënies është zhvilluar hap pas hapi. Në vitin 2006, rritja e depozitave ishte më e ngadalëshme se rritja e kredive, veçanërisht gjatë gjysmës së parë të vitit, andaj raporti i kredive ndaj depozitave arriti kulmin prej 73.0% në Qershor 2006 (Figura 16). E kundërta ndodhi gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006 kur vëllimi i depozitave u rrit më shpejt se kreditë dhe raporti i kredive ndaj depozitave zbriti në 68.7%. Raporti qëndron brenda intervalit të vendeve rajonale, ku Mali i Zi ka raportin më të lartë të kredive ndaj depozitave prej 89.6% dhe Shqipëria më të ulët prej 28.3%.

Figura 16. Raporti i kredive ndaj depozitave, (2004-2006)



Burimi: AQBK (2007).


Depozitat në sektorin bankar kryesisht mbahen në valutën euro, e cila është valuta zyrtare në Kosovë. Megjithëse shuma e depozitave jo-euro është rritur për 16.6%, ajo ende paraqet vetëm 3.7% të tërësisë së depozitave. Për më tepër, bankat nuk japin kredi në valuta të tjera, andaj sistemi bankar i Kosovës nuk i nënshtrohet rrezikut ndaj kursit të këmbimit valutor.

Depozitat e sektorit vendor, posaçërisht të ekonomive familjare, vazhdojnë të jenë burimi kryesor i financimit të detyrimeve bankare me shumën prej 517.1 milion euro. Depozitat e ekonomive familjare janë rritur për 13.8% në vitin 2006 ndaj 2005, duke kontribuar pozitivisht me 7.5pp ndaj rritjes së tërësishme të depozitave. Për më tepër, depozitat e ekonomive shtëpiake kanë rritur paksa pjesëmarrjen e tyre ndaj tërësisë së depozitave në 55.8% nga 54.3% sa ishte në vitin 2005. Megjithëse KJF-të (kryesisht korporatat private) janë përfituesitë kryesor të kredive bankare depozitat e tyre janë duke u rritur më trend më të ngadalshëm. Rritja vjetore e depozitave të tyre ishte 6.3%, duke kontribuar më vetëm 2.4 pp ndaj rritjes së tërësishme të depozitave. Depozitat e KJF-ve publike arrijne shumën prej 217.6 milion euro dhe ishin tejet përpara atyre të korporatave private, të cilët arrinin vlerën prej 124.5 milion euro. Një depozitor i sektorit publik, kompania e telekomit të Kosovës, e cila ka rreth 20% të tërësisë së depozitave mban një peshë sistematike në sektorin financiar.

Kutia 1. Mjetet, kreditë dhe depozitat e sektorit bankar si përqindje e PBB-së në vendet e EJL

Sistemi Bankar i Kosovës krahasohet relativisht mirë me shtetet tjera të EJL-së sa i përket madhësisë dhe rolit ndërmjetësues të sistemit bankar. Raporti 47.7% i mjeteve ndaj PBB-së rradhit Kosovën afër mesatarës së EJL-së e cila qëndron afër 61.4%. Në mes vendeve të rajonit, Kroacia me 109% dhe Bullgaria me 74.1%, paraqesin shtetet më raportin më të lartë të mjeteve të sektorit bankar ndaj PBB-së, kurse raporti më i ulët është regjistruar në Mal të Zi ku mjetet totale të sektorit bankar përbëjnë 28.6% të PBB-së.

Figura 17. Mjetet, kreditë dhe depozitat totale të sektorit bankar në EJL, si % ndaj PBB-së



Burimi: Bisness Monitor International(2006); EBRD(2005).


*Shënim: Te dhënat për shtetet e EJL-ve janë nga viti 2005

Gjithashtu roli ndërmjetësues i sektorit bankar, i matur me anë të raportit të kredive dhe depozitave të sektorit bankar ndaj PBB-së, pozicionon sistemin bankar të Kosovës në nivel krahasues me vendet tjera të EJL-së. Me një raport prej 26.1% të kredive ndaj PBB-së, Kosova rradhitet pak përtej mesatares së rajonit e cila qëndron në 27.2%. Shteti i cili ka regjistruar nivelin më të lartë të ndërmjetësimit të sektorit financiar është Kroacia, ku pjesëmarrja e kredive në PBB llogaritet për 62.9%, përderisa raporti më i ulët është regjistruar në Shqipëri dhe Mal të Zi ku raporti i depozitave ndaj PBB-se është 14.7%, përkatësisht 15.7%.

Përveç kësaj, sistemi bankar i Kosovës krahasohet mirë me vendet tjera të rajonit edhe për sa i përket raportit të depozitave të tërësishme të sektorit bankar ndaj PBB-së. Në vitin 2006, raporti i tërësisë së depozitave ndaj PBB-së në Kosovë qëndron në 37.98% që është pak nën mesataren e rajonit që llogaritet për 43.6%. Megjithatë, nëse konsiderohen shtetet në bazë individuale, Kroacia (72.7%), Bullgaria (56.6%) dhe Shqipëria (51.9%) qëndronin më lartë se Kosova për sa i përket raportit të depozitave ndaj PBB-së. Raporti më i ulët i depozitave ndaj PBB-së është regjistruar në Mal të Zi ku tërësia e depozitave bankare llogaritet për 17.6% të PBB-së.

Normat e kamatës. Në fund të vitit 2006 normat e kamatës për depozitat qëndronin në 2.97%, përderisa normat e huadhënies qëndronin në 13.37% (mesatarja e nxjerrë përmes produkteve të ndryshme dhe maturiteteve të ndryshëm). Diferenca në normën e kamatës (kredi dhe depozitë) vazhdimisht është në rënie, nga 11.80% në und të vitit 2004 deri në 10.40% në fund të vitit 2006. Siç sqaron figura 18, shpërndarja e normave të kamatës për ekonomitë familjare është më e ulët sesa për korporatat. Më një mesatare nga 3.18%, normat e kamatës në depozita për ekonomitë familjare ishin përpara depozitave të normave të interesit të KJF-ve për 0.42 pp. Përderisa mesatarja e normave të kamatës në kreditë e ekonomive familjare ishin për 1.90 pp me ulët se sa normat e kamatës për kreditë e KJF-ve të cilat qëndronin në 14.32% në fund të vitit 2006.

Figura 18. Mesatarja e normave efektive të kamatës për kredi dhe depozita, (2004-2006)




Burimi: AQBK (2007).

Diferenca e normës së kamatës 10.40% është relativisht e gjërë dhe mund të sqarohet përmes kostos së lartë operacionale në sistemin bankar, vështiresitë në vlerësimin e rreziqeve të kredisë, koncentrimin e tregut, pritjet e larta mbi kthimin në bankat e jashtme dhe pasiguria ndaj qëndrueshmërisë ekonomike, për të mos përmendur mungesat në kornizën ligjore dhe mekanizmat e përforcimit.

Pasqyra e Suksesit. Treguesit të cilët janë arritur përmes pasqyrës së suksesit vënë në pah se sektori bankar në Kosovë ishte profitabil gjatë vitit 2006. Treguesit e fitimit mirëmbajnë shkallën e njëjtë me vitët e mëparshme. Më gjithatë, ka hapësirë për përmirësim të uljes së shpenzimeve administrative, të cilat vazhdojnë të jenë të larta.

Sektori bankar në Kosovë përmbylli vitin 2006 me neto fitimin prej 19.3 milion euro. Përderisa në vitin 2005 neto fitimi pas tatimit ishte vetëm 4.4% me i lartë sesa në vitin 2004, në vitin 2006 u rrit për 42.6%. Kjo ishte pjesërisht si rezultat i normës më të ngadalshme të rritjes së shpenzimeve në vitin 2006 (15.6%) krahasuar me normën e rritjes së të ardhurave (20.8%) dhe të menaxhimit të përmirësuar të rrezikut ndaj kredisë.

Figura 19. Neto të ardhurat e Bankave Komeriale, (2004-2006)



Burimi: AQBK (2007).

Totali i të ardhurave bruto të sektorit bankar arriti shumë më tej 113.9 milion euro në fund të vitit 2006. Fitimi i sektorit bankar është krejtësisht për shkak të të hyrave kamatore mbi veprimtaritë e huadhënëse. Nga Dhjetori 2006, të hyrat kamatore arriten shumë më tej 88.8 milion euro, ose një rritje vjetore 19.1%. Vëprimitaria kreditore paraqet pothuajse 90.0% të të hyrave nga të hyrat kamatore i sektorit bankar (ose 69.7% të totalit të të hyrave), dhe 10.0% paraqet të hyrat nga plasmanet në bankat tjera dhe investimet në letrat më vlerë. Nga veprimtaritë jo të lidhura me kamatën, gjeneratori i të ardhurave janë provizionet më pjesëmarrje nga 90.0% në gjithsej të hyrat jokamatore (ose 19.7% e totalit të të hyrave).

Në vitin 2006 shpenzimet e sektorit bankar arriten shumë më tej 90.1 milion euro. Përderisa të hyrat kryesisht gjenerohen nga veprimtaritë e lidhura me kamatën, shpenzimet janë kryesisht të lidhura me veprimtaritë jokamatore, siç janë provizionet për humbjet e kredive dhe shpenzimet e përgjithshme dhe administrative. Shpenzimet kamatore, kryesisht kamata e cila u paguhet depozitorëve, - llogaritet për 20.0% të gjithsej shpenzimeve. Shpenzimet jokamatore (përveç shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative) kryesisht përbëhen nga provizionet për humbjet e kreditë të cilat grumbulluan shumë më tej 16.0 milion euro në fund të vitit 2006 (rreth 19.4% më tepër se në vitin 2005). Shpenzimet tjera jokamatore lidhen me amortizimin e mjeteve fikse të cilat kapin shumë më tej 5.6 milionë euro. Më gjithatë, më shumë se gjysma e gjithsej shpenzimeve janë shpenzimet e përgjithshme dhe administrative (rreth 53.7%). Këto shpenzime kanë qënë më të larta gjatë vitit 2006, sidoqoftë rritja e tyre është më e qetë se sa gjatë vitit 2005 kur ato janë llogaritur për 56.2% të totalit të shpenzimeve. Ky është një zhvillim pozitiv, nëse marrim në konsideratë zgjerimin e arritur të sektorit bankar në lidhje me personelin, rrjetine degëve, etj.

Treguesit e performancës. Një rritje e shpejtë e fitimit pas tatimit prej 42.6% dhe një rritje më e ngadalshme e mjeteve prej 20.8%, përmirësoi kthimin mesatar në mjete (ROAA) të sektorit bankar në 1.8% në vitin 2006. Kthimi mesatar në kapitalin aksionar (ROAE) ka arritur kulmin prej 23.1% i cili është më i larti krahasuar me shtetet në rajon (Kutia 2). Kjo rritje në ROAA dhe ROAE rezulton nga fitimet e tri bankave, në mesin e të cilave dy janë të huaja.

Tabela 7. Treguesit e performancës së bankave, në %, (2002 – 2006)


Përshkrimi	2002	2003	2004	2005	2006
Kthimi ne mesataren e aseteteve (ROAA)	0.60	1.30	1.90	1.50	1.80
Kthimi ne mesataren e ekuitetit (ROAE)	9.70	18.80	22.60	20.10	23.10
Margjina neto e interesit	3.00	4.30	5.40	6.00	5.90
Efikasistet I shpenzimeve	4.00	4.30	4.20	4.50	4.20

Burimi: AQBK (2007).

Kutia 2. Profitabiliteti i sektorit bankar në shtete të zgjedhura të EJL-së*

Sa u përket treguesve të profitabilitetit, Kosova rradhitet mbi mesataren e rajonit për nga Kthimi Mesatar në Mjete dhe Kthimi Mesatar në Kapital Aksionar. Në vitin 2006, Kosova regjistroi ROAA prej 1.8%, përderisa mesatarja e rajonit ishte 0.8%. Duke marr shtetet individualisht, Bullgaria regjistroi ROAA prej 1.8% njëjtte sikurse Kosova. Kthimi me i ulët është regjistruar në Mal të Zi me një Kthim negativ prej -0.3%.

Figura 21. Treguesit e Profitabilitetit në SEE*



Burimi: Business Monitor International (2006); EBRD (2005).

*Shënim: Të dhënat për shtetet e EJL janë për vitin 2005

Për sa i përket raportit të ROAE, Kosova udhëheq me normën më të lartë prej 23% krahasuar me shtetet tjera të rajonit të cilat regjistruan ROAE prej 6.5%. Brenda shteteve të rajonit, Shqipëria regjistroi normën më të lartë të ROAE (17.9%), kurse norma më e ulët është regjistruar në Mal të Zi (-1.2%).

Në fund të vitit 2006, Margjina Neto e Interesit (MNI), e cila paraqet raportin e të ardhurave neto nga interesi ndaj gjithsej mjeteve, arriti normën prej 5.9% - e cila është e krahasueshme me vitin 2005 dhe më e lartë se në periudhat e mëparshme. Të ardhurat neto nga interesi dhe tërësia e mjeteve, gjatë vitit 2006 kishin një rritje të ngjashme me vitin 2005 (16.5% dhe 18.2%). MNI është dukshëm më e lartë se në shtetet në rajon (Kutia 3), që mund të jetë si rezultat i një difference mjaft të lartë të normës së interesit për kredi dhe depozita në Kosovë si dhe të performancës së mirë të institucioneve më të mëdha bankare.


Treguesi i efikasitetit të shpenzimeve, i matur si raport i shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative ndaj tërësisë së mjeteve, u përmirësua duke rënë prej 4.5% në vitin 2005, në 4.2% në vitin 2006, si rezultat i rritjes më të ngadalshme të shpenzimeve. Mëgjithatë, për shkak të nivelit

aktual relativisht të lartë, shpenzimet administrative pritet të ulen në të ardhmën, duke pasur parasysh strukturën e tanishme të sektorit bankar ku shpenzimet administrative kryesisht lidhen me shpenzimet fikse fillestare dhe zgjerimit të degëve. Për më tepër, ristrukturimi i vazhdueshëm i bankave vendore mund gjithashtu të sjellë një kontroll më të mirë të shpenzimeve operative.

Kutia 3. Efikasiteti i Sektorit Bankar në shtetet e zgjedhura të EJL-së

Sektori bankar i Kosovës regjistroi një MNI prej 5.9% e cila është mbi mesataren e rajonit që ishte 3.8%. Sipas këtij treguesi, vetëm bankat në Mal të Zi qëndruan në pozitë më të avancuar se Kosova, duke regjistruar një normë prej 6.1%. MNI më i ulët është regjistruar në sistemin bankar të Shqipërisë (2.7%).

Figura 22. Treguesit e efikasitetit në EJL*



Burimi: Business Monitor International (2006); EBRD (2005).

*Shënim: Te dhënat për shtetet e EJL-së janë për vitin 2005

Në anën tjetër, sistemi bankar i Kosovës regjistroi rezultate më pak të favorshme për sa i përket efikasitetit të shpenzimeve krahasuar me mesataren e rajonit. Sistemi bankar i Kosovës regjistroi një normë të shpenzimeve ndaj tërësisë së mjeteve prej 4.2%, përderisa mesatarja e rajonit ishte 3.9%. Bankat me efikase për sa i përket shpenzimeve ishin bankat në Shqipëri (1.8%), kurse ato më pak efikase ishin bankat në Bosnjë e Hercegovinë (5.8%).

Në përgjithësi, portofolio i kredisë së bankave komerciale mund të vlerësohet i një kualiteti të mirë. Përderisa në vitin 2005, kreditë e pa arkëtuara janë llogaritur për 8.48% të totalit të kredisë, në vitin 2006 ato paraqesin vetëm 7.34%. Megjithatë, shumica bruto e kredisë të pa arkëtuara, (të cilat janë elementi kryesor i mjeteve të rrezikuara) është rritur, pasi ato janë llogaritur për 4.12% të tërësisë së kredisë në vitin 2006, krahasuar me 2.01% në vitin 2005. Kjo rritje është pjesërisht për shkak të riklasifikimit të mjeteve përcaktuar nga AQBK-ja duke u bazuar në inspektimet në vend (on-site). Pas provizionit, shumica neto e kredisë të pa arkëtuara është vetëm 3.5 milion euro. Gjendja e kredisë të pa arkëtuara në sektorin bankar të Kosovës duket më e favorshme krahasuar me shtetet në rajon (Tabela 8). Kjo mund të jetë pasojë e mungesës së borxheve të trashëguara nga ish-ekonomia socialiste, politikat e matura të huadhënies të zbatuara gjatë viteve të fundit, pesha më e madhe e aktorëve me performancë të mirë, dhe mbikëqyrja e matur.

Tabela 8. Kreditë e pa arkëtuara si përqindje e totalit të kredive, në shtetet e EJL-së *

Vendi		Kreditë jo-performuese, në % te total kredive
Shqipëria		2.3
Bulgaria		3.8
Kroacia		7.2
FYROM		22.2
Serbia		23.8
Bosna dhe Hercegovina		5.4
Mali I Zi		na
Kosova	2005	2.0
	2006	4.1


Burimi: EBRD (2006) dhe AQBK (2007).

Shënim: Te dhënat për shtetet e EJL janë të vitit 2005

Likuiditeti dhe Mjaftueshmëria e Kapitalit. Treguesit përkatës sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës është likuid dhe solvent. Rregulla e reviduar bankare XXI ka paraparë që deri me 31 Dhjetor 2006, bankat të rrisin kapitalin minimal të paguar në 5.0 milion euro. Pra, totali i kapitalit të sektorit bankar në fund të vitit 2006 ishte për 33.6% më i lartë se në fund të vitit 2005.

Mjetet likuide të sektorit bankar arritën shumën prej 486.1 milion euro ose 11.3% më shumë se në vitin 2005. Megjithatë, rritja e përgjithshme e kredive, kryesisht e shkaktuar nga rritja e kredive, në mënyre evidente ndikoj në rënien e mjeteve likuide në raport me mjetet e gjithëmbarshme nga 44.4% në fund të vitit 2005, në 41.8% në fund të vitit 2006. Sidoqoftë, pozita e likuiditetit të sektorit bankar mbetet adekuate. Struktura e komponentëve të ndryshëm të mjeteve likuide mbetet e ngjashme. Mjetet likuide më të përfaqësuara mbeten mjetet e investuara në bankat e jashtë vendit, që përbëjnë 50.0% të totalit të aseteve likuide, përderisa paraja e gatshme dhe mjetet në AQBK-në përbëjnë 29.5% të totalit të aseteve likuide. Siç tregon Figura 20, rënia e shpejtë e likuiditetit në vitin 2002 dhe 2003 është përcjellë me një ulje të ngadalësuar në raport me rritjen signifikante të aktivitetit huadhënës të sektorit bankar.

Figura 20. Treguesit e Likuiditetit dhe Solventitetit, (2002 – 2006)




Burimi: AQBK (2007).

Përpos që sektori bankar në Kosovë është likuid, ai është edhe solvent. Në fund të vitit 2006 raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (kapitali rregullator ndaj mjetëve të rrezikuara) arriti shkallën prej 16.7%, krahasuar me vitin 2005 që ishte 14.7%. Kjo është mbi minimumin e kërkuar prej 12.0% i cili është përcaktuar në Rregullën mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit (RMK) e aplikuar në Kosovë. Kjo rritje ishte si rezultat i rritjes më të shpejtë të kapitalit në krahasim me rritjen e mjeteve të rrezikuara (MR). Gjithashtu kapitali rregullator (i nivelit të parë) llogaritet të jetë 14.5% e MR, që është substancialisht më lartë se shkalla prej 8.0% e definuar në rregullën bankare I. Kapitali i gjithëmbarshëm (i nivelit të parë dhe dytë) në fund të vitit 2006 arriti shumën 117.2 milion euro (33.6% më shumë se në vitin 2005), si pasojë e rritjes së kapitalit minimal të të gjitha bankave në 5 milion euro, e caktuar në rregullën e reviduar bankare XXI të AQBK-së, të shoqëruar me rritje të rregullt të kapitalit në harmoni me rritjen e aktivitetit.

Kutia 4. Likuiditeti dhe RMK e sektorit bankar në shtetet e zgjedhura të SEE-së

Me një normë prej 68.7% raporti i kredive ndaj depozitave në Kosovë rradhitet pak mbi mesataren e rajonit nga 63.9%. Norma më e lartë është regjistruar në sistemin bankar të Malit të Zi, ku raporti i kredive ndaj depozitave ishte 89.6%. Kurse Shqipëria regjistroi raportin më të ulët të kredive ndaj depozitave (28.3%) e cila është si pasojë e ndërmjetësisë së ulët të sistemit bankar.

Figura 23. Raporti i kredive ndaj depozitave në EJL *



Burimi: Business Monitor International (2006); EBRD (2005).

*Shënim: Te dhënat për shtetet e EJL janë për vitin 2005

Kosova më një normë të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 16.7% rradhitet më ulët se mesatarja e shteteve tjera në rajon të cilat kishin normë prej 23.1%. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për Kosovën është me i ulta në rajon, kurse më e larta është në Mal të Zi.

3.3.3 Zhvillimet në Kompanitë e Sigurimeve

Përveç bankave komerciale në Kosovë, një komponent tjetër më rendësi i korporatave financiare janë kompanitë e sigurimeve. Megjithëse, me një shumë të mjeteve prej 62.9 milion euro, sektori i sigurimeve përbën 5% të totalit të mjeteve të sektorit financiar. Në fund të vitit 2006 operonin nëntë kompani të sigurimeve në Kosovë. Gjashtë kompani janë kryesisht me kapital të jashtëm kurse tri janë me kapital plotësisht vendor. Si pasojë, ngjajshëm me sektorin bankar, kapitali i jashtëm është dominues në industrinë e sigurimeve duke menaxhuar pothuajse 70.0% të tërësisë së mjeteve (Tabela 9).

Tabla 9. Struktura pronësore e mjeteve në sektorin e sigurimeve, në mijëra euro (2004 – 2006)

Përshkrimi	Dhjetor2004		Dhjetor2005		Dhjetor 2006	
	Vlera	Aksione (%)	Vlera	Aksione(%)	Vlera	Aksione (%)
Kompanitë e sigurimeve me kapital të huaj	25,916	59.2	33,279	61.1	43,795	69.5
Kompanitë e sigurimeve me kapital vendor	17,881	40.8	21,144	38.9	19,176	30.5
Gjithsej mjetet	43,797		54,423		62,971	

Burimi: AQBK (2007).

Depozitat e sektorit të sigurimeve në korporatat depozitare (AQBK dhe bankat komerciale) arritën shumën prej 45.3 milion euro, ose 26.6% më shumë se në vitin 2005. Në veçanti, në vitin 2006, kompanitë e sigurimeve rritën depozitat e tyre në banka (për 34.8%). Si pasojë, mjetet neto të jashtme zbritën në vetëm 25,000 euro nga 3.5 milion euro në fund të vitit 2005.

Veprimtaria themelore e kompanive të sigurimeve në Kosovë është produkti i Përgjegjësisë ndaj Palës së Tretë (PPT), që do të thotë policat e automjeteve të siguruar. Premiumet e pranuar kryesisht akumulohen nga policat PPT (rreth 71.2%), përderisa të tjerat vijnë nga polisat kufitare dhe polica të tjera (jo PPT). Veprimtaria e sigurimeve përjetoj tendencën e njejtë sikurse në vitet e mëparshme – shuma e kërkesave të paguara ndaj klientëve në krahasim më premiumet e pranuar ende mbetet e ulët. Mëgjithatë, raporti u përmiresua pak në 22.4% nga 19.4% në vitin 2005. Shuma e premiumeve totale të pranuar në vitin 2006 ishte 48.7 milion euro, vetëm 3.2% më tepër se në vitin 2005. Kjo është një shenjë që tregu i PPT-se tani është më i zhvilluar, me një numër të vogël të automjeteve jo të siguruar. Në të vërtetë, me rreth 408,500 polisa të shitura në vitin 2006, rritja vjetore ishte vetëm 32,914 polisa më tepër.

Krahasuar me shumën e paguar të premiumeve bruto prej 48.7 milion euro në vitin 2006, shuma e paguar e kërkesave të klientëve arrin vlerën prej 10.9 milion, që tregon një raport prej 22.4% të kërkesave të paguara ndaj premiumeve. Duhet theksuar se në vitin 2006 shuma e kërkesave të paguara ishte për 19.3% më e lartë sesa në vitin 2005. Rreth 90.0% e tërësisë së kërkesave të paguara ishin lidhur më polisat PPT, përderisa kërkesat mbi polisat kufitare dhe polisat tjera (jo PPT), u llogariten për 10.0% të tërësisë së kërkesave të paguara.

Zhvillimet në Fondet Pensionale

Me një shumë prej 10.5 milion euro, fondet pensionale në Kosovë kanë pjesëmarrje vetëm me 1.0% të totalit të mjeteve të sektorit financiar. Kjo shumë përfshin vetëm mjetet e skemave suplementare – pensionet e ofruara nga punëdhënësit për punonjësitë, përveç kontributeve të detyrueshme për

Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) i cili është 'fond i sigurimit shoqëror'. Megjithatë, gjatë vitit 2006, të gjashtë fondet pensionale suplementare të cilat operonin brenda korporatave të ndryshme publike ndaluan veprimtarinë aktive, si pasojë e ndërprerjes së veprimtarisë në bazë vullnetare dhe jo vullnetare. Kjo ishte ose për shkak të shumave të larta të detyrimeve jo te financuara, ose për shkak të dështimit (ose ndryshimit të kapitalit) të kompanisë kontribuese. AQBK-ja me vet-iniciativë, apo sipas kërkesës se çdo kompanie kontribuese, revokoi licencën dhe caktoi zyrtarin përgjegjës për likuidim. Në fund të procesit të likuidimit, mjetet e mbledhura nga ish fondet e ndryshme pensionale do të transferohen tek fondet tjera pensionale, ose në raste të veçanta, do të transferohen tek llogaritë e peng mbajtjes të hapura në bankat komerciale në emër të çdo pensionisti. Për sa u përket të drejtave të vogla pensionale, ato pritet tu paguhen përfituesve të tyre. Në anën tjetër, në Nëntor 2006, Bordi Drejtues i AQBK-se i lëshoi licencën një fondi suplementar privat të pensioneve "Fondi Slloveno-Kosovar" i cili gjithashtu do të veproj si menaxher i aseteve për fondet e akumuluar. Ky është fondi i parë privat pensional i licencuar në Kosovë.

Kutia 5. Fondet e Pensioneve të cilat veprojnë në Kosovë dhe ndarja e tyre

Skemat e pensionit në Kosovë klasifikohen si më poshtë:


- 1) Pensioni bazë (skemë e detyrueshme) – Paguhet nga Administrata e Pensionit, dhe financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, i cili paguan një shumë prej 40 euro për çdo banorë të Kosovës i cili është më i vjetër se 65 vjeç.
- 2) Pensioni i kursimeve individuale (skemë e detyrueshme) – e administruar nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), dhe financiar nga kontributet minimale të detyrueshme të punëdhënësve dhe punonjësve (5% secili).
- 3) Skemat suplementare – të cilat përbëhen nga: a. *Pensionit i Kursimeve Individuale* (është kontribut vullnetar shtesë i paguar nga punëdhënësi ose punonjësi, ose nga të dy, dhe i cili administrohet nga TKPK); b. *Pensionet Suplementare të Punëdhënësve* (ofruar nga punëdhënësi për punonjësit); c. *Pensionet Suplementare Individuale*, dhënë për personat fizik nga siguruesit e licencuar të pensioneve.

3.3.5. Zhvillimet në Ndërmjetësitë e Tjerë Financiarë

Përveç bankave komerciale, ndërmjetësitë tjerë financiarë (NTF) janë gjithashtu të përfshir në veprimtarinë e huadhënies në ekonomi. NTF-të janë institucione mikro financiare të cilat nuk kanë të drejtë të marrin depozita mbi një shumë të kufizuar. Veprimtaria e tyre kryesore është veprimtaria e huadhënies, kryesisht si mbështetje për ndërmarrësitë e vegjël. Burimi kryesor i financimit të NTF-së mbeten donatorët e jashtëm.

Në fund të vitit 2006, gjashtëmbëdhjetë NTF operonin në Kosovë, të cilët administronin rreth 5.0% të totalit të mjeteve të sektorit financiar. Nga fundi i vitit 2006, portofolio total i kredive të NTF-së arriti shumë kumulative nga 57.7 milion euro, llogaritur për 8.3% të tërësisë së shumës kumulative të kredive të lëshuara korporatave financiare (KF-të). Megjithatë, në lidhje me numrin e kredive, NTF-të llogarisin për 25.7% të numrit të kredive – duke treguar orientimin e tyre në mikrokredi. Në vitin 2002, përderisa sektori bankar kishte filluar veprimtarinë e tij të kredidhënies, kontributi i kredive të NTF-së për sa i përket tërësisë së kredive ishte jashtëzakonisht i lartë (27.0%), por më pas zbriti duke mbetur konstant së fundi (Figura 24).

Figura 24. Aktivitetet e huadhënies të ndërmjetësive tjera financiare



Burimi: AQBK (2007).

Në fund të vitit 2006, NTF-të mbanin 35,541 kredi në portfolion e tyre e cila shifër tregon 8,418 kredi më tepër se në fund të vitit 2005. Shuma mesatare për kredi ishte 1,622 euro, e që ishte më ulët se në vitin 2005 (që arrinin shumën prej 1,906 euro).

3.4. Sektori i Jashtëm

Ne vitin 2006, për herë të parë AQBK-ja përpiloi dhe botoi bilancin e pagesave të Kosovës. Sipas vlerësimeve (te dhënave para-përfundimtare), deficiti i llogarisë rrjedhëse (pas asistencës së huaj) shënoj 393.0 milion euro. Kjo ishte kryesisht për shkak të bilancit të lartë negativ në kategorinë e mallrave dhe të shërbimeve (-1,236,8 milion euro në vitin 2006), pavarësisht nga të hyrat e konsiderueshme në transfertat rrjedhëse (që arrin shumën prej 808.5 milion euro në vitin 2006). Në krahasim me PBB-në, deficiti i llogarisë rrjedhëse pas asistencës së huaj mbetet i lartë në 17.3% të PBB-së në vitin 2006, krahasuar me 11.9% në vitin 2005. Para asistencës së huaj, ky deficit është shumëfish më i lartë (44.2% të PBB-së në vitin 2006), duke theksuar varësinë e ekonomisë së Kosovës në drejtim të sektorit të donatoreve.

Aktualisht, me një rritje nga 10.2% krahasuar me vitin 2005, bilanci i mallrave dhe shërbimeve arrin shumën prej -1.2 miliard për vitin 2006, i cili paraqet një deficit rreth 50% të PBB-së. Si në vitet e mëparshme, deficiti tejet i madh i llogarisë rrjedhëse me të cilin është përballur Kosova është për shkak të deficitit të lartë tregtar. Me eksporte të mallrave (pas rregullimit për mbulime) që arrin shumën rreth 100 milion euro dhe importet të cilat arrin shumën prej 1.3 miliard euro, mbulesa e eksporteve ndaj importeve qendrojnë në 8.1%, duke paraqitur një përmirësim krahasuar me vitet e mëparshme. Megjithatë, duke pasur parasysh bazën e ulët, në vitin 2006 eksportet e Kosovës u rritën me 42.4% kundër rënies prej 10% në vitin 2005, përderisa importet në vitin 2006 u rritën me 15.2%.

Tabela 10. Bilanci i Pagesave të Kosovës (2004-2006), Në miliona euro


Përshkrimi	2004	2005	2006
1. LLOGARIA RRJEDHËSE	-201.0	-266.7	-393.1
A. Mallrat dhe shërbimet	-1,047.3	-1,122.2	-1,236.8
Mallrat	-944.9	-1,021.7	-1,158.3
Kredi	79.0	71.4	101.7
Debi	-1,024.0	-1,093.1	-1,260.1
Shërbimet	-102.4	-100.5	-78.5
Kredi	132.0	128.6	141.1
Debi	-234.3	-229.1	-219.6
B. Të hyrat	22.7	29.7	35.2
Kredi	42.3	51.5	67.1
Debi	-19.5	-21.9	-31.9
C. Transferet rrjedhëse	823.6	825.9	808.5
Kredi	987.3	980.9	931.2
Debi	-163.7	-155.0	-122.7
2. Llogaria financiare dhe e kapitalit	146.2	78.4	42.5
A. Ilogaria e kapitalit	7.0	4.5	3.3
Kredi	7.0	4.5	3.3
Debi	0.0	0.0	0.0
B. Llogaria financiare	139.3	73.9	39.2
Investimet direkte	21.0	59.1	266.3
Portfolio investimet	-162.2	-67.8	-127.7
Investimet tjera	282.2	110.6	-104.3
Mjetet rezervë	-1.8	-28.0	4.9
GABIMET DHE HARRESAT NETO	54.8	188.3	350.7

Burimi: AQBK (2007).

1/ Paratë e dërguara si dhe të dhënat e sektorit të donatorëve janë marë nga IMF Aide Memoire(Shkurt 2007)

Për sa i përket strukturës së eksporteve, rritja me e madhe është regjistruar në kategorinë e produkteve ushqimore, e cila është një shenjë pozitive dhe pasojë e fillimit të prodhimit në kompanitë e mëdha të privatizuara. Me saktësisht, eksporti i produkteve ushqimore të vitit 2006 arriti shumën 15.8 milion euro krahasuar me 3.2 milion euro në vitin 2005. Si e tillë, produktet minerale zgjeruan pjesëmarrjen e tyre ndaj shumën e tërësishme të eksporteve në 20.0% në vitin 2006, nga 6.6% në vitin 2005 (Grafiku 25). Metalet baze megjithëse u rriten me 9 milion euro në vitin 2006, për shkak të rritjes së shpejtë në kategoritë tjera, pjesëmarrja e tyre në shumën e tërësishme të eksporteve u zvogëluar në 42% (nga rreth 50% në 2005). Për më shumë, metalet baze dhe produktet ushqimore përbëjnë rreth 60% të eksporteve të Kosovës. Lëkurat dhe të ngjashme, përbëjnë kategorinë e tretë më të madhe në kuadër të strukturës së eksporteve.

Figura 25. Eksportet dhe Importet sipas grupmallrave, si pjesëmarrje në shumën e tërësishme, nga viti 2006



Burimi: AQBK (2006).

Produktet ushqimore, të cilat llogariten 18.5% të gjithëjimporteve, u rriten me 31 milion euro në vitin 2006 në krahasim me 39.5 milion euro në vitin 2005. Ajo çka verëhet, është rritja e importeve të makinerisë (kryesisht paisjet) të cilat arrin 156.0 milion në vitin 2006. Kështu që, importet e makinerisë dhe të ngjashme lidhur rritën pjesëmarrjen e tyre në shumën e tërësishme të importit në rreth 12%. Duke përbërë rreth 13% të importeve në vitin 2006, importet e produkteve ushqimore të përgatitura u rritën me 5 milion euro, duke treguar një zëvendësim të vazhdueshëm të mallrave vendore të prodhuara ndaj atyre të importuara. Pas rritjes substanciale në vitin 2005 kryesisht për shkak të importit të automjeteve të përdorura me 60 milion euro (të cilat qëndronin në 99.4 milion euro) në 2006 kjo kategori u zvogëloi për 11 milion euro.


Shtetet në rajon⁸ janë partnerët kryesor tregtar të Kosovës, me eksporte të cilat arrin shumën prej 41.8 milion euro (52.8% të eksporteve) dhe importet me 576.7 milion euro (43.9% të importeve). Pavarësisht nga rënia e eksporteve nga IRJM me 1.4 milion euro, në vitin 2006 eksportet e Kosovës në shtetet në rajon u rritën me 14.8 milion euro, kryesisht nga rritja e eksporteve në Serbi dhe Mal të Zi (7 milion euro), Shqipëri (5.3 milion euro) dhe Bullgaria (3.2 milion euro). Duke qëndruar në 260 milion euro, importet nga IRJM në vitin 2006 gjatë vitit 2005 janë me të lartë për 40 milion euro, duke u ngadalësuar nga rritja me 70 milion euro në vitin 2005 gjatë vitit 2004. Përderisa eksportet, duke u ulur me 1.4 milion euro, qëndruan në 8.2 milion euro në vitin 2006.

Përveq shteteve në rajon, shtetet e BE-se janë partnerët e dytë me të mëdhej tregtar të cilët paraqesin 28.4% të eksporteve dhe 34.7% të importeve. Në vitin 2006, përkundër vitit 2005, importet nga BE-ja qëndruan porthuajse në të njëjtin nivel, përderisa eksportet u rritën me 29.2% të drejtuar kryesisht nga rritja e eksporteve ndaj Sllovenisë. Partneri tjetër tregtar (për sa i përket eksporteve) është Zvicra. Duhet cekur fakti se përderisa eksportet në këtë shtet në vitin 2005 shënuan vetëm 0.7 milion euro, në vitin 2006 ato në mënyrë të shpejtë u rritën duke arritur në 7.4

⁸ Shqipëria, Bullgaria, Bosna dhe Hercegovina, Kroacia, IRJM, Mali i Zi dhe Serbia.

milion euro. Importet nga Zvicra ne vitin 2006 arriten shumën 23 milion euro nga 18.7 milion euro ne vitin 2005. Veçmas nga ajo qe u përmend me lartë, importet nga Turqia dhe Kina ne shumë prej 90.4 milion euro dhe 75.5 milion euro secila, ne vitin 2006 u rriten me rreth 25 milion euro se bashku.

Figura 26. Eksportet dhe Importet sipas shteteve, viti 2006



Burimi: AQBK (2006).

Llogaria e te ardhurave për vitin 2006 qendroj ne 35.3 milion euro, krahasuar me 29.7 milion eur, një vit me pare. Rritja e vazhdueshme është kryesisht për shkak te rritjes ne anën kredi, duke arritur shumë prej 67.1 milion euro përdërisa zëri kryesor paraqet fitimetnga investimet ne tregjet e jashtme financiare, te dominuara nga investimet e TKPK-se. Një tjetër element ne anën kredi janë pagat e stafit lokal te KFOR-it dhe zyrave ndërlidhëse ne Kosovë. Se bashku, ana kredi arrin shumë prej 67.1 milion euro. Për sa i përket anës debi, shuma totale e 31.8 milion euro përbehet kryesisht nga fitimet e ri-investuara nga korporatat financiare (bankat e jashtme komerciale dhe kompanitë e sigurimeve) duke arritur shumë prej 22.8 milion euro.

Transfertat rrjedhësepërveq mallrave dhe shërbimeve llogariten si një element i rendësishem ne bilancin e pagesave te Kosovës. Në vitin 2006, shuma e tërësishme e transfertave rrjedhëse arn në 808.5 milion euro, duke zbritur nga 825.9 milion ne vitin 2005. Zëri kryesor brenda transfertave rrjedhëse përbën paratë e dërguara nga punëtorët jashtë, për shkak te numrit te konsiderueshëm te Kosovareve te cilet jetojnë ne shtetet EJL-së, kryesisht ne Gjermani, Zvicra, Londer, etj. Për vitin 2006, paratë e dërguara nga punëtorët jashtë llogariten 424.4 milion euro. Duke marr parasysh prezencen ndërkombëtare ne Kosovë, dhe fakti se ka dalje te parasë nga ekspatriatet (stafi i huaj që punon në Kosovë), shuma neto e remitancave llogaritet diku rreth 300 milion euro. Veçmas nga kategoritë e përmendura me lartë, transfertat rrjedhëse përfshine gjithashtu donatorët (185 milion euro) dhe buxhetin e UNMIK-ut (250.8 milion euro).

Pavarësisht nga te ardhurat e konsiderueshme ne investimet direkte, duke pasur parasysh daljet e mëdha (investimet jashtë) në formë portfolio dhe investimet tjera, llogaria kapitale dhe financiare e Kosovës qendroj ne 42.5 milion euro ne vitin 2006 nga 78.4 milion euro ne vitin 2005. Si pasojë e

procesit të privatizimit, investimet e huaja direkte ne Kosovë përbëjnë 266.3 milion euro, nga 59.1 milion euro në 2005. Megjithatë, ndikimi ekonomik i këtyre shumave ne bilancin e pagesave të Kosovës është i kufizuar meqenëse kjo është zbutur nga shuma përfërsisht e njëjtë e rritjes së mjeteve të huaja neto.

4. Mbikëqyrja Financiare

4. Mbikëqyrja Financiare

AQBK-ja ka autoritet rregullator dhe zbatues për të gjitha institucionet financiare në Kosovë, si dhe merr pjesë në zhvillimin dhe modernizimin e sektorit financiar, i cili aktualisht mbulon industrinë bankare, industrinë e sigurimeve, fondet pensionale dhe institucionet tjera financiare (institucionet mikro financiare, institucionet financiare jo bankare, zyret e këmbimit të valutave dhe institucionet për transferin e parave).

Synimi i AQBK –se është që të këtë një mbikëqyrje financiare dhe një proces rregullator që është efikas, fleksibil dhe i cili promovon një sektor financiar konkurrues të bazuar në treg, duke zbatuar parimet më të mira të standardeve ndërkombëtare në zhvillimin e sektorit financiar.

Qasja e mbikëqyrjes së AQBK-së është zhvilluar në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare për mbikëqyrësit, duke filluar nga qasja e “bazuar në rregulla” në qasjen e “bazuar në rrezikun”, e formuluar sipas Principeve Themelore të Basel-it dhe Shtylla e 2 e Basel-it II për bankat, dhe një regjime të aftësisë paguese bazuar në rrezikun e cila është duke u adoptuar ndërkombëtarisht për kompanitë e sigurimeve.

Qasja e bazuar në rrezikun ka për qëllim që t'i mundësojë AQBK-së që në mënyrë të përshatshme të përdorë burimet e saj mbikëqyrëse në ato fusha me rrezik më të lartë, brenda institucioneve individuale financiare dhe sektorit financiar në përgjithësi. Mbikëqyrja bankare në bazë të rrezikut përqendrohet në aftësinë e menaxhmentit për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar rrezikun, kurse mbikëqyrja e sigurimit në baze të rrezikut përqendrohet në kërkesat e aftësisë paguese dhe krijon kornizë të matur e cila pasqyron në mënyrë me të saktë rreziqet e ndërmarr nga sigurvearit. Qëllimi është krijimi i një mbikëqyrje sa më efektive dhe të balancuar mirë të sektorit të sigurimit e cila do të sigurojë perspektivën e aftësisë paguese si dhe çeshtjet tjera me rendësi për mbikëqyrjen e sigurimeve të cilat mund të drejtojnë në liberalizimin e tarifave.

Në përputhje me legjislacionin që drejton funksionin e saj të paraparë me ligj (Rregulloret e UNMIK-ut 1999/21, 2001/25, 2005/20, dhe 2006/47), AQBK-ja ka vendosur standarde dhe kërkesa mbikëqyrëse të hollësishme në mënyrë që të arrijë një sektor financiar të rregulluar mirë. Gjithashtu, këto Rregulloret i japin Bordit Drejtues të AQBK-së autoritet për të adoptuar rregulla prudente të mbikëqyrjes, të cilat përcaktojnë limitet, direktivat operuese, procedurat dhe kërkesat raportuese për institucionet financiare, si dhe masat zbatuese në rast mospajtueshmërie me kërkesat ligjore ose për shkak të praktikave të pasigurta dhe pa shëndosha.

Rregulloret e institucionit financiar dhe rregullat prudente vazhdimisht rishikohen dhe freskohen, për të siguruar që ato vazhdojnë të jenë në linjë me praktikën më të mira ndërkombëtare. Ato gjithashtu rishikohen për të siguruar që ato vendosin ekuilibrin e duhur në krijimin e një mjedisi të rregulluar mirë, pa vendosur ngarkesa të panevojshme për përdoruesit e shërbimeve financiare.

4.1 Veprimtaria Rregullative e Sektorit Financiar

Si rregullator, AQBK-ja merr pjesë në zbatimin e Rregulloreve përkatëse të UNMIK-ut. Korniza ligjore për drejtimin e këtyre veprimtarive në përputhje me standardet e BE-se është përshtatur në

nivelin aktual të zhvillimit të institucioneve financiare në Kosovë dhe gjithashtu është plotësuar me rregullat dhe vendimet e AQBK-se.

Korniza e rregullave të mbikëqyrjes financiare është krijuar në fillim të themelimit të AQBK-se, që nga ajo kohë sektori financiar ka ndryshuar, po ashtu ka ndryshuar edhe qasja e AQBK-së ndaj mbikëqyrjes. Bazuar në faktorët e lartpërmendur dhe rekomandimeve të asistencës teknike, mbikëqyrja financiare e AQBK-se ka punuar në mënyrë aktive për sa i përket rishikimit dhe plotësimit të kornizës së rregullave, dhe të themelimit të politikave dhe procedurave. Veç kësaj, për të udhëzuar industrinë financiare në implementimin e “praktikave më të mira”, AQBK-ja ka lëshuar “Letra Këshilluese” si referenca mbështetëse dhe plotësuese. Disa nga këto rregulla janë aprovuar nga Bordi Drejtues i AQBK-se dhe ato që kanë mbetur janë finalizuar në konsulltim me industrinë financiare të cilat do të prezantohen për aprovim Bordit Drejtues të AQBK-se gjatë vitit 2007.

Për më tepër, si rezultat i këtij procesi, gjatë vitit 2006 Bordi Drejtues i AQBK-se aprovoj këto rregulla të mbikëqyrjes se sigurimeve:

- o Përmirësimin e Rregullit V mbi mënyrat e shitjes së produkteve të sigurimit dhe licëncimin e detyrueshëm të operatorëve të sigurimit, dhe agjentet e sigurimit dhe borkerët.

- o Rregulla VIII mbi depozitim të aseteve si garancë, mjaftueshmërisë së kapitalit, raportimin financiar, menaxhimin e rrezikut, investimeve dhe likuiditetin. Si pasojë Rregullat Nr: VIII, IX, X, XI, XII, XIIa, XIII, XIV, XV, XVI, XIX, XX, XXIII dhe XXV janë anuluar.

4.2 Licencimi dhe Struktura

Ne përputhje me legjislacionin që drejton funksionin e saj statusor, AQBK-ja ka autoritetin për të vendosur kriteret për licencimin e institucioneve financiare dhe për të refuzuar ato të cilat nuk i përmbushin këto standarde.

Vizioni i AQBK-se është një sektor financiar i qëndrueshëm dhe i zhvilluar i drejtuar nga forcat e tregut, por që vepron brenda rregullativës prudente dhe kornizës së politikës së mbikëqyrjes të harmonizuar në bazë të direktivave të BE-se/ KE-se.

Strategjia e AQBK-se në fushën e licencimit të institucioneve financiare përqendrohet në tërheqjen e investitorëve të cilët kanë gjendje të mirë financiare, përmbushin kriterin e duhur dhe të përshtatshëm për aksionarë dhe menaxhment, janë të aftë që të drejtojnë një qasje në zhvillimin e matur të biznesit për të mbrojtur interesat e klientve, duke ndihmuar në këtë mënyrë në forcimin e sistemit financiar dhe rritjen e besueshmërisë ndaj tij.

Aktiviteti i licensimit të bankave nga AQBK gjatë vitit 2006 kryesisht ka qenë hapja e degëve të reja dhe ndryshimet në strukturat e pronësisë së bankave. Sidoqoftë, gjatë vitit 2006 Bordi Drejtues i AQBK-se aprovoj dy (2) licenca preliminare për degët e bankave me kapital të jashtëm (Banka Kombëtare Tregtare nga Shqipëria dhe Komercijalna Banka nga Serbia). Numri i bankave që operonin gjatë vitit 2006 ishte gjashtë, pas revokimit të licencës së Bankës Kreditore të Prishtinës –

BKP. Në fund të vitit 2006, në tërë Kosovën operonte një rrjet prej gjashtë bankave me 220 degë dhe nen-degë.⁹

Zyret e Këmbimit të Valutave dhe Zyret e Transferit të Parave. Gjatë vitit 2006 në AQBK janë regjistruar dhjetë zyre të këmbimit të valutave dhe një agjension i transferit të parave. Në fund të vitit 2006, operojnë në Kosovë 16 zyre të këmbimit të valutave dhe tri agjensione të transferit të parave. Krijta e madhe e numrit të zyreve të licensuara të këmbimit të valutave gjatë vitit 2006 është rezultat i fushatës së përbashkët i AQBK,

Policisë së UNMIK-ut, Shërbimit Policor të Kosovës dhe Qendrës Intelgjente Financiare në mënyrë që të legalizojnë agjentët e këmbimit të valutave të huaja në rrugë.

Institucionet Mikro Financiare. Në fund të vitit 2006 në Kosovë kanë operuar 15 institucione mikro financiare dhe tri institucione jo bankare financiare

Tabela 11: Aktiviteti i Licensimit të Bankave, 2002 – 2006

Përshkrimi	2002	2003	2004	2005	2006
Të Licensuara më parë	7	7	7	7	6
Aprovime Preliminare *	0	0	0	0	2
Revokim I Licencës	0	0	0	0	-1
Totali	7	7	7	7	8

Tabela 12: Aktiviteti i Licensimit të Institucioneve Jo Bankare Financiare, 2002 – 2006

Përshkrimi	2002	2003	2004	2005	2006
Të Regjistruara/Licensuara më parë	14	14	15	18	19
Regjistruara/Licensuara	0	1	3	1	1
Tërheqja e Regjistrimit	0	0	0	0	-2
Totali	14	15	18	19	18

Tabela 13: Aktiviteti i Licensimit të Agjensioneve të Transferit të Parave, 2002 – 2006

Përshkrimi	2002	2003	2004	2005	2006
Të Licensuara më parë	1	1	1	1	2
Licensuara	0	0	0	1	1
Totali	1	1	1	2	3

⁹ Shtesë 2006 – Në vijim të Rregullores 1999/21 të Misionit të Administrimit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara - UNMIK-ut, Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (AQBK), në kapacitetin e Autoritetit të Mbikqyrjes Bankare në baze të urdhërit të datës 13 Mars, 2006 ka revokuar licencën e Bankës Kreditore të Prishtinës. AQBK ka caktuar Z. Michael Rouswell si administrator të përkohshëm të Bankës Kreditore të Prishtinës, i cili ka marrë në mbikqyrje dhe udhëheqje operimet e Bankës Kreditore të Prishtinës në ora 8:00 para dite me 13 Mars, 2006

Tabela 14: Aktivitet e Licensimit të Zyreve të Këmbimit të Valutave, 2002 – 2006

Përshkrimi	2002	2003	2004	2005	2006
Të Licensuara më parë	3	3	4	3	6
Licensuara	0	1	0	4	10
Tërheqja e Regjistrimit	0	0	-1	-1	0
Totali	3	4	3	6	16

Kompanitë e sigurimit. Në fund të 2006, nëntë kompani të sigurimeve që nuk ofrojnë sigurime jetësore në Kosovë, tre prej këtyre kompanive janë degë të kompanive të huaja: një është nga Shqipëria) një kompani subsidiare nga Kroacia dhe një kompani nga Turqia. Një kompani e sigurimit e ka ndryshuar strukturën e pronësisë me një përbërje të re 49% kapital vendor dhe 51% të huaj. Tri kompanitë tjera janë kompani sigurimesh me pronësi vendore duke përfshirë kompaninë e re e cila filloj të operoj në vitin 2006.

Ndërmjetësuesit e sigurimeve. Kjo kategori përfshinë agjentët, brokerët e kategorive shtesë, dhe rregulluesit e dëmve (rregulluesit e dëmve nga kompanitë dhe rregullues të pavarur të dëmeve). Gjatë vitit 2006 numri i agjentëve është rritur nga 658 në 784, ku kategoritë të tjera kanë mbetur në nivel të njëjtë.

Fondet pensionale suplementare. Nuk ka fonde pensionale të licencuara në vitin 2006 ndërsa pesë fondet ekzistuese vullnetarisht kanë ndërprerë aktivitetin e tyre, duke e zvogluar numrin e këtyre fondeve nga gjashtë në një. Me vetë iniciativë, ose me kërkesë të secilës kompani kontribuese, AQBK-ja ka revokuar licensën e tyre, dhe ka caktuar likuidatorin e tyre.

Siguruesit e Fondeve Pensionale. Siguruesi i parë i fondeve pensionale është licencuar në Kosovë në vitin 2006. Bordi drejtues i AQBK-së ka lëshuar licencën për fondin pensional suplementar - 'Fondi Sloveno-Kosovar' - i cili poashtu operon si menaxher i aseteve për fondet e mbledhura.

Tabela 15: Veprimtaria e licencimit të kompanive të sigurimit, 2002 - 2006

Përshkrimi	2002	2003	2004	2005	2006
Të licencuara më parë	0	8	8	8	8
Të licencuara	8	1	2	1	1
Anuluara	0	-1	-2	-1	0
Total	8	8	8	8	9

Tabela 16: Veprimtaria e licencimit të ndërmjetësve të sigurimit, 2002 – 2006

Përshkrimi	2002	2003	2004	2005	2006
Agjentet	231	307	446	658	784
Brokeret e linjave shtesë	0	1	3	3	3
Broker	0	0	0	2	2
Korporatat e rregullimit të humbjeve	1	0	1	2	2
Rregulluesit e pavarur të ankesave	0	0	2	3	3

Tabela 17: Veprimtaria e licencimit të fondeve pensionale , 2002 – 2006

Përshkrimi	2002	2003	2004	2005	2006
Fondet pensionale suplementare	5	6	5	6	1
Siguruesit privat te fondeve pensionale	0	0	0	0	1

4.3 Veprimtaria e Mbikëqyrjes Financiare

Një nga funksionet kryesore të AQBK-së është që të sigurojë mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare, me qëllim të krijimit të një sistemi financiar të shëndoshë, të arritshëm si dhe konkurrues, i cili sistem është i besueshëm dhe ofron një sferë të gjerë të shërbimeve financiare. Në kryerjen e këtij misioni, Drejtoratet e Mbikëqyrjes së Bankave, Sigurimeve dhe Pensioeneve janë përgjegjës për licencimin, rregullimin dhe kontrollimin e institucioneve financiare dhe institucioneve jo bankare financiare që operojnë në Kosovë.

4.3.1 Mbikëqyrja bankare ka për qëllim mbrojtjen e fondeve të depozituesve dhe të mirëmbajë një sistem financiar stabil duke u kujdesur për një ambient efikas dhe konkurrues financiar. Drejtoriati i Mbikëqyrjes Bankare promovon këto qëllime përmes:

Sistemit të qëndrueshëm financiar bankar dhe Jobankar

Promovimi i një sistemi financiar të sigurtë, të shëndoshë dhe të qëndrueshëm është një nga arsyet themelore të mbikëqyrjes dhe rregullimit të institucioneve financiare. Një sistem financiar i qëndrueshëm iu siguron depozituesve një vend të sigurtë për të mbajtur paratë e tyre. Po ashtu u siguron bizneseve dhe individëve një kornizë të besueshme për kryerjen e transaksioneve monetare.

Sistemit konkurrues Financiar Bankar dhe Jobankar

Një qëllim tjetër kryesor i mbikëqyrjes dhe rregullimit të institucioneve financiare është krijimi i një sistemi konkurrues financiar . Një sistem konkurrues financiar iu siguron konsumatorëve produkte dhe shërbime financiare me çmime më të ulëta, mallra dhe shërbime më të mira financiare.

Sistemit të favorshëm Financiar Bankar dhe Jobankar

Një synim tjetër shumë me rëndësi i rregullimit është mbrojtja e konsumatorëve. Rregulloret dhe rregullat e përshtatshme kërkojnë që institucionet financiare të shfalojnë informatat që ju ndihmojnë konsumatorëve që të vlerësojnë opcionet e hapura të produkteve, siq është kostoja e kredisë , të drejtat e tyre dhe obligimet e mundshme, si dhe shkellën reale të kthimit në depozitat e tyre.

Rregullat e AQBK-së dhe rregulloret e UNMIK-ut drejtojnë shumë aspekte të institucioneve financiare bankare dhe jobankare. Çështje të tilla si: kush zotëron, kontrollon dhe administron institucionet financiare; çfarë vlere kreditimi mund t'i japin institucionet financiare një konsumatori

të vetëm ose grupe konsumatorësh; sa kapital duhet të kenë institucionet financiare; ku mund t'i vendosin institucionet financiare zyrat e tyre; dhe çfarë shërbimesh mund të ofrojnë ato, janë të gjitha çështje të rregulluara nga rregullat dhe rregulloret bankare dhe jobankare.

Objektivi kryesor i procesit të mbikëqyrjes është vlerësimi i sigurisë dhe efikasitetit të institucioneve financiare. Ky vlerësim përfshin vlerësimin e sistemeve të menaxhimit të rrezikut të institucionit, gjendjen financiare, portofolionë e kredisë si dhe pajtueshmërinë me rregullat dhe rregulloret e zbatueshme bankare dhe jobankare.

Procesi i mbikëqyrjes përfshin ekzaminimin në vend dhe ekzaminimin dhe monitorimin përmes analizës së jashtme. Në përgjithësi, stafi i AQBK-së kryen ekzaminime në vend të bankave dhe institucioneve financiare jobankare të paktën çdo 12 muaj. Kjo rutinë mund të mbështetet me ekzaminime më të shpeshta të "limituara", me qëllim të përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve të mëparshme.

AQBK-ja i ekzaminon veprimtaritë e institucioneve financiare përmes:

- Analizave të Jashtme – mbledhja e informacioneve (raporteve, informacioneve dhe të të dhënave, të cilat dorëzohen në AQBK-ja nga bankat dhe institucionet financiare jobankare), dhe vlerësimi i treguesve të operacioneve të tyre dhe krahasimi i tyre me limitet e përcaktuara, të dhënat e mëparshme dhe standardet e pranuar ndërkombëtare.
- Ekzaminimi në vend – Kryerja e vlerësimit cilësor të veprimtarive të të bankave dhe institucioneve financiare jobankare përmes kontrollit të të dhënave të tyre të brendshme duke përdorur qasjen e bazuar në rrezik.

Në mbikëqyrjen e institucioneve financiare përmes analizave të jashtme, AQBK-ja përdor analiza të vazhdueshme të cilat ndihmojnë në zbulimin e trendeve të padëshirueshme që zhvillohen në institucionet financiare dhe në industrinë financiare. Ky informacion mundëson që AQBK-ja t'i drejtojë më mirë burimet e saj ekzaminuese në ato institucione që kanë nevojë për vëmendje mbikëqyrëse.

Ekzaminimi në vend është faza e mbikëqyrjes për gjetjen e fakteve. Faktet analizohen për të përcaktuar gjendjen e institucionit financiar. Këto të gjetura përmblihen në Raportin e Ekzaminimit. Duke i përdorur këto fakte, përcaktohet profili i rrezikut të institucionit financiar, i cili përcakton mënyrën sesi do të trajtohet institucioni nga mbikëqyrësit gjatë ciklit të ardhshëm mbikëqyrës.

Ekipi i ekzaminimit në vend i AQBK-së kryen vlerësimet në thellësi të fushëveprimit të politikave formale, procedurave dhe praktikave të cilat janë përdorë nga institucionet financiare për të menaxhuar dhe kontrolluar portfolionë e tyre kreditore. Qëllimi i këtij shqyrtimi specifike të kredive është identifikimi i problemeve në fushën e kredive, pasi që kreditë paraqesin një burim të madh të rrezikut për institucionet financiare. Ky rrezik është i kufizuar me anë të rregullave dhe rregulloreve të AQBK-së.

Mbikëqyrja e përqendruar në rrezik – Duke qenë se institucionet financiare bankare dhe jobankare po rriten si në përmasa ashtu dhe në kompleksitet, AQBK-ja ka lëvizur drejt një qasjeje

mbikëqyrëse të përqendruar në rrezik, që është një proces i vazhdueshëm sesa ekzaminim i momentit. Synimi i procesit të mbikëqyrjes së përqendruar në rrezik është identifikimi i rreziqeve më të mëdha të një institucioni financiar dhe vlerësimi i aftësisë së menaxhmentit të institucionit për të identifikuar, monitoruar dhe kontrolluar këto rreziqe.

Për këtë, AQBK-ja përdor qasjen e CAMEL-it për vlerësimin e rrezikut. Sistemi mbikëqyrës i vlerësimit CAMEL është një vegël e mbikëqyrjes që përdorin shumica e mbikëqyrësve në vendet e zhvilluara. Ky sistem mbikëqyrës është një akronim për pesë përbërësit e sistemit të vlerësimit: C- Mjaftueshmëria e kapitalit, A-Cilësia e asetëve, M-Manaxhmenti dhe administrimi , E- Të Hyrat, dhe L- Likuiditeti. Secili përbërës i CAMEL-it vlerësohet nga 1 deri në 5, ku 1 shpreh vlerësimin më të lartë dhe 5 më të ulët. Gjithashtu, institucionit financiar i jepet një vlerësim i përgjithshëm nga 1 deri në 5, vlerësim i cili rrjedh nga vlerësimet e përbërësit individual.

Secila bankë dhe institucioni i madh financiar jobankar është i përcaktuar me vlerësimin e komponenteve të vlerësimit, të bazuara në vlerësimin e standardeve përkatëse financiare dhe operacionale në përputhje me kriteret dhe parimet e standardizuara:

Mjaftueshmëria e Kapitalit – Mjaftueshmëria e bazës së kapitalit, vlera neto dhe rezervat për të mbështetur operacionet aktuale, zhvillimin e rrezikut, dhe rritjen e mëtejshme të institucionit financiar.

Cilësia e Aseteve – Cilësia e kredive, investimeve dhe mjeteve tjera.

Cilësia e Menaxhmentit – Aftësia e menaxhmentit për të administruar si duhet të gjitha aspektet e biznesit të institucionit financiar, dhe për të planifikuar për nevojat e ardhshme dhe rrethanat e papritura.

Të Hyrat – Aftësia për të gjeneruar të hyra për mbulimin e shpenzimeve të tyre, duke provizionin adekuat për humbjet e mundshme të kredive, pagesën e interesit mbi depozitat dhe sigurimi i duhur i fondeve të depozituesve.

Likuiditeti – Mirëmbajtja e mjeteve të mjaftueshme likuide për mbulimin e nevojave aktuale, veçanërisht për tërheqjet e bëra nga depozituesit.

Rezultatet e ekzaminimit në vend raportohen tek bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i institucionit financiar në një raport të ekzaminimit, të bazuar në sistemin mbikëqyrës të vlerësimit CAMEL.

Tabela 18: Mbikëqyrja Bankare: Ekzaminimet në vend të kryera gjatë vitit 2006

Pershkrimi	Numri i ekzaminimeve
Bankat - i plote	4
Bankat - fokusuar	6
Bankat – deget – para-hapjet dhe ri zhvendosja	32
Institucionet Mikro Financiare - I plote	12
Agjensionet per Transferin e Parave – I plote	2
Zyret e Kembimit te Valutave– I plote	4

4.3.2 Objektivi i drejtorisë së mbikëqyrjes së sigurimeve dhe pensioneve është mbajtja e sigurisë, stabilitetit dhe efikasitetit të sigurisë dhe sektorit pensional, për të mbrojtur policëmbajtësit dhe për të ofruar një ambient të përshtatshëm për aksionaret. Për këtë arsye, procedurat e mbikëqyrëse dhe ekzaminuese janë kryer në bazë të planit për inspektim 2006. Kompanitë e sigurimeve, ndërmjetësuesit dhe fondet pensionale janë të mbikëqyrura përmes:

Analizat jashtë vendit bëhen duke mbledhur informata (raporte dhe të dhëna tjera) të cilat dorëzohen në AQBK për kompanitë e sigurimit dhe fondet pensionale. Duke u bazuar në analizat e informatave të pranuar, indikatorët operues siç janë diferenca e solvencës, fuqia financiare, raporti i humbjes, provizionet teknike, ruajtja maksimale ndaj rrezikut, risigurimimi është i ranguar kundër stadardeve ndërkombëtare. Poashtu, AQBK-ja vlerëson përputhshmërinë me rregullat dhe rregulloret e saj. Analiza jashtë vendit indentifikon çështjet dhe dobësitë në një kompani sigurimi ose fond pensional, deri sa ekzaminimet në vend verifikojnë dhe monitorojnë përmirësimet e dobësive të cilat janë identifikuar.

Ekzaminimet në vend – janë pjesa kryesore e procesit të mbikëqyrjes. Është me rëndësi të verifikohen të dhënat dhe informatat e dorëzuara nga kompanitë e sigurimit dhe fondet pensionale vazhdimisht. Mes tjerash, lejon Mbikëqyrjen e Sigurimeve dhe Pensioneve për të vlerësuar procesin e marrjes së vendimeve dhe kontrollit të brendshëm. Për të bërë këtë vlerësim, AQBK-ja përdorë sistemin e kartelës për vlerësim (SCS). Ky është një sistem i gradimit të performancës nga 1 deri në 5, ku 1-shi identifikohet si rreziku më i lartë dhe 5 ai më i ultë. Sistemi përfshinë pesë komponente në procesin e gradimit: i përshtatshëm dhe i duhur (Struktura e menaxhimit dhe struktura e ndarjes së aksioneve), Sistemi dhe Kontrollat (emitimit, procesimi i kërkesave, masat teknike, përshtatshmëria, etj), kualiteti i risigurimeve, Raportet e auditorëve dhe paanësia ndaj mbajtësit të policave.

Duke u bazuar në sistemin e ekzaminimit, rezultatet individuale dhe rezultatet e përgjithëshme të bazuara në gjykimin profesional. Rezultatet janë analizuar që të përcaktojnë gjendjen e institucionit. Gjendja e kompanisë është e përmbledhur në raportin e ekzaminimit dhe në bazë të gjetjeve strategjia mbikëqyrëse është e zhvilluar për ciklin e ardhshëm të mbikëqyrjes së institucionit.

Tabela 19: Mbikëqyrja e Sigurimeve: Ekzaminimi i kryer në vend gjatë vitit 2006

Përshkrimi	Nr. i Ekzaminimeve
Kompanitë e sigurimit - plotë	6
Kompanitë e sigurimit - fokusuar	9
Kompanitë e sigurimit – zyrat e agjentëve	185
Brokeret e linjave shtesë	3
Brokeret e sigurimeve	3

Gjatë 2006, të gjitha fondet pensionale suplementare që operonin në kompani të ndryshme publike kanë pushuar së funksionuari si pasojë e shuarjes vullnetare ose jo vullnetare të tyre. Këto shuarje kanë ndodhur për shkak të shumave të mëdha të obligimeve të pa financuara, dështimeve, ose ndryshimeve në pronësi të kompanive kontribuese. Me vetë iniciativë ose me kërkesë të secilës kompani kontribuese, AQBK ka revokuar licensën e saj, dhe ka caktuar një likuidator. Në fund të procesit të likuidimit i cili është vazhdim e sipër, asetet e mbetura të ish fondeve pensionale do të

transferohen tek fondet tjera ose, në raste të caktuara, do të transferohen tek llogaritë e besueshme në bankat komerciale në emër të secilit pensionist; dhe si të drejta të pensioneve që i kanë, pritet t'i paguhen përfituesëve.

Tabela 20: Mbikëqyrja e pensioneve: Ekzaminimi në vend i kryer gjatë vitit 2006

Përshkrimi	Nr. i ekzaminimeve
TKPK	1
Fondet pensionale suplementare	3

4.4. Veprimet detyruese

Pavarësisht nga përpjekjet e mbikqyrësve, janë krijuar situata kur bankat kanë dështuar për të arritur kërkesat prudente të mbikëqyrjes ose janë përdorur praktika të pa sigurta dhe jo të shëndosha bankare dhe siguruere. Si rezultat i shkeljeve të rregulloreve ose praktikave bankare të pa sigurta ose jo të shëndosha, AQBK-ja ka inicuar 22 veprime detyruese ndaj bankave gjatë vitit 2006, ndërsa mbikëqyrja e sigurimeve ka inicuar 16 veprime detyruese kundër kompanive të sigurimit.

Veprimet detyruese në vitin 2006 të ndërmarra bazuar nga rregullorja Nu. 1999/21 dhe 2001/25, shtrihen duke filluar nga vërejtjet me shkrim deri tek revokimi i licencës dhe ish-in të bazuara në masën e shkeljes, ekspozimit të rrezikut, shkeljeve të përsëritura, etj. Tipet e veprimeve detyruese të ndërmarra nga AQBK-ja duke përfshirë komunikimet me gojë dhe me shkrim, kufizimi i aktiviteteve të caktuara, marrëveshjet formale në mes të AQBK-së dhe bankave, dhe kërkesat për ngritjen e kapitalit aksionar, dhe dënimet monetare. Veprimet detyruese ndaj bankave kanë rezultuar në pozita më të mira financiare të institucioneve financiare dhe kanë zvogluar rrezikun.

Kutia 6. Liquidimi i Bankës Kreditore të Prishtinës (BKP)

Më datë 13 Mars të vitit 2006, Bordi Drejtues i AQBK-së ka revokuar licencën e BKP-së, duke urdhëruar ndërprerjen e aktiviteteve me datën 13 Mars 2006, ka shkarkuar Bordin drejtues dhe menaxhmentin e bankës, dhe ka emëruar likuidatorin që të menaxhojë bankën dhe të mbrojë interesin e depozitorëve. Si pasojë e kësaj:

- Transhi i parë i pagesës së depozitorëve deri në shumën 1.000 Euro është përmbushur menjëherë.
- Transhi i dytë i pagesës së depozitorëve së shpejti pas kësaj është ngritur në shumën prej 3.500 Euro.
- Transhet e ardhshme të pagesës janë përmbushur në disa radha të caktuara, ashtu siq likuidatori ka mbledhur fonde të mjaftueshme në mënyrë që të mbulojë 70% të depozitave, me lartësi maksimale të pagesës prej 20.000 Euro për depozitor.
- Për momentin, 9 million Euro u janë paguar depozitorëve nga shuma që ka qenë prej 32 million Euro.
- Duke u bazuar në pritjet momentale të mbledhjes së kredive, Likuidatori parashikon një mundësi të mirë të mbledhjes së kredive nga huamarrësit e BKP-së. Pagesa e lartë dhe e shpejtë e depozitave do të bazohet nga mbledhja e kredive.
- Procesi i likuidimit mund të zgjasë disa vite.

5. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun


5. Shërbimet e siguruara për autoritetet, komunitetin financiar dhe publikun

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës u siguron institucioneve publike, komunitetit financiar dhe publikut shërbimet e rëndomta financiare që ofrohen nga një bankë qendrore, me përjashtim të çfarëdo krediti ose likuiditetit të përkohshëm meqë AQBK-ja nuk është bankë emetuese. Si rrjedhojë e vendimeve të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, valuta që përdoret në Kosovë është euroja.

5.1. Operacionet dhe Menaxhimi i Parave të Gatshme


AQBK-ja është përgjegjëse për sigurimin e një furnizimi të duhur me kartëmonedha dhe monedha për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme në ekonomi. Meqë euroja është valuta kryesore e lejuar për përdorim në Kosovë, përgjegjësitë e AQBK-së lidhur me operacionet dhe menaxhimin e parave të gatshme kanë të bëjnë me euron.

Figura 27: Furnizimi me kartëmonedha euro (numri i denominimeve)



Burimi: AQBK (2007)


Figura 28: Furnizimi me monedha euro (numri i denominimeve)



Burimi: AQBK (2007)


Siç është paraqitur në figurat e mësipërme, gjatë vitit 2006, AQBK-ja i furnizoi bankat komerciale dhe institucionet e tjera me mbi 3.5 milionë kartëmonedha euro në shumë prej afro 143 milionë eurove dhe 1.8 milionë monedha euro në shumë prej afro 0.65 milion eurove. Sa i përket vlerës së përgjithshme, paratë e gatshme të furnizuara gjatë vitit 2006 patën një rënie prej afro 13.2 për qind në krahasim, ndërkaq struktura e parave të gatshme të furnizuara sipas denominimeve ndryshoi dukshëm nga viti në vit. Përderisa furnizimi i kartëmonedhave 5 dhe 20 euro u rrit, furnizimi i denominimeve të tjera u zvogëlua. Mandej, gjersa furnizimi i monedhave të denominimeve më të larta (monedhat 0.5, 1 dhe 2 euro) u rrit, furnizimi i monedhave të denominimeve më të ulëta (monedhat 1, 2, 5, 10 dhe 20 eurocent) u zvogëlua, ndonëse AQBK-ja ka vazhduar të promovojë përdorimin e monedhave të kuqe (monedhat 1, 2 dhe 5 eurocent) dhe i vuri në dispozicion sikurse vitin e kaluar. Zvogëlimi i furnizimit të monedhave të kuqe reflekton zvogëlimin e nevojës për to të shkaktuar kryesisht nga rumbullakimi relativ i çmimeve të shitjes me pakicë.

Figura 29: Kartëmonedhat euro të pranuar (numri i denominimeve)



Burimi: AQBK (2007)

Figura 30: Monedhat euro të pranuar (numri i denominimeve)



Burimi: AQBK (2007)

Në anën tjetër, në 2006, AQBK-ja pranoi më shumë se 7.4 milionë kartëmonedha euro dhe më shumë se 2.6 milionë monedha euro në formë të depozitave të parave të gatshme nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera. Shprehur në vlerë, këto depozita arritën afro 435.8 milionë euro dhe afro 2 milionë euro, përkatësisht. Në dallim nga paratë e gatshme të furnizuara nga AQBK-ja, vlera e përgjithshme e parave të gatshme të depozituara në AQBK tregon një rritje 7.1 për qind krahasuar me vitin paraprak.

Ngjashëm me vitet e kaluara, në vitin 2006, paratë e gatshme të depozituara në AQBK ishin në një vlerë më të lartë sesa paratë e gatshme të furnizuara nga AQBK-ja. Në të vërtetë, duke arritur në rreth 294.7 milionë euro në 2006, ndryshimi ishte më i ndjeshëm sesa në dy vitet e mëparshme kur ishte rreth 249.8 milionë euro dhe rreth 176.8 milionë euro, përkatësisht. Meqë AQBK-ja mban në trezorë vetëm nivelin minimal të nevojshëm të parave të gatshme duke dërguar tepricat në eurozonë, ku kthehen në mjete interes-prurëse, rritja vjetore e parave të gatshme të depozituara kundrejt parave të gatshme të furnizuara ka rezultuar gjithashtu në rritjen neto të dërgesave jashtë vendit të parave të gatshme. Neto dërgesat jashtë vendit të parave të gatshme në vitin 2006 në shumën gjithsej prej 306.8 milionë eurove ishin në mënyrë të konsiderueshme më të larta sesa në 2005 dhe 2004, kur ishin 237.5 milionë euro dhe 191 milionë euro, përkatësisht.

Figura 31: Kartëmonedhat e vjetërsuara të hequra nga qarkullimi (2006 kunder. 2005)



Burimi: AQBK (2007)

Procesimi i kartëmonedhave dhe monedhave të depozituara në AQBK vijoi të kryhet përmes pajisjeve moderne të procesimit dhe në përputhje me rregullat standarde. Në të vërtetë, në vitin 2006, AQBK-ja ka avancuar tërësinë e pajisjeve të procesimit të parave të gatshme me disa pajisje të tilla më të fundit. Gjatë vitit 2006, afro 2.6 milionë kartëmonedha euro (34.9 për qind e kartëmonedhave euro të depozituara në AQBK) u klasifikuan si të vjetërsuara dhe u hoqën nga qarkullimi dhe dërguan në eurozonë. Një vëllim i këtillë i konsiderueshëm i kartëmonedhave euro të vjetërsuara të hequra nga qarkullimi kontribuoi ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së parave të gatshme në qarkullim.


Cilësia e parave të gatshme në qarkullim u përmirësua gjithashtu përmes furnizimit të kartëmonedhave të reja euro, të cilat u sollën nga eurozona. Gjatë vitit 2006, AQBK-ja furnizoi rreth 2.0 milionë kartëmonedha të reja euro (54.7 për qind e të gjitha kartëmonedhave euro të furnizuara). Shumica e kartëmonedhave të reja të furnizuara ishin kartëmonedha të denominimeve të ulëta, me të cilat kryesisht u furnizuan bankat komerciale për qëllim të pajisjes së bankomatëve të tyre. Mandej, edhe të gjitha kartëmonedhat e përdorura euro që u furnizuan ishin të cilësisë standarde më të lartë.

Figura 32: Raporti i furnizimit të kartëmonedhave të reja euro me furnizimin gjithsej në 2006



Burimi: AQBK (2007)

Figura 33: Furnizimi me kartëmonedha të reja (2006 perkunder 2005)




Burimi: AQBK (2007)

Për sa iu përket masave kundër falsifikimit, AQBK-ja vazhdoi gjatë gjithë vitit 2006 të analizojë rastet e valutave të falsifikuara. Po ashtu ka vazhduar të bashkëpunojë me autoritetet policore për raportimin e falseve dhe trajnimin mbi falset. Në veçanti, AQBK-ja dhe autoritet policore kanë bashkëpunuar në avancimin e procedurave të raportimit të falseve nga institucionet financiare. Gjithashtu termet referuese të një komiteti të përbashkët për analizim të falseve u akorduan.

5.2. Shërbimet e siguruar për Thesarin

Funksioni i bankierit – ose më me vend i siguruesit të shërbimeve financiare – për Thesarin AQBK-së i është dhënë në përputhje me Rregulloren, në nenin mbi kompetencat e veçanta të AQBK-së. AQBK-ja siguron shërbime financiare në emër të dhe për llogari të jo vetëm Thesarit, por dhe entiteteve të tjera të IPVQ-ve dhe të AKM-së. Gjithashtu ofron shërbime financiare për kompanitë më të mëdha të shërbimeve publike. Në vitin 2005, në mënyrë të ngjashme me vitet e mëparshme, këto shërbime konsistojnë kryesisht nga mirëmbajtjet e llogarive dhe operacionet e pagesave, duke përfshirë çfarëdo kreditimi.

Figura 34: Evoluimi i depozitave të Thesarit dhe IPVQ-ve të tjera dhe të AKM-së



Burimi: AQBK (2007)

Depozitat e Thesarit dhe IPVQ-ve të tjera së bashku me depozitat e AKM-së përbënë pjesën më të madhe të depozitave të gjithëmbarshme të mbajtura në llogaritë e AQBK-së. Më 31 dhjetor 2006, depozitat e Thesarit dhe IPVQ-ve të tjera patën shumën prej 195.7 milionë eurove. Gjatë vitit, depozitat e AKM-së u bënë më të rëndësishme, për shkak të intensifikimit të procesit të privatizimit, duke arritur në fund të vitit në shumën prej 275 milionë eurove. Evoluimi i depozitave të Thesarit dhe IPVQ-ve të tjera si dhe të AKM-së të mbajtura në llogaritë e AQBK-së paraqitet në figurën e mësipërme.

Gjithashtu, pjesa më e madhe e operacioneve të pagesave vendore kryhen në emër të dhe për llogari të Thesarit. Sa i përket operacioneve të pagesave ndërkombëtare të Thesarit, në fund të 2006, aranzhimet u bënë për kryerjen e tyre përmes AQBK-së.

Gjatë vitit 2006, AQBK-ja vazhdoi të mbështesë avancimin e proceseve të kryerjes së transaksioneve dhe rakordimeve të Thesarit dhe entiteteve të tjera. Format elektronike standarde për informatat mbi llogaritë dhe transaksionet individuale që u zhvilluan në 2006 u përshtatën për Thesarin dhe AKM-në për t'iu shërbyer më mirë nevojave të tyre. Mandej, një aplikacion për gjenerimin automatik të të gjitha dosjeve të informatave mbi llogaritë e Thesarit u zhvillua si mjet

komplementar për lidhjen e veçantë të telekomunikimit me Thesarit, e cila po ashtu u zbatua në vitin 2006.

5.3. Menaxhimi i mjeteve financiare

AQBK-ja është e ngarkuar me menaxhimin e fondeve të depozituara nga ana e MEF-it, IPVQ-ve të tjera, agjencive publike, entiteteve të UNMIK-ut, institucioneve financiare dhe organizatave donatore. Në praktikë, fondet e depozituara kryesisht iu takojnë MEF-it (rezervat buxhetore), AKM-së (mjetet nga procesi i privatizimit) dhe institucioneve financiare (rezervat e kërkuara të likuiditetit).

Më 31 dhjetor 2006, mjetet financiare të menaxhuara ishin në shumën prej 630 milionë eurove. Nga këto, depozitat e IPVQ-ve dhe entiteteve të lidhura ishin 196 milionë euro (31 për qind të shumës së përgjithshme), depozitat e AKM-së ishin 275 milionë euro (44 për qind të shumës së përgjithshme) dhe depozitat e institucioneve financiare ishin 121 milionë euro (19 për qind të shumës së përgjithshme).

Në përputhje me Rregulloren, Bordi Drejtues i AQBK-së ka përcaktuar politikën e investimeve e cila duhet të ndiqet nga menaxhmenti, dhe nën kontrollin e tij, nga ana e njësisë së menaxhimit të mjeteve financiare. Për arsye se një pjesë e madhe e fondeve që menaxhohen janë fonde publike dhe mund të paguhen brenda një afati të shkurtë kohor, një theks i veçantë i është dhënë sigurisë dhe likuiditetit, dhe mandej kthimit në investime.

Të gjitha operacionet e investimeve kryhen me bankat të cilat gëzojnë rangje klasifikimi të larta (Aaa dhe Aa ose ekuivalente). Mjetet financiare të menaxhuara plasohen në valutën euro në plasmanë të afatizuar bankar (52për qind në fund të vitit 2006), në letra me vlerë qeveritare me maturitete më shkurta se një vit dhe rangje klasifikimi të larta për investime (Aaa dhe Aa ose ekuivalente) (43për qind), dhe në fund në llogari rrjedhëse. Ekspozimet ndaj palëve në transaksion veç e veç dhe ndaj vendeve janë të kufizuara rreptësisht. Përputhshmëria me rregullat e brendshme të investimeve përcillet në baza ditore, ndërkaq të gjitha operacionet evidentohen në baza ditore nga një zyrë mbështetëse e pavarur dhe i raportohen zyrës së drejtorit të përgjithshëm. Analizat e rreziqeve të palëve në transaksion si dhe auditimet e funksioneve të menaxhimit të mjeteve financiare kryhen rregullisht.

Depozitave në llogari të AQBK-së iu paguhet interes në bazë të normës depozituese të Bankës Qendrore Evropiane (BQE), ndërkaq mesatarisht kthimi i realizuar nga AQBK-ja është afër normës minimale ofertuese të BQE-së. AQBK-ja realizon një margjinë e cila i kontribuon të ardhurave të veta.


5.4. Shërbimet për Komunitetin Financiar

5.4.1. Sistemi i Pagesave

Një nga qëllimet e AQBK-së është ta nxisë një sistemi efikas dhe të sigurt të pagesave vendore. AQBK-ja e ka ndjekur në mënyrë aktive këtë qëllim që prej themelimit të vet, dhe një arritje e madhe ndodhi në maj të vitit 2001, kur u krijua Sistemi i Kliringut Ndërbankar (SKN) me qëllim lehtësimin të operacioneve të pagesave vendore përmes sistemit bankar. AQBK-ja jo vetëm që operon dhe mbikëqyr SKN-në, por gjithashtu merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në operacionet e SKN-së bashkë me të gjitha bankat komerciale.

Vëllimi dhe vlera e transaksioneve të përshkuara përmes SKN-së janë rritur në mënyrë të vazhdueshme, duke pasqyruar rritjen relative të pagesave pa para të gatshme dhe rritjen e besimit në sistemin bankar vendor. Ndërkohë, SKN-ja i është nënshtruar zhvillimit të vazhdueshëm teknologjik përderisa mënyrat e kryerjes së transaksioneve janë modernizuar dhe pasuruar.


Figura 35: Vëllimi dhe vlera vjetore e transaksioneve të SKN-së



Burimi: AQBK (2007)

Sikurse viteve të mëparshme, në 2006, rritja vjetore si e vëllimit ashtu edhe e vlerës së transaksioneve të SKN-së ishte e ndjeshme. Gjatë vitit 2006, rreth 997 mijë transaksione me një vlerë të përgjithshme prej 2,325 milionë eurove janë kanalizuar përmes SKN-së. Krahasuar me transaksionet e SKN-së në vitin paraprak, vëllimi i transaksioneve u rrit për 58 për qind, dhe vlera e transaksioneve u rrit për 21 për qind.


Figura 36: Vëllimi dhe vlera mesatare ditore e transaksioneve të SKN-së



Burimi: AQBK (2007)


Rritja e rëndësishme e transaksioneve të SKN-së mund të shihet edhe nga të dhënat mesatare ditore. Vlera ditore e transaksioneve të SKN-së në vitin 2006 ishte rreth 9.3 milionë euro, krahasuar me rreth 7.7 milionë euro në vitin 2005. Mandej, vëllimi ditor i transaksioneve të SKN-së në vitin 2006 ishte afro 4.0 mijë, krahasuar me rreth 2.5 mijë transaksione në vitin 2005.

Figura 37: Vëllimi vjetor i transaksioneve të SKN-së sipas llojeve të tyre



Burimi: AQBK (2007)

Figura 38: Vlera vjetore e transaksioneve të SKN-së sipas llojeve të tyre




Burimi: AQBK (2007)

Pagesat e rregullta përbëjnë rreth 99 përqind të transaksioneve të SKN-së, dhe ato kanalizohen përmes SKN-së ose si transaksione individuale (një-deri te-një) ose si transaksione masive (një-deri te-shumë ose shumë-deri te-një). Ato kryqëzohen përmes sesioneve të rregullta të kliringut dhe shlyhen në baza neto. Duhet të përmendet se në 2006, sesioni i dytë i kliringut filloi së aplikuari për shkak të rritjes së vëllimit të transaksioneve të rregullta. Kos-giro transaksionet përfaqësojnë një lloj të veçantë të transaksioneve të rregullta që po ashtu kryqëzohen përmes sesioneve të kliringut dhe shlyhen në baza neto. Ato kanalizohen përmes SKN-së si transaksione masive (shumë-deri te-një). Përderisa transaksionet e rregullta individuale janë të destinuara për pagesat në përgjithësi dhe pagesat e rregullta masive janë të destinuara për pagesat dhe arkëtimet e entiteteve të ndryshme, transaksionet Kos-giro janë të destinuara për arkëtimet e standardizuara dhe të automatizuara të institucioneve të mëdha faturuese. Transaksionet Kos-giro u futën në përdorim në vitin 2005 dhe patën një rritje relative të rëndësishme në vitin 2006.

Transaksionet prioritare ende përfaqësojnë një pjesë të vogël të transaksioneve të gjithëmbarshme të SKN-së, por vëllimi i tyre ka pasur rritje të konsiderueshme çdo vit. Ato përlllogariten dhe shlyhen menjëherë në baza bruto. Ngjashëm me transaksionet e rregullta, transaksionet prioritare mund të kanalizohen përmes SKN-së ose si individuale ose si masive.

Pesë llojet e veçanta të transaksioneve të SKN-së mund të grupohen në dy kategori varësisht nëse shlyhen në baza neto ose bruto sic u përmend më sipër. Transaksionet e shlyera në baza neto vazhdojnë të dominojnë mbi transaksionet e shlyera në baza bruto. Sa i përket vëllimit, transaksionet e shlyera në baza bruto, përkundër dyfishimit të tyre vjetor në 2006, vazhdojnë të përfaqësojnë më pak se një për qind të transaksioneve të SKN-së. Sa i përket vlerës, megjithatë, transaksionet e shlyera në baza bruto përfaqësojnë më shumë se 10 për qind të transaksioneve të SKN-së, dhe në 2006 ato patën një rritje vjetore prej afro 20 për qind.

Figura 39: Vëllimi dhe vlera vjetore e transaksioneve të SKN-së: Neto me Bruto



Burimi: AQBK (2007)

Si pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në SKN, AQBK-ja merr pjesë në kanalizimin e urdhërpagesave vendore në emër të dhe për llogari të klientëve. Gjatë vitit 2006, AQBK-ja ka dërguar përmes SKN-së mbi 109.6 mijë urdhërpagesa shkuarëse, dhe ka pranuar përmes SKN-së 60.3 mijë urdhërpagesa ardhëse. Shprehur në vlerë, shumat e urdhërpagesave shkuarëse në vitin 2006 ishte 659.6 milionë euro, dhe vlera e urdhër pagesave ardhëse ishte 913.9 milionë euro. AQBK-ja ka mbetur sa i përket si vlerës ashtu edhe vëllimit të transaksioneve pjesëmarrësi më i madh në SKN.

5.4.2. Kos-giro

Skema Kos-giro paraqet një veçori kryesore të infrastrukturës së pagesave. Futja e saj në përdorim një vit më herët ishte një arritje e madhe në zhvillimin e pagesave me vlera të ulëta dhe vëllime të larta të lëmit me pakicë. Kos-giro është destinuar që të lehtësojë pagesat e faturave përmes standardizimit dhe automatizimit të një skeme efektive për faturuesit e mëdhenj, paguesit dhe sektorin bankar.

Kos-giro bazohet në standardet e pranuar ndërkombëtarisht dhe siguron një mënyrë që paguesi t'i paguajë faturat faturuesit përmes sistemit bankar. Faturuesi i siguron paguesit faturën (kërkesën për pagesë) të bashkëngjitur me një formular standard të pagesës, i cili i përmban detajet e pagesës në një barkod. Kur formulari paraqitet në bankë, në mënyrë automatike detajet e pagesës merren përmes pajisjes për leximin e barkodit dhe pagesa inicohet, d.m.th. llogaria e paguesit debitohet ose paguesi paguan me para të gatshme. Në të vërtetë, nëse faturuesi e ka llogarinë në të njëjtën bankë, pagesa edhe finalizohet menjëherë, d.m.th. llogaria e faturuesit kreditohet. Në mënyrë alternative, pagesa finalizohet pasi të jetë kanalizuar përmes SKN-së. Po ashtu Kos-giro siguron një mënyrë të standardizuar dhe efikase për sigurimin e detajeve të nevojshme për faturuesin për rakordim të automatizuar.

Skema Kos-xhiro iu nënshtrua zhvillimeve të rëndësishme në vitin 2006. Edhe pse fillimisht e dizajnuar si skemë për të mundësuar procesimin e faturave gratis për paguesin, u përshtat për të mundësuar edhe procesimin alternativ (me tarifa për t'u paguar nga paguesi) varësisht nga qëndrimi i faturuesit. Në lidhje me aranzhimin fillestar, një marrëveshje mes bankave u arrit në

vitin 2006 që parashtron politikën dhe procedurën e tarifave ndërbankare. Gjatë vitit, dy institucione i ishin bashkuar skemës Kos-giro – KEK-u për faturat e rrymës dhe Agjencia Kosovare e Pronave për skemën e vet të qirave. Po ashtu, Shërbimi Doganor i UNMIK-ut ka bërë përgatitjet e nevojshme dhe pritjet t'i bashkohet skemës në fillim të vitit 2007.

5.4.3. Regjistri i Krediteve të Kosovës

Një nga shërbimet kryesore që AQBK-ja siguron për komunitetin financiar, më saktësisht për institucionet kredidhënëse, është vënia në dispozicion e raporteve kreditore mbi aplikuesit për kredit dhe kredimarrësit e tyre përmes sistemit të Regjistrimit të Krediteve të Kosovës (RKK) i cili është futur në funksion në vitin 2006. RKK-ja është dizajnuar si një aplikacion i bazuar në Internet dhe mund të qaset drejtpërdrejt dhe në kohë reale nga institucionet kredidhënëse. Në RKK, institucionet kredidhënëse fusin dhe azhurnojnë të dhënat mbi kreditet e tyre të lejuara, dhe ato mund të marrin nga RKK-ja një raport përmbledhës mbi nivelin dhe statusin e krediteve aktive në lidhje me secilin prej kredimarrësve dhe aplikuesve për kredit. RKK-ja është destinuar po ashtu që përmes AQBK-së secili person i interesuar mund të marrë detajet e veta kreditore. Mandej, gjithashtu shërben për qëllime mbikëqyrëse të Mbikëqyrjes Bankare.

RKK-ja siguron një mjet me rëndësi për funksionimin e tregut të krediteve. Mundëson vlerësimin më të mirë të mundësisë kredimarrëse dhe rreziqeve të kredimarrësit / aplikuesit për kredit dhe, si rrjedhojë, lehtëson në masë të madhe procesin e lejimit të kreditit.

Gjatë vitit 2006, RKK-ja ka kaluar nëpër disa ngritje funksionale për të avancuar funksionin si për institucionet kredidhënëse ashtu edhe për Mbikëqyrjen Bankare. Në mënyrë që të plotësojë më mirë nevojat dhe kërkesat e institucioneve kredidhënëse dhe të Mbikëqyrjes Bankare, një njësi e veçantë organizative u themelua në gjysmën e dytë të vitit 2006. Përpos operimit të sistemit, kjo njësi po ashtu koordinon zhvillimin e mëtutjeshëm dhe monitoron përputhshmërinë me kërkesat teknike të institucioneve kredidhënëse.

5.5. Aktivitet kërkimore dhe statistikore

Arritja më e madhe e Drejtoratit të Kërkimeve dhe Statistikave (DKS) gjatë vitit 2006 ishte përpilimi i statistikave të bilancit të pagesave të Kosovës për dy vite të njëpasnjëshme, 2004 dhe 2005. Kjo ishte hera e parë që nga ana e DKS-së statistikave të bilancit të pagesave u përpiluan dhe shpërndanë përmes publikimit në Buletin e AQBK-së nr. 3. Në lidhje me statistikave të sektorit financiar, ato janë përmirësuar për nga cilësia dhe sasia, në këtë mënyrë duke siguruar burim të besueshëm të informatave për përdorues të ndryshëm.

DKS-ja ka vazhduar me publikimin e Buletinit Statistikor Mujor (BSM). Në dhjetor 2006, DKS-ja ka publikuar edicionin e 64-të të BSM (me vlerësimin tremujor), me qëllim parësor të përmirësimit të statistikave në Kosovë. Po ashtu, shpërndarja e serive kohore në faqen e Internetit të AQBK-së dhe në kuadër të buletinit, duke përfshirë të dhënat mujore që nga fundi i vitit 2000, duket se çmohen nga përdoruesit.

Buletini i AQBK-së (Struktura e Sektorit Financiar) po ashtu ishte përpiluar dhe publikuar në vitin 2006. Ai përmban informata mbi sektorin financiar në Kosovë, me referencë të veçantë për sektorin bankar, dhe përshkruan zhvillimet kryesore në këtë sektor. Në të ardhmen, këto informata do të përfshihen në një publikimin të ri me titull Raporti i Stabilitetit Financiar.

Gjatë vitit 2006, dy studime janë iniciuar nga DKS-ja. Njëri studim është i lidhur me kostot e ndërmjetësimit të sektorit bankar dhe i dyti është i lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë. Studimet janë duke vazhduar dhe rezultatet do të publikohen nga ana e AQBK-së.

6. Zhvillimet e brendshme

6. Zhvillimet e brendshme

6.1. Rregullorja e re për AQBK-në

Në gusht të vitit 2006, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) nënshkroi një rregullore të re për Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës. Kjo rregullore e re ua hartua me qëllim të rritjes së rolit të kosovarëve dhe institucioneve të Kosovës.

Rregullorja e re fuqizon rolin e AQBK-së në sektorin financiar përmes dy objektivave kryesore: (i) mbështetja e sistemit financiar të shëndoshë, solvent dhe të bazuar në funksionimin efikas të tregut të qendrueshëm, duke inkurajuar paraqitjen në treg të instrumenteve të sigurta financiare; dhe (ii) mbështetja e politikave të përgjithshme ekonomike në Kosovë në drejtim të kontributit për një shpërndarje efikase të burimeve në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut të hapur.

Detyrat e AQBK-së janë të identifikuar qartazi në fushën e mbikëyrjes financiare, sistemit të pagesave, studimeve ekonomike, pjesëmarrjes dhe anëtarësimit në institucionet financiare ndërkombëtare, organizata dhe këshilla që shtrihen në fushën e përgjegjësive të saj.

Dispozitat kryesore të aprovuara me Rregullorën e re të AQBK-së Nr. 2006/47 janë përmbledhur si vijon:

- Fuqitë e përgjithshme janë zgjeruar në mënyrë që të sigurojnë pavarësinë dhe neutralitetin operacional (Neni 4.2).
- Kapitali duhet të rritet nga 10 në 20 milion Euro (Neni 12.1)
- Përbërja e Bordit drejtues siguron shumicën e anëtarëve të emëruar nga ana e institucioneve kosovare (Neni 18) – Bordi drejtues do të përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtori i Përgjithshëm i cili do jetë Kryekzekutivi i AQBK-së, dhe katër drejtorë joekzekutiv në mesin e të cilëve hynë edhe Kryesuesi i Bordit drejtues. Në konsultim me PSSP-në: (a) Drejtori i përgjithshëm do të caktohet në bazë të propozimit të IPVQ-së i cili, pas aprovimit të Kuvendit, do të dorëzohet PSSP-së për emërim. Dy drejtorë joekzekutiv do të nominohen me propozim të IPVQ-së, njëri prej tyre i propozohet IPVQ-së nga ana e MEF-it, dhe më pastaj pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Kosovës, që të dy i dërgohen PSSP-së për emërim; dhe (b) Një drejtor joekzekutiv do të jetë Drejtori i Thesarit, ndërsa drejtori tjetër joekzekutiv do të emërohet me propozim të UNMIK-ut. Si dispozitë kalimtare, PSSP-ja do të emërojë drejtëpërdrejtë personin e parë për të marrë detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm (Neni 10). Njëri prej drejtorëve joekzekutiv të emëruar nga PSSP-ja do të caktohet po nga PSSP-ja si Kryesuesi i Bordit Drejtues, në konsultim me anëtarët e Bordit. Anëtarët e Bordit drejtues, përveç Drejtorit të Thesarit, si dhe dy Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm, duhet të jenë persona me integritet të pranuar, me edukim profesional të lartë dhe përvojë financiare, bankare, ose në çështje ligjore, pa ndonjë mandat politik të tanishëm ose gjatë vitit të fundit. Bordi drejtues paraprak përbëhej nga 7 anëtarë, të gjithë të emëruar drejtëpërdrejtë nga PSSP-ja.
- Funkcionet ndërkombëtare janë zgjeruar (Neni 8)
- Një rol më i madh në fushën e informacionit ekonomik (Neni 9)
- Pavarësia financiare është e siguar (Neni 14)

6.2 Projekti i ngritjes së sigurisë fizike

Një projekt voluminoz dhe shumë i rëndësishëm për ngritjen e sigurisë fizike të ndërtesës së AQBK-së ka filluar në prillin e vitit 2006 dhe nga fundi i vitit 2006 rreth 90% të punëve të projektuara janë kryer.

Qëllimi i parë dhe kryesor i këtij projekti ishte të siguroj funksionimin e sigurt të Bankës, kryerjen e transaksioneve të saja të përditshme dhe menaxhimin e lëvizjes së fondeve me vlera të larta. Si rezultat i kësaj, zona të reja për kategori të ndryshme të transfertave janë rivendosur bashkë me instalimin e paisjeve të një sigurie të lartë. Më pas, një sistem gjithëpërfshirës i kontrollit të qasjes është instaluar bashkë me kontrollin bioemetrik për zona të sigurisë së lartë, përfshirë pastaj edhe rrjetin tërësisht të ri kompjuteristik (LAN), rrjetin e ri të telefonisë dhe atë të tërë sistemit elektrik. Gjithashtu, është instaluar një sistem i ri i kamerave (CCTV) brenda objektit dhe zonave përreth tij, duke përfshirë këtu edhe një sistem të ri alarmi kundër vjedhjeve i lidhur me Policinë si dhe një sistem të ri alarmi kundër zjarrit. Në të njëjtë kohë, janë bërë edhe disa rirregullime racionale të hapësirës për zyra.

Poashtu, një ngritje e theksueshme është bërë edhe në drejtim të Shëndetit dhe Sigurisë nga Zjarri përfshirë këtu edhe disa rregullime jashtë objektit. Për kujdes të veçant ndaj personave me aftësi të kufizuara, është ndërtuar një kalim i pjerrtë në hyrje të ndërtesës, ndërsa edhe i tërë sistemi i izolimit të kulmit është ndërruar.

Në përfundim, duhet theksuar se i tërë Projekti është kryer në bazë të standardeve më të mira të BE-së dhe se AQBK-ja gjatë tërë projektit ka siguruar të gjitha lejet e nevojshme nga autoritetet përkatëse.

Së fundi, AQBK-ja i shpreh mirënjohje stafit të saj i cili, paralel me ekzekutimin e këtij projekti voluminoz dhe shumë të rëndësishëm, tregoi kontribut dhe mirëkuptim të lartë në kryerjen e punëve të tyre pa kurrfarë ndërprerjesh.

6.3 Qeverisja dhe kontrolli i brendshëm

Inspektori i Përgjithshëm ushtron funksionin e udhëheqësit të kontrollit të brendshëm. Ai është caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm me aprovim të Bordit drejtues dhe mund të largohet prej zyrës së tij vetëm me vendim të PSSP-së. Inspektori i Përgjithshëm aktual është caktuar me mandat pesë vjeçar duke filluar nga shkurti i vitit 2007.

Inspektori i Përgjithshëm është njëri ndër tre anëtarët e Komitetit të auditimit – dy të tjerët janë anëtarë Bordi – dhe ai i raporton Drejtorit të Përgjithshëm dhe Komitetit të auditimit, dhe në fund përmes këtij kanali edhe vetë Bordit.

Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm përfshinë dy njësi: auditimin e brendshëm dhe kontrollin e buxhetit (analizat operacionale dhe kontabilitetin e shpenzimeve).

6.3.1 Auditimi i brendshëm

Auditimi i brendshëm ka punuar në bazë të planit vjetor – të aprovuar si nga ana e Komitetit të auditimit ashtu edhe nga ana e Bordit drejtues – i cili është i bazuar në profilin e rrezikut. Varësisht nga rreziku i paraparë, kontrollet dhe auditimet janë kryer në frekuenca mujore dhe vjetore dhe atë në përgjithësi me iniciativë të Inspektorit të Përgjithshëm, ndërsa edhe vetë Drejtori i Përgjithshëm dhe Komiteti i auditimit janë poashtu në zanafillë të auditimeve të planifikuara.

Një mori kontrollash të aseteve me vlerë, kryesisht të parasë së gatshme, dhe barazimit të llogarive janë kryer gjatë vitit të kaluar, duke pasqyruar kështu mospërputhje të pakta dhe minore. Sa u përket vetë auditimeve, ato ishin të koncentruara në arritjen e qëllimeve vijuese:

- Plotësimi i objektivave dhe qëllimeve të definuara nga ana e menaxhmentit
- Përdorimi racional dhe efektiv i aseteve
- Përgjegjësia dhe integriteti i informacionit
- Përputhshmëria e operacioneve me politikën, planet, procedurat, rregulloret dhe ligjet në fuqi.

Me qëllim këmbimi të përvojave dhe forcimi të kapaciteteve, Inspektori i Përgjithshëm ka nisur një program bashkëpunimi të gjerë me bankat qendrore të rajonit, deri sa aktivitetet e kontrollit të brendshëm kanë përfituar më tutje nga trajnimet dhe ndihma teknike e ofruar nga institucionet e huaja. Kështu, Inspektori i Përgjithshëm dhe stafi i tij janë anëtarësuar edhe në Institutin Ndërkombëtar të Auditorëve.

6.3.2 Kontrolli i buxhetit

Kjo njësi kontrollon përshtatjen e shpenzimeve me linjat buxhetore të aprovuara nga ana e Bordit; poashtu kjo përqëndrohet në veçanti në përshtatshmërinë e procesit të prokurimeve dhe dokumentimit të shpenzimeve. Kjo njësi ka filluar të kryej edhe analiza operationale dhe kontabilitet të shpenzimeve të detajuar; këto funksione do të zhvillohen gjatë vitit 2007 dhe 2008.

6.4 Zhvillimi i burimeve njerëzore

Viti 2006 shënon një mori momentesh me rëndësi të lidhura me rritjen e njohurive, aftësive dhe ekspertizës së stafit të AQBK-së.

Gjatë vitit 2006, më shumë se 45% të të gjithë stafit të AQBK-së kanë marrë pjesë në kurset relevante të organizuara nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare (FMN – Joint Vienna Institute, Banka Qendrore Evropiane, Bundesbanka e Gjermanisë, Banka e Francës, Banka Kombëtare e Austrisë, Banka e Rezervave Federale e Nju Jork-ut, Banka e Japonisë, etj.) dhe institucionet tjera në Kosovë (Shoqata e Bankierëve të Kosovës, SCAAK, etj.).

Në vazhdim, pesë menaxherë të lartë të AQBK-së kanë kryer me sukses Progamim special njëvjeçar të Zhvillimit Profesional dhe atë tremujor të Udhëheqjes Ekzekutive, programe këto të sponsoruara nga USAID-i. Poashtu, në vijë me Politikën e vet të Trajnimit dhe Zhvillimit të Stafit, AQBK-ja ka vazhduar me sponsorizimin e stafit të saj më të shkathtë në regjistrimin e programeve pasuniversitare të ndërlidhura me vendet e tyre të punës.

Gjatë vitit 2006, mesatarja e punëtorëve të AQBK-së ishte 141 punëtorë ose 1% më tepër se mesatarja e punëtorëve gjatë vitit 2005. Në aspektin e strukturës, 48% e punëtorëve ishin të gjinisë femërore, ndërsa 4,5% ishin nga komuniteti i minoriteteve. Sa i përket strukturës kualifikuese, 60% e punëtorëve ishin me përgatitje universitare.

6.5 Ngritja strukturës organizative të AQBK-së gjatë vitit 2006

Falë dizajnit të kujdesshëm të strukturës organizative, objektivi i përgjithshëm i ndryshimit të strukturës organizative në vitin 2006 ishte që të rritet zhvillimi i AQBK-së duke forcuar kapacitetin e saj për të realizuar agjendën e saj strategjike.

E lansuar në janar të vitit 2006, struktura e re organizative theksoi procesin e kosovarizimit të menaxhmentit të AQBK-së, përmes emërimit të stafit të lartë vendor (Zyrtari Kryesor i Operacioneve dhe Zyrtari Kryesor i Mbikëqyrjes) si Zëvendës Drejtorë të Përgjithshëm të AQBK-së. Njëkohësisht, me qëllim të ngritjes së mëtejme të efijencës, llogaridhënies dhe qeverisjes transparente, dy shtyllat organizative të AQBK-së (Mbikëqyrja Financiare dhe Operacionet Bankare Qendrore) u riorganizuan në disa drejtorate, dy drejtorate në Mbikëqyrjen Financiare dhe katër drejtorate në Operacionet Bankare Qendrore. Në vitin 2006, vetëm një i jashtëm kishte funksion ekzekutiv (Drejtori i Përgjithshëm), deri sa tre ekspertë të jashtëm mbanin këto pozita: një këshillëtar për mbikëqyrje financiare, një oficer i lartë për rregullimin financiar dhe një asistent personal i Drejtorit të Përgjithshëm.

7. Pasqyrat financiare të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Pasqyrat financiare

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2006

(së bashku me raportin e auditorit të pavarur)

Vërejtje: në rast të ndonjë mosmarrëveshje, mbizotëron versioni i pasqyrave financiare në gjuhën angleze

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

PËRMBAJTJA	FAQE
Raporti i auditorit të pavarur	-
Bilanci i gjendjes	1
Pasqyra e të ardhurave	2
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitete	3
Pasqyra e fluksit të parasë	4
Shënime mbi pasqyrat financiare	5 - 31



KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo
Sulejman Vokshi, No. 14
Pristina, Kosovo

Telephone +381 38 246 771
Telafix +381 38 246 772
E-mail office@kpmg.al

Raporti i Auditorit te Pavarur

Për Bordin Drejtues të Autoritetit
Qendror Bankar të Kosovës

Është bërë auditimi i pasqyrave financiare përgjellëse të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës ("Banka"), i cili përbëhet nga gjendja e bilancit deri më 31 Dhjetor 2006, deklarata e të ardhurave, deklarata e ndryshimeve në ekuitet dhe deklarata e rrjedhjes së parave për fund të vitit, si dhe një përmbledhje e rëndësishme e politikave të kontabilitetit dhe shënimet tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e duhur të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: dezajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm lidhur me përgatitjen dhe prezantimin e duhur të pasqyrave financiare të cilat janë të liruara nga paragjykimet materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, zgjedhjen dhe aplikimin e politikave të përshtatshme të kontabilitetit; dhe përgatitjen e vlerësimeve të kontabilitetit të cilat janë të arsyeshme sipas rrethanave.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është shprehja e opinionit lidhur me këto pasqyra financiare të cilat bazohen në auditimin tonë. Ne e kemi drejtuar auditimin tonë sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Ato standarde kërkojnë që ne të jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike përkatëse si dhe me planifikimin dhe përbushjen e auditimit në mënyrë që të fitohet siguria e arsyeshme në qoftë se pasqyrat financiare janë të liruara nga paragjykimet materiale.

Një auditim përfshin procedurat e përbushura në mënyrë që të sigurohet evidenca e auditimit lidhur me shumat dhe zbulimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga vendimi jonë, përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve ndaj paragjykimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve. Duke i bërë ato vlerësime të rreziqeve, ne konsiderojmë se kontrolli i brendshëm është i lidhur me përgatitjen dhe paraqitjen e duhur të pasqyrave financiare nga ana e entitetit në mënyrë që të përcaktohen procedurat e auditimit të cilat janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo më qellim të shfaqjes së opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshëm të parimeve të kontabilitetit të përdorur dhe arsyeshmerinë e vlerësimeve të kontabilitetit të bëra nga ana e menaxhmentit, si dhe vlerësimin e përgjithshëm të prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit e cila është siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për mendimin tonë.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pikëpamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të bankës deri më 31 Dhjetor 2006, si dhe të përbushjes financiare dhe rrjedhjes së parave për fund të vitit sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

KPMG, Shqipëri Sh.p.k.

18 Maj, 2007
Prishtinë, Kosovë

KPMG Albania Sh.p.k., an Albanian limited liability company and a member firm of the KPMG Network of independent member firms affiliated with KPMG International, a Swiss cooperative.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Bilanci i gjendjes

Gjendja më 31 Dhjetor

<i>në '000 EUR</i>	Shënim	2006	2005
Mjetet			
Paraja e gatshme	6	11,136	24,464
Llogaritë rrjedhëse në bankat jorezidente	7	22,480	23,765
Bonot e thesarit	8	203,398	159,269
Llogaritë depozitore në bankat jorezidente	9	404,025	190,633
Prona dhe pajisjet	10	1,262	329
Mjetet e patrupëzuara	11	144	165
Mjete të tjera	12	177	377
Gjithsej Mjetet		<u>642,622</u>	<u>399,002</u>
Detyrimet			
Detyrimet ndaj bankave vendore	13	94,477	82,518
Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare lokale	14	475,821	229,891
Detyrimet ndaj entiteteve publike dhe tregtare	15	45,076	64,126
Detyrime tjera vendore	16	2,658	2,745
Gjithsej Detyrimet		<u>618,032</u>	<u>379,280</u>
Kapitali dhe rezerva			
Fondi Statutor	17	10,000	10,000
Fondi i rezervave	18	14,590	9,722
Gjithsej kapitali dhe rezervat		<u>24,590</u>	<u>19,722</u>
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat		<u>642,622</u>	<u>399,002</u>

Shënimet në faqet 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të paraqitura në faqet prej 1 deri në 30 janë aprovuar nga Menaxhmenti i AQBK-së, më 18 maj 2007 dhe janë nënshkruar nga:

 Michel Svetchine

Drejtor i Përgjithshëm

 Gani Gërguri
Zëvendës Drejtor i
Përgjithshëm

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Pasqyra e të ardhurave

Gjendja më 31 Dhjetor

<i>në '000 EUR</i>	Shënim	2006	2005
Të ardhurat nga interesi		15,187	7,369
Shpenzimet nga interesi		(8,731)	(3,432)
Neto të ardhurat nga interesi	19	6,456	3,937
Të ardhurat nga tarifatat dhe komisioni		744	705
Shpenzimet nga tarifatat dhe komisioni		(250)	(557)
Neto të ardhurat nga tarifatat dhe komisioni	20	494	148
Të ardhurat nga grantet	21	317	468
Të ardhurat tjera operative	22	792	311
Të ardhurat operative		8,059	4,864
Shpenzimet për personelin	23	(1,254)	(1,085)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11	(282)	(366)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	24	(870)	(822)
Shpenzimet operative		(2,406)	(2,273)
Profiti për periudhën		5,653	2,591

Shënimet në faqet 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Pasqyrë e ndryshimeve në ekuitet në përfundimin e vitit më 31 dhjetor 2006

<i>në '000 EUR</i>	Fondi Statutor	Fondi i rezervave	Fitimet e mbajtura	Totali
Bilanci më 1 Janar 2005	10,000	7,513	-	17,513
Fitimi për periudhën	-	-	2,591	2,591
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve të pranuar	-	-	2,591	2,591
Pagesa për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave	-	(382)	-	(382)
Transferta në fondin e rezervave	-	2,591	(2,591)	-
Bilanci më 31 dhjetor 2005	10,000	9,722	-	19,722
Bilanci më 1 janar 2006	10,000	9,722	-	19,722
Fitimi për periudhën	-	-	5,653	5,653
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve të pranuar	-	-	5,653	5,653
Pagesa për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave	-	(785)	-	(785)
Transferta në fondin e rezervave	-	5,653	(5,653)	-
Bilanci më 31 dhjetor 2006	10,000	14,590	-	24,590

Shënimet në faqet 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Pasqyra e fluksit të parasë Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor

<i>në '000 EUR</i>	Shënime	2006	2005
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Neto surplus i vitit		5,653	2,591
Përshtatjet për:			
Zhvlerësim	10	137	163
Amortizim	11	145	204
Të ardhurat vjetore nga grantet	16	(124)	(199)
Të ardhurat nga interesi	19	(15,187)	(7,369)
Shpenzimet nga interesi	19	8,731	3,432
<i>Flukset operative të parasë së gatshme para ndryshimeve në kapitalin punues</i>		<i>(645)</i>	<i>(1,178)</i>
Rënia/(rritja) në letrat me vlerë		(57,178)	9,994
Rënia/(rritja) në llogaritë depozitore të bankave jo rezidente		(24,254)	(2,250)
Rënia/(rritja) në asetet tjera		200	(266)
Rritja e detyrimeve ndaj bankave vendore		11,959	9,619
Rritja e detyrimeve ndaj institucioneve qeveritare vendore		245,930	4,682
Rritja/(rënia) ndaj entiteteve publike dhe komerciale		(19,050)	31,300
Rritja/(rënia) e detyrimeve tjera vendore		(5)	611
<i>Fluksi i parave të gatshme i përdorur për aktivitetet operative</i>		<i>156,957</i>	<i>52,512</i>
Interesi i pranuar		13,875	7,426
Interesi i paguar		(8,731)	(3,432)
<i>Neto paratë e gatshme nga aktivitetet operative</i>		162,101	56,506
Fluksi i parasë së gatshme nga aktivitetet investuese			
Blerja e pajisjeve	10	(1,070)	(65)
Blerja e mjeteve të paprekshme	11	(124)	(130)
<i>Neto paratë e gatshme të përdorura në aktivitetet investuese</i>		<i>(1,194)</i>	<i>(195)</i>
Fluksi i parave të gatshme nga aktivitetet financuese			
Pagesat Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave	18	(785)	(382)
Të hyrat nga grantet	16	42	112
<i>Neto paratë e gatshme nga aktivitetet financuese</i>		<i>(743)</i>	<i>(270)</i>
Neto (rënia)/rritja në para të gatshme dhe ekuivalentët e saj		160,164	56,041
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj më 1 Janar		348,834	292,793
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj më 31 Dhjetor	25	508,998	348,834

Shënimet në faqet 1 deri 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

1. Entiteti raportues

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës ("AQBK") pasardhës i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (BPK) është një entitet publik i veçantë i cili ka të drejtë të licencojë, mbikëqyrë dhe rregullojë institucionet financiare në territorin e Kosovës. AQBK-ja është themeluar në përputhje me dispozitat e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ("UNMIK"), Rregullorja nr. 1999/20 e nxjerrë më 15 nëntor 1999 (e ndryshuar më 1 tetor 2001) "Mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës". Veç kësaj , më 24 Gusht 2006 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ("PSPP") ka nënshkruar Rregulloren e re mbi Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës dhe ka transformuar Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (BPK-në) në Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës (AQBK). Nën këtë rregullore objektivat themelore të AQBK-së janë:

- Të nxisë sigurinë, aftësinë e pagimit dhe funksionimin efikas të sistemit financiar stabil të bazuar në treg, duke inkurajuar daljen e instrumenteve financiare të sigurta në treg; dhe
- Të mbështesë politikat e përgjithshme të ekonomisë në Kosovë, me synim të kontribimit në ndarjen efikase të resurseve në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur.

AQBK-ja mes tjerash, ka këto kompetenca të veçanta:

- Rekomandojë udhëzime të gjera politike Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në fushat e përgjegjësisë së saj;
- Të formulojë dhe të zbatojë masat për sistemet e marrëveshjeve mbi transaksionet e valutave vendore dhe të huaja në Kosovë dhe të mbikëqyrë dhe rregullojë pagesat;
- Të posedojë dhe veprojë me një apo me më shumë sisteme pagesash;
- Të veprojë si agjent fiskal dhe bankar për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe të ofrojë këshilla financiare sipas kërkesave të saj;
- Të mbajë depozita në valutë të huaj për bankat, Ministrinë për Ekonomi dhe Financa dhe entitetet tjera publike;
- Të sigurojë furnizim adekuat të kartëmonedhave dhe monedhave për rregullimin e transaksioneve me para të gatshme;
- Të licencojë, mbikëqyrë dhe rregullojë institucionet financiare; dhe
- Të kryejë analiza të rregullta ekonomike dhe monetare të ekonomisë së Kosovës, t'i bëjë publike rezultatet dhe t'i paraqesë propozime e masa Administratës së Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në bazë të analizave të tilla.

AQBK-ja operon në lokalet e saja në Prishtinë.

Adresa e zyrës së regjistruar të AQBK-së është si në vazhdim:

Rruga Garibaldi 33,
Prishtinë,
Kosovë.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

1. Entiteti raportues (vazhdim)

Bordi Drejtues

Bordi Drejtues përcakton politikat për aktivitetet e AQBK-së si dhe mbikëqyrë implementimin e tyre. Sipas rregullores së UNMIK-ut, Bordi Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Në përfundim të vitit, më 31 Dhjetor 2006 Bordi Drejtues i AQBK-së përbëhej nga anëtarët si në vijim:

- Z. Ajri Begu, Kryetar i Bordit Drejtues të AQBK-së, drejtor jo-ekzekutiv
- Z. Michel Svetchine, Drejtor i Përgjithshëm i AQBK-së,
- Znj. Chiara Bronchi, drejtor jo-ekzekutiv,
- Z. Gazmend Luboteni, drejtor jo-ekzekutiv
- Z. Lulzim Ismaili, drejtor jo-ekzekutiv

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklaratë e zbatueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas bazës së kostos historike.

(c) Valuta funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë të paraqitura në euro ("EUR"), që është valutë funksionale e AQBK-së. Përveç nëse paraqitet ndryshe, informatat financiare të paraqitura në euro janë rrumbullakësuar në mijë euro.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat afektojnë aplikimin e politikave dhe vlerave të raportuara të aseteve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen vazhdimisht. Revizionet e vlerësimeve të kontabilitetit njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është reviduar dhe në secilën periudhë të ardhshme të afektuar.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

(e) (d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Në veçanti, informatat mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurt dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit që kanë ndikim më të madh në shumën e pranuar në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 4.

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit

Politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë periudhave të paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet me valuta të huaja janë konvertuar në valutë funksionale sipas kursit këmbimor të asaj date. Asetet dhe detyrimet monetare të vlerësuara sipas valutave të huaja në datën e raportimit janë rikonvertuar në valutën funksionale sipas kursit këmbimor të asaj date. Fitimi apo humbja në zërat monetar është ndryshimi në mes të shpenzimit të amortizuar në valutën funksionale në fillim të periudhës, i rregulluar sipas interesit efektiv dhe pagesave gjatë asaj periudhe, dhe shpenzimi i amortizuar i konvertuar në valutën e huaj sipas kursit këmbimor në fund të periudhës. Asetet dhe detyrimet jo-monetare të denominuara në valuta të huaja të matura në vlerën reale janë rikonvertuar në valutën funksionale sipas kursit këmbimor të asaj date kur është caktuar vlerësimi i drejtë. Ndryshimet në valutë të huaj që ngriten pas rikonvertimit cilësohen si fitim apo humbje.

(b) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi paraqiten në pasqyrat e të ardhurave me anë të metodës së interesit efektiv. Shkalla e interesit efektiv është shkalla e cila saktësisht skanton pagesat dhe prurjet e ardhshme në të gatshme të vlerësuara sipas jetëgjatësisë së parashikuar të aseteve apo detyrimeve financiare (apo kur është e mundur, për një periudhë më të shkurtër) tek shumat e bartura të aseteve apo detyrimeve financiare. Shkalla e interesit efektiv është e përcaktuar në njohjen fillestare të mjeteve dhe detyrimeve financiare dhe nuk rishikohet më vonë.

Kalkulimi i shkallës së interesit efektiv përfshinë të gjitha tarifat dhe pikët e paguara apo të pranuar, shpenzimet e transaksionit, si dhe skontot apo premiumet që janë pjesë integrale e shkallës së interesit efektiv. Shpenzimet e transaksionit janë shpenzime që rriten dhe drejtpërdrejt i atribuohen përvetësimit, lëshimit ose disponimit me një aset apo detyrim financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrat e të ardhurave përfshijnë:

- Interesin mbi asetet dhe detyrimet financiare sipas shpenzimit të amortizuar në bazë të shkallës së interesit efektiv.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(c) Tarifat dhe komisioni

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisioni që janë përbërës të shkallës së interesit efektiv të asetëve apo detyrimeve financiare janë të përfshira në matjen e shkallës së interesit efektiv.

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet tjera, duke përfshirë tarifën e transakcionit për llogaritë operative, transferet e fondeve dhe tarifave të licencimit janë të pranuar sipas pëmbushjes së shërbimeve të ndërlidhura.

Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet tjera ndërlidhen kryesisht me tarifën e transakcioneve dhe shërbimeve, të cilat shpenzohen me pranimin e shërbimit.

(d) Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative pranohen në momentin kur ndodhin.

(e) Beneficionet e punëtorëve

(i) Planet e kontributit të definuar

AQBK-ja jep kontributet e detyrueshme të sigurimit social që sigurojnë beneficione pensionale për punëtorët pas pensionimit të tyre. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për sigurimin e pragut minimal legal për pensionet në Kosovë sipas planit të definuar për kontribute pensionale. Kontributet e AQBK-së në planin e beneficioneve pensional zbatohen në pasqyrat e të ardhurave sipas ndodhjes së tyre.

Për më tepër, AQBK-ja pranon kontributin fiks të paguar në fondin e veçantë pensional që mirëmbahet nga AQBK-ja. AQBK-ja nuk ka obligim ligjor apo konstruktiv për të paguar kontribute tjera.

(ii) Beneficionet afatshkurtëra

Obligimet përfituese afatshkurtëra të punëtorit maten në baza jo-të skontuara dhe paguhen me rastin e ofrimit të shërbimit përkatës.

Provizioni pranohet për shumën që pritet të paguhet sipas bonusit në para të gatshme apo planeve fitim-ndarëse, nëse AQBK-ja aktualisht ka obligim konstruktiv apo ligjor për t'a paguar këtë shumë si rezultat i shërbimit të mëparshëm të ofruar nga punëtori dhe kur obligimi mund të llogaritet besueshmërisht.

(f) Tatimi dhe alokimi i profitit

AQBK-ja është e përfshirë nga tatimi në të ardhura, në pajtim me rregulloren e UNMIK-ut 1999/20 të lëshuar më 15 nëntor 1999 (të ndryshuar më 1 tetor 2001) "Mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës" të zëvendësuar me Rregulloren e re të UNMIK-ut 2006/47 të lëshuar më 24 gusht 2006 "Mbi Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës" ku kërkohet me ligj që të paguaj çfardo bilanci të të ardhurave në neto drejtpërdrejt në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave pas alokimit për plotësimin e nivelit të fondit të rezervave, drejtpërdrejt nga Bordi Udhëheqës.

(g) Asetet dhe detyrimet financiare

(i) Pranimi

AQBK-ja fillimisht i pranon depozitet sipas datës së zanafillës. Të gjitha asetet dhe detyrimet tjera financiare fillimisht pranohen në datën e këmbimit me ç'rast AQBK-ja bëhet palë e provizionit të kontraktuar për instrumentin.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(g) Asetet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(ii) Mospranimi

AQBK nuk e pranon asetin financiar në rast të skadimit të drejtave kontraktuese për fluksin e parave të gatshme të aseteve, apo në rast të transferimit të të drejtave për pranimin e fluksit të parave të gatshme të kontraktuar të asetit financiar në një transaksion në të cilin në mënyrë substanciale të gjitha rreziqet dhe shpërblimet prej pronësisë së asetit financiar janë të transferuara. Çfardo interesi në asetet financiare të transferuara që janë krijuar apo mbajtur nga AQBK-ja është i pranuar si aset apo detyrim i ndarë.

AQBK nuk e pranon detyrimin financiar në rast se i janë hequr, anuluar apo kanë skaduar obligimet kontraktuese.

(iii) Shlyerja

Asetet dhe detyrimet financiare konsiderohen të shlyera dhe neto shuma paraqitet në raportin e bilancit, atëherë dhe vetëm atëherë kur AQBK-ja ka të drejtë ligjore të shlyej dhe synon ose t'a sistemoj në bazë të netos ose ta marrë në konsiderim asetin dhe ta sistemoj detyrimin në të njëjtën kohë.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë të netos vetëm nëse lejohet sipas standardeve të kontabilitetit, apo për fitimet dhe humbjet që dalin nga një grup i transaksioneve të ngjashme.

(iv) Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e asetit apo detyrimit financiar është shuma sipas të cilës matet aseti apo detyrimi financiar gjatë pranimit fillestar, minus ripagesat kryesore, plus apo minus amortizimi kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv të secilit ndryshim në mes të shumës fillestare të pranuar dhe shumës së maturitetit, minus secila zbritje për dëm.

(v) Matja e vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerave të drejta të aseteve financiare dhe detyrimeve financiare arritet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknikat e neto vlerës ekzistuese, metodën e fluksit të "cash"-it të zbritur, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmimet e caktuara të tregut, si dhe modelet e vlerësimit. AQBK-ja përdorë metodat e mirënjohura të vlerësimit për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare më të zakonshme dhe më të thjeshta. Për këto instrumente financiare, inputet në modele janë të observueshme nga pikëpamja e tregut.

(vi) Identifikimi dhe matja e dëmit

Nëse ka evidencë të vlefshme, AQBK-ja vlerëson në çdo datë bilanci se a është dëmtuar një aset financiar jo i realizuar në vlerë reale përmes fitimit ose humbjes. Asetet financiare janë të dëmtuara nëse evidenca objektive demonstroi se një ndodhi humbjeje është shfaqur pas njohjes iniciale të asetit dhe se ndodhja e humbjes ka një ndikim në fluksin e ardhshëm të parasë së gatshme nga aseti i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(g) Asetet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vi) Identifikimi dhe matja e dëmit (vazhdim)

Evidenca e vlefshme që një aset financiar ka pësuar humbje përfshinë dështimin ose delikucencën nga ana e huamarrësit, ristrukturimin e plasmanit ose avansit nga ana e AQBK-së në kuptimin që AQBK-ja në të kundërtën nuk do ta konsideronte, indikacionet që huamarrësi apo emetuesi mund të bankrotojnë; zhdukjen e tregut aktiv për atë aset financiar, apo të dhëna tjera të observueshme që ndërlidhen me një grup të aseteve siç janë ndryshimet e pafavorshme në statusin pagues në AQBK, të huamarrësit apo emetuesit, ose shkaqe ekonomike që ndërlidhen me dështimin përbrenda grupit.

Humbjet shfaqen në fitim apo humbje dhe reflektohen në llogarinë e lejimeve kundrejt plasmaneve dhe avanseve.

Kur një ngjarë pasuese shkakton rënien e shumës së dëmit, humbja e dëmit rikthehet nëpërmes të fitimit dhe humbjes.

(vii) Përcaktimi në vlerë reale nëpërmes të fitimit dhe humbjes

AQBK-ja ka përcaktuar asetet dhe detyrimet financiare tek vlera reale nëpërmes të fitimit apo humbjes, kur ose:

- Asetet dhe detyrimet menaxhohen, vlerësohen dhe raportohen së brendshmi në baza të vlerësimit të drejtë;
- Përcaktimi eliminon ose redukton në mënyrë të dukshme një mospërputhje kontabiliteti, e cila në të kundërtën do të rritej, ose
- Aseti apo detyrimi përmbanë një derivativë fikse që në mënyrë të dukshme modifikon fluksin e "cash"-it që pëmdryshe do të kërkohej me anë të kontratës.

Asetet financiare që janë përcaktuar tek vlera e drejtë nëpërmes të fitimit apo humbjes përfshijnë bonot e thesarit në pasqyrat financiare të vitit 2005.

(h) "Cash"-i dhe ekuivalentët e "cash"-it

"Cash"-i dhe ekuivalentët e "cash"-it përfshijnë paratë *cash në dorë*, depozitat bankare dhe asetet financiare likuide të larta me maturitete origjinale më pak se tre muaj, të cilat janë subjekt i një rreziku të vogël për vlerat e tyre të drejta, dhe përdoren nga ana e AQBK-së për zotimet afatshkurta.

"Cash"-i dhe ekuivalentët e "cash"-it barten në koston e amortizuar në raportin e bilancit.

(i) Investimet e letrave me vlerë

Investimet e letrave me vlerë fillimisht maten sipas vlerës së drejtë plus kostoja e transaksioneve direkte në rritje që mëpastaj llogariten si të - mbajtura - në - maturitet.

(ii) Të mbajtur në maturitet

Investimet e mbajtura - në - maturitet janë mjete joderivative me pagesa fikse apo të përcaktuara dhe maturitet fiks që AQBK-ja ka për qëllim pozitiv dhe aftësi për të mbajtur maturitetin, dhe të cilat nuk janë të përcaktuara me vlerë reale nëpërmes të fitimit, humbjes apo në dispozicion-për - shitje.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(i) Investimet e letrave me vlerë (vazhdim)

(i) Të mbajtura në maturitet (vazhdim)

Investimet e mbajtura në maturitet barten në koston e amortizuar duke përdorur metodën e intersit efektiv. Çfardo shitje apo riklasifikim i një shume të caktuar të investimeve të mbajtura në maturitet jo afë maturitetit të tyre do të rezultojnë në riklasifikimin e të gjitha investimeve të mbajtura në maturitet si të disponueshme-për-shitje, dhe do të parandalojë AQBK-në nga klasifikimi i investimit të letrave me vlerë si të mbajtura në maturitet për vitin financiar aktual dhe dy vitet e ardhshme.

(j) Prona dhe pajisjet

(i) Identifikimi dhe matja

Prona dhe pajisjet shprehen në koston minus zhvlerësimin e akumuluar dhe dëmtimet ose humbjet. Kostoja përfshinë shpenzimet që drejtpërdrejt i atribuohen blerjes së asetit. Kostoja e aseteve të vetë-konstruara përfshinë koston e materialit dhe punën direkte, si dhe kostot tjera për të sjellë atë aset në gjendje funksionale të përdorimit të qëllimshëm si dhe shpenzimet tjera të çmontimit dhe zhvendosjes së sendeve si dhe rregullimin e vendit në të cilin janë të vendosura. Softueri i blerë i cili është i integruar në funksionalitetin e pajisjes përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj pajisje.

Kur pjesë të një sendi pronësie ose pajisje kanë jetesë të dobishme të ndryshme ekonomike, ato llogariten si sende të ndara (komponenta kryesore) nga prona dhe pajisjet.

(ii) Çmimet vijuese

Kosto e zhvendosjes së një pjese të një sendi prone ose pajisje njihet në shumën e bartur të sendit nëse ekzistojnë gjasat që dobitë e ardhshme ekonomike të vendosura brenda pjesës do të rrjedhin në AQBK si dhe nëse kostoja e tij mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostoja servisuere ditore e pronës dhe pajisjes njihet në fitimin ose humbjen e realizuar.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në fitimin ose humbjen mbi bazën lineare të vlerësimit të jetesës së dobishme ekonomike të çdo pjese të një sendi të pronës dhe pajisjeve.

Vlerësimi i jetesës së dobishme ekonomike për periudhat aktuale dhe krahasuese është si në vijim:

	2006	2005
• Mjetet e transportit	5 vite	5 vite
• Pajisje zyre dhe të tjera	5 vite	5 vite
• Pajisjet kompjuteri	3 vite	3 vite

Metodat e amortizimit, jetëgjatësia dhe vlerat reziduale rivlerësohen në datën e raportimit.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (në vazhdim)

(k) Mjete të patrupëzuara

Softueri i blerë nga AQBK-ja është pasqyruar në koston e zvogëluar për vlerën e akumuluar të amortizimit dhe humbjeve nga zhvlerësimi.

Shpenzimi pasues mbi mjetin e softuerit kapitalizohet vetëm kur rriten përfitimet e ardhshme ekonomike të përmbledhura në mjetin specifike të lidhur me të. Të gjitha shpenzimet tjera shënohen ashtu si ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje mbi vijën lineare të jetëgjatësisë së softuerit, nga data kur është në dispozicion për përdorim. Jetëgjatësia e softuerit është vlerësuar si tre vite (2005: 3 vite).

(k) Zhvlerësimi (dëmtimi) i mjeteve jo financiare

Shumat bartëse të mjeteve jo financiare të AQBK-së rishikohen në çdo datë të raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë shenjë të dëmtimit. Nëse ekziston një shenjë e tillë atëherë bëhet vlerësimi i shumës së ri-kthyeshme të mjeteve.

Një humbje zhvlerësimi njihet nëse shumata bartëse e një mjeti ose e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon shumën e ri-kthyeshme të saj. Njësia e gjenerimit të parasë është grupi më i vogël i mjeteve të identifikueshme i cili gjeneron flukse të parasë të cilat janë të pavarura prej asetëve tjera dhe grupeve tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitimin ose humbjen. Humbjet nga zhvlerësimi të lidhura me njësitë e gjenerimit të parasë janë të shpërndara me qëllim zvogëlimi të shumës bartëse të mjeteve tjera në njësi (grup i njësive) mbi bazën *pro rata*.

Shuma e ri-kthyeshme e një mjeti apo njësie të gjenerimit të parasë është më e madhe se vlera e saj përdoruese dhe vlera e saj reale e minusuar për koston e shitjes. Në vlerësimin e vlerës përdoruese, flukset e ardhshme të vlerësuar të parasë skontojnë deri në vlerën e tyre prezente duke përdorur normën e skontimit para-tatimor që reflekton vlerësimet aktuale të vlerës kohore të parasë dhe rreziqet specifike të asetit.

Humbjet nga zhvlerësimi të pranuar në periudhat paraprake vlerësohen gjatë secilës date të raportimit për çfarëdo shenja që humbja është zbritur apo nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi risillet vetëm kur kemi të bëjë me ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e shumës së rekuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi risillet vetëm deri në masën kur shumata bartëse e asetit nuk tejkalon shumën bartëse e cila do të ishte përndryshe e determinuar, neto e zhvlerësimit apo amortizimit, nëse humbja nga zhvlerësimi nuk do të ishte e njohur.

(m) Depozitat dhe obligimet tjera financiare

Depozitat janë burimet e financimit të AQBK-së. Ato fillimisht matën në vlerën e tyre reale plus kostoja e transaksionit, dhe më pas maten në koston e amortizimit duke përdorë metodën efektive të interesit.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(n) Të ardhurat nga grantet

Grantet të cilat kompenzojnë shpenzimet e ndodhura të AQBK-së njihen si të ardhura në pasqyrën e të ardhurave dhe atë mbi një bazë sistematike në po të njëjtën periudhë kohore në të cilën kanë ndodhur shpenzimet. Grantet të cilat kompenzojnë AQBK-në për kosto të një asemi njihen në pasqyrën e të ardhurave si e ardhur dhe atë në baza sistematike përgjatë jetëgjatësisë së asetit.

(o) Pagat e financuar nga donatorët

Disa anëtarë të menaxhmentit të AQBK-së janë ekspertë ndërkombëtar të caktuar nga organizatat ndërkombëtare që ofrojnë mbështetje financiare AQBK-së. Veç kësaj këto organizata ndërkombëtare gjithashtu caktojnë ekspert dhe konsulent për një afat të shkurt kohor sipas nevojës. Mbështetja financiare këtyre organizatave ndërkombëtare përfshinë, por nuk kufizohet, pagimin e rrogave për këta menaxherë dhe konsulentë të emëruar. Mëqenëse kjo asistencë ndërkombëtare u paguhet direkt personave të emëruar, atëherë shtrirja e këtyre pagesave është e panjohur dhe as që është e përfshirë në këto pasqyra financiare. Kohëzgjatja e caktimit të personelit të këtij menaxhmenti nuk është krejtësisht e qartë, megjithëse është objektiv i organizatave ndërkombëtare që përfundimisht ti zëvendësojë këta të emëruar me emra nga stafi vendor.

(p) Veprimtaritë fiduciare

Në disa raste të veçanta, AQBK-ja vepron si agjent fiskal dhe agjent i pagesave për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Mjetet dhe të ardhurat të cilat rezultojnë nga këto aktivitete përjashtohen nga këto mjete financiare ku AQBK-ja vepron në kapacitet fiduciar si i emëruar ose agjent.

(q) Provigjionet

Provigjioni njihet poqëse, si rezultat i ngjarjeve të kaluara, AQBK-ja ka një detyrim aktual ose konstruktiv ligjor që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, dhe poqëse janë gjasat që do të kërkohet një derdhje e përfitimit ekonomik për të shlyer obligimin përkatës. Provigjionet përcaktohen duke zbritur fluksin e pritur të parasë sipas normës para-tatimore e cila pasqyron vlerësimet aktuale të tregut mbi vlerën kohore të parasë dhe, aty ku është e përshtatshme, rreziqet specifike ndaj detyrimit.

Një provigjion për kontrata të rënda njihet atëherë kur përfitimet e pritura të AQBK-së për t' u nxjerrë nga një kontratë janë më të ulëta se kostoja e pashmangshme për të plotësuar obligimet e saja sipas kontratës. Provigjioni matet me vlerën aktuale të kostos më të ulët të pritur nga ndërprerja e kontratës dhe koston neto të pritur në rastin e vazhimit të kontratës. Para themelimit të një provigjioni, AQBK-ja njezh çdo humbje nga zhvlerësimi i aseteve të ndërlidhura me atë kontratë.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(r) Fondi rezervë

Sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/20 (e amenduar), çdo vit AQBK-ja do të derdhë të ardhurat neto në llogarinë e rezervës së përgjithshme deri sa kapitali dhe llogaritë e rezervës së përgjithshme arrijnë në 5% të shumës totale, shumë e bilanceve të kredisë së të gjitha llogarive të mbajtura në regjistrat e AQBK-së nga llogari-mbajtësit të paraqitura në bilancin e gjendjes së AQBK-së në fundin e çdo viti financiar.

(s) Standarde dhe interpretime të reja ende jo të implementuara

Një numër i standardeve të reja, ndryshime të standardeve dhe interpretime nuk janë ende në fuqi për fundin e vitit 31 Dhjetor 2006, dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

- SNRF 7 *Instrumentat Financiar: Shpalsjet* (në fuqi nga 1 Janar 2007). Standardi do të kërkoj shpalsje të rritur lidhur me rëndësinë e instrumenteve financiare për pozitën dhe performancën e pozitës financiare të një entiteti, si dhe shpalsje cilësore dhe sasiore mbi natyrën dhe shtrirjen e rreziqeve. AQBK-ja konsideron së shpalsjet e kërkuara shtesë të rëndësishme do të lidhen me objektivat, politikat dhe proceset e menaxhimit të rrezikut financiar. AQBK-ja do të aplikoj SNRF 7 nga periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2007.
- SNK 1 *Plotësimi i SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare – Zbulimet Kapitale* (hyn në fuqi nga 1 Janar 2007). Si amendament plotësues që del nga SNRF 7 (shih më lartë), Standardi do të kërkoj shpalsje të shtuar për sa i përket kapitalit të AQBK-së. Ky amendament do të kërkojë në mënyrë sinjifikante shpalsje të mëtejme lidhur me strukturën e kapitalit të AQBK-së, AQBK-ja do të aplikoj Amandamentin e SNK 1 nga periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2007.
- SNRF 8 *Segmentet operuese* (hyn në fuqi nga 1 Janar 2009). Standardi kërkon shpalsje të segmentuar sipas komponentave të entitetit të cilat monitorohen nga menaxhmenti me rastin e marrjes së vendimeve lidhur me çështje operationale. Segmentet operuese janë komponenta të një entiteti për të cilat ekziston informatë financiare e ndarë dhe që vlerësohet rregullisht nga shefi vendimmarrës i operationeve me rastin e vendimeve për shpërndarjen e resurseve dhe vlerësimin të performancës. AQBK-ja do të aplikoj SNRF 8 nga periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2009.
- RFNKI (IFRIC) 7 *Aplikimi i Qasjes së Ripasqyrimitt* sipas SNK 29 *Raportimi Financiar në Ekonomitë me Hiper-inflacion* (hyn në fuqi për periudhat vjetore duke filluar më ose pas 1 Mars 2006). Interpretimi përmban udhëzimin mbi atë se si një entitet duhet ripasqyruar pasqyrat e tij financiare bazuar në SNK 29, në vitin e parë të identifikimit të ekzistimit të hiperinflacionit në ekonominë e valutës së tij funksionale. Interpretimi nuk është relevant për operationet e AQBK-së pasi AQBK-ja nuk ka valutë të një ekonomie hiper-inflacionare.
- RFNKI (IFRIC) 8 *Shtrirja e SNRF 2* (efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 Maj 2006). Interpretimi qartëson atë që standardi i kontabilitetit SNRF 2 i Pagesës bazuar në aksione aplikohet në aranzhmanet ku një entitet kryen pagesa bazuar në aksione me gjasë për konsideratë joadekuate ose joekzistuese. Interpretimi nuk është relevant për operationet e AQBK-së.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

3. Politika të rëndësishme të kontabilitetit (vazhdim)

(s) Standarde dhe interpretime të reja ende jo të implementuara (vazhdim)

- *RFNKI (IFRIC) 9 Ri-vlerësimi i Derivativeve të Vendosur* (efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 Qershor 2006). Interpretimi kërkon që të bëhet një rivlerësim nëse një derivat i vendosur duhet të ndahet nga kontrata themelore vetëm atëherë kur ka ndryshime në kushtet e kontratës që në mënyrë sinjifikante modifikojnë fluksin e parasë që përndryshe do të ishte kërkuar sipas kësaj kontrate. Interpretimi nuk është relevant për operacionet e AQBK-së.
- *RFNKI (IFRIC) 10 Raportimi Financiar i Përkohshëm dhe Zhvlerësimi* (efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 Nëntor 2006). Interpretimi ndalon anulimin e humbjes nga zhvlerësimi i njohur në periudhën e përkohshme të mëparshme për sa i përket "goodwill"-it, investimeve në instrumente ekuiteti ose mjete financiare të bartura sipas koston. Interpretimi nuk është relevant për operacionet e AQBK-së.
- *RFNKI (IFRIC) 11 SNRF 2 – Transaksionet Grupore dhe të Thesarit të bazuara në aksione* (efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 Mars 2007). Interpretimi kërkon rregullimin e pagesës bazuar në aksione me të cilën një entitet pranon mallrat ose shërbimet si konsideratë për instrumentet e tij të ekuitetit për t'u llogaritur si një transaksion pagese bazuar në aksione dhe i kryer me ekuitet, pavarësisht nga mënyra e fitimit të instrumentit të ekuitetit të nevojshëm. Gjithashtu ky ofron udhëzim mbi atë se, në rregullimin e pagesave bazuar në aksione - në të cilin furnizuesit e mallrave ose shërbimeve të një entiteti janë pajisur me instrument ekuiteti të entitetit amë, a duhet të llogariten për si të rregulluara bazuar në para ose si të rregulluara bazuar në ekuitet, në pasqyrat financiare të entitetit. Interpretimi nuk është relevant për operacionet e AQBK-së.
- *RFNKI (IFRIC) 12 Marrëveshjet lidhur me Shërbimet e Koncesionit* (efektive nga data 1 Janar 2008). Interpretimi ofron udhëzim për entitetet e sektorit privat mbi disa çështje të njohjes dhe matjes që rezultojnë nga kontabiliteti i rregullimit të shërbimeve të koncesionit në raport midis sektorit publik dhe privat. Interpretimi nuk është relevant për operacionet e AQBK-së.

(t) Krahasimet

Për një prezantim më të përshtatshëm të transaksioneve, klasifikimi i disa zërave në pasqyrat financiare të vitit aktual dallon nga viti i mëparshëm. Rrjedhimisht prezantimi i pasqyrave financiare të vitit paraprak është ndryshuar aty ku ishte e nevojshme.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Menaxhmenti ka diskutuar me Bordin Drejtues lidhur me zhvillimin, përzgjedhjen dhe shpalosjen e politikave dhe vlerësimeve kritike të kontabilitetit të AQBK-së, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve.

Këto shpalosje plotësojnë shpjegimin mbi menaxhimin e rreziqeve financiare (shiko shënimin 27).

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

5. Ripasqyrimi i pasqyrave financiare të viteve paraprake

AQBK-ja kishte regjistruar gabimisht pranimin e granteve shtesë në pasqyrat financiare të viteve të mëparshme dhe të ardhurat përkatëse të shtyera në shumë prej 413 mijë euro. Si rezultat mjetet dhe detyrimet më 31 Dhjetor 2005 ishin të mbivlerësuar për 413 mijë euro. Në përputhje me këtë, pPasqyrat financiare për fundvitin më 31 Dhjetor 2005 janë ripasqyruar. Në veçanti, shumat e paraqitura në pasqyrat financiare për mjetet dhe detyrimet tjera të brendshme janë zvogëluar për 413 mijë euro.

6. Paratë e gatshme

Paratë e gatshme janë denominuar si në vazhdim:

	2006	2005
EUR	11,123	24,464
USD	13	-
Gjithsej	11,136	24,464

7. Llogaritë rrjedhëse me bankat jo rezidente

Këto llogari janë mbajtur në këto banka të mëposhtme:

	2006	2005
Deutsche Bundesbank	21,967	22,788
Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG	237	2
Svenska Handelsbanken	211	33
Dresdner Bank	48	91
Commerzbank AG	17	851
Gjithsej	22,480	23,765

8. Bonot e thesarit

Bonot e thesarit janë letra me vlerë të borxhit të emetuara nga qeveritë e vendeve të Bashkimit Evropian, me maturitet prej tre deri në gjashtë muaj. Të gjitha bonot e thesarit denominohen në Euro dhe mbahen në maturitet me një normë efektive të interesit që varion nga 3.07% në 3.59% (2005: nga 2% në 2.44%). Të gjitha bonot kanë vlerësimin më gradën më të lartë të kreditit ranguar nga tri agjencitë për vlerësimin e kreditit – Standard dhe Poor's, Fitch Ratings ose Moody's.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

_(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

9. Llogaritë e depozitave në bankat jorezidente

Llogaritë e depozitave në bankat jorezidente përbehen nga:

	2006	2005
Depozitat e afatizuar		
Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG	69,818	33,500
Svenska Handelsbanken	53,400	36,000
HBOS Treasury Service Plc	50,368	29,342
ING Banka	49,646	33,644
Dresdner Banka	46,300	15,400
Deutsche Bundesbanka	45,000	5,000
KBC	44,612	21,486
Rabobank	21,680	8,334
Danske Bank	14,639	7,277
Commerzbank AG	7,100	500
	402,563	190,483
Kamata e akumuluar nga depozitat e afatizuar		
Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG	75	7
Svenska Handelsbanken	279	21
HBOS Treasury Service Plc	243	60
ING Banka	278	19
Dresdner Banka	190	11
Deutsche Bundesbanka	72	2
KBC	165	12
Rabobank	146	10
Danske Banka	6	8
Commerzbank AG	8	-
	1,462	150
Gjithsej	404,025	190,633

Depozitat e vendosura në bankat jorezidente denominohen në Euro dhe fitojnë interes me një normë efektive të interesit që varion nga 3.16% në 3.79% (2005:ndërmjet 1.95% dhe 2.4%) dhe kanë maturitete origjinale prej 7 deri 367 ditë (2005: prej 4 deri 186 ditë).

Autoriteti Qendrore Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

10. Prona dhe pajisjet

				Asete	
	Pajisjet	Komputerët	Automjetet	në ndërtim	Totali
Kosto					
Bilanci më 1 Janar 2005	469	608	99	112	1,288
Blerjet	-	116	-	137	253
Shlyerjet	-	(436)	-	-	(436)
Transfertat	-	-	-	(188)	(188)
Bilanci më 31 Dhjetor 2005	469	288	99	61	917
Bilanci më 1 Janar 2006	469	288	99	61	917
Blerjet	-	63	27	980	1,070
Shlyerjet	-	-	(39)	-	(39)
Bilanci më 31 Dhjetor 2006	469	351	87	1,041	1,948
Zhvlerësimi					
Bilanci më 1 Janar 2005	253	555	53	-	861
Zhvlerësimi për periudhën	84	60	19	-	163
Shlyerjet	-	(436)	-	-	(436)
Bilanci më 31 Dhjetor 2005	337	179	72	-	588
Bilanci më 1 Janar 2006	337	179	72	-	588
Zhvlerësimi për periudhën	68	50	19	-	137
Shlyerjet	-	-	(39)	-	(39)
Bilanci më 31 Dhjetor 2006	405	229	52	-	686
Shumat bartëse					
Bilanci më 1 Janar 2005	216	53	46	112	427
Bilanci më 31 /12/ 2005	132	109	27	61	329
Bilanci më 31 /12/ 2006	64	122	35	1,041	1,262

Mjetet në ndërtim lidhen më përmirësimin e sigurisë në ndërtesën ku AQBK-ja ushtron veprimtarinë e saj. Sipas nenit tre të Rregullores së UNMIK-ut 2006/47, Rregullorja Nr. 2006/47 mbi Autoritetin Qendrore Bankar të Kosovës, AQBK-ja mundet për qëllim të biznesit të saj zyrtar të përdor dhe administroj në emër të Misionit të Përkohshëm Të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) pronën dhe ndërtesën, përfshirë edhe pronën e luajtshme dhe të paluajtshme, të vendosur në Rrugën Garibaldi 33, Prishtinë-Kosovë, e cila më herët është përdorur nga Shërbimi i Kontabilitetit Shoqëror të Kosovës. Nuk ka mjete të zotuar – pengu si kolateral më 31 Dhjetor 2006 (2005: asnjë).

Autoriteti Qendrore Bankar i Kosovës**Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare**

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

11. Mjete të patrupëzuara

	<u>Softuer</u>
Kosto	
Bilanci më 1 Janar 2005	691
Blerjet	85
Shlyerjet	-
Transfertat	<u>45</u>
Bilanci më 31 Dhjetor 2005	<u>821</u>
Bilanci më 1 Janar 2006	821
Blerjet	22
Shlyerjet	-
Transfertat	<u>102</u>
Bilanci më 31 Dhjetor 2006	<u>945</u>
Amortizimi	
Bilanci më 1 Janar 2005	452
Amortizimi për periudhë	204
Shlyerjet	<u>-</u>
Bilanci më 31 Dhjetor 2005	<u>656</u>
Bilanci më 1 Janar 2006	656
Amortizimi për periudhë	145
Shlyerjet	<u>-</u>
Bilanci më 31 Dhjetor 2006	<u>801</u>
Shumat bartëse	
Bilanci më 1 Janar 2005	<u>239</u>
Bilanci më 31 Dhjetor 2005	<u>165</u>
Bilanci më 31 Dhjetor 2006	<u>144</u>

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

12. Mjete të tjera

	2006	2005
Të ardhura të përlogaritura nga provigjionet	159	335
Llogari për t'u arkëtuar dhe parapagesa	18	42
Gjithsej	177	377

Të ardhurat e përlogaritura nga provigjionet paraqesin provigjionin e vlerësuar për përtëritjen e licencës nga institucionet financiare vendore.

13. Detyrimet ndaj bankave vendore

Sipas Rregullës XVII të Rregullores mbikëqyrëse të AQBK-së, bankat komerciale të cilat veprojnë në Kosovë kërkohet që të mirëmbajnë një rezervë të likuiditetit në shumë prej 10% të gjithsej depozitave të klientëve të tyre. Së paku gjysma nga këto bilance të rezervave duhet të mbahen në llogaritë e AQBK-së

Bilanci i rezervës në tepricë nga 5%, deri në 10%, të gjithsej depozitave të klientëve sillte interes prej 2.25% më 31 Dhjetor 2006 (31 Dhjetor 2005: 1%). Shumat nën 5% dhe mbi 10% nuk janë interes prurëse.

	2006	2005
Pro Credit Bank Kosovë	19,039	11,812
Raiffeisen Bank Kosovë	15,232	7,833
Kasabank	5,105	4,875
Banka e Re e Kosovës	2,270	2,455
Banka Ekonomike e Prishtinës	2,030	1,818
Banka për Biznes	1,650	2,108
Banka Kreditore e Prishtinës	-	1,281
Gjithsej rezerva të detyrueshme likuiditeti	45,326	32,182
Pro Credit Bank Kosovë	5,354	14,627
Raiffeisen Bank Kosovë	11,225	7,864
Kasabank	12,133	12,723
Banka e re e Kosovës	4,840	4,461
Banka Ekonomike e Prishtinës	4,008	4,905
Banka për Biznes	6,487	3,362
Banka Kreditore e Prishtinës	99	2,394
Banka Kombëtare Tregtare e Shqipërisë	5,005	
Gjithsej llogaritë rrjedhëse	49,151	50,336
Gjithsej	94,477	82,518

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

14. Detyrimet ndaj institucioneve vendore qeveritare

Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare përfshijnë llogaritë rrjedhëse nga si më poshtë:

	2006	2005
Agjencia Kosovare e Mirëbesimit	275,022	113,132
Ministria për Ekonomi dhe Financa	200,049	113,013
Institucione tjera qeveritare	578	647
UNMIK-u	172	3,099
Gjithsej	475,821	229,891

Norma efektive e interesit për llogaritë rrjedhëse më 31 Dhjetor 2006 është 2.25% (31 Dhjetor 2005: 1%)

15. Detyrimet ndaj entiteteve publike dhe tregtare

Detyrimet ndaj entiteteve publike dhe tregtare përfshijnë llogaritë rrjedhëse dhe depozitat e afatizuar nga si më poshtë:

	2006	2005
Llogaritë rrjedhëse		
Kompanitë e sigurimeve	18,525	18,218
Korporatat e Shërbimeve Publike	10,369	37,584
Fondet e Pensioneve	8,167	4,222
Te tjera	18	2
	37,079	60,026
Depozitat e afatizuar		
Kompanitë e sigurimeve	2,025	-
Fondet e Pensioneve	5,972	4,100
	7,997	4,100
Gjithsej	45,076	64,126

Norma efektive e interesit për llogaritë rrjedhëse më 31 Dhjetor 2006 është 2.25% (31 Dhjetor 2005: 1%) dhe për depozitat e afatizuar varion nga 2.56% në 3.39% më 31 Dhjetor 2006 (31 Dhjetor 2005: 1.83%).

16. Detyrimet tjera vendore

	2006	2005
Detyrimet ndaj Qeverisë së Kosovës	1,636	1,697
Të ardhurat e shtyra nga grantet	301	383
Detyrimet ndaj ish Bankës Popullore të Kosovës	467	450
Kreditorët dhe përlllogaritjet e ndryshme	218	180
Detyrime të tjera vendore	36	35
Gjithsej	2,658	2,745

Bilanci i detyrimeve ndaj Qeverisë së Kosovës më 31 Dhjetor 2006 i referohet shumës prej 1,038 mijë euro (2005: 1,285 mijë euro) të qirasë së mbledhur për ndërtesat publike deri në themelimin e pronësisë dhe 598 mijë euro (2005: 408 mijë euro) të ndëshkimeve mbikëqyrëse të mbledhura prej institucioneve financiare që nga 24 Prill 2002 dhe interesi përkatës i përlllogaritur në përfundim të këtyre datave.

Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Shënime të bashkangjitura pasqyrave financiare

(Vlerat janë në 000 EUR, nëse nuk ceket ndryshe)

16. Detyrimet tjera vendore (vazhdim)

Detyrimet ndaj ish Bankës Popullore të Kosovës dalin nga këto në vazhdim. Në fillim, AQBK-ja kishte trashëguar shuma specifike në para, në valuta të ndryshme, nga ish Banka Popullore e Kosovës. Në këtë bilanc është përfshirë gjithashtu edhe interesi i akumuluar gjatë viteve që nga 5 Janar 2004. Paraja fillimisht është konvertuar në 872 mijë DEM më 22 Dhjetor 2000 dhe me pas është transferuar fizikisht dhe depozituar në llogarinë e AQBK-së në bankën Commerzbank AG në Frankfurt. Bilanci i llogarisë më 1 Janar 2002 është konvertuar në 446 mijë euro dhe si rezultat bilanci më 31 Dhjetor 2006 dhe 31 Dhjetor 2005 përfshinë bilancin me interesin e përlllogaritur në përfundim të këtyre datave.

Lëvizja në të ardhurat e shtyera nga grantet ka qenë si në vazhdim:

	Autoriteti Qendror Fiskal	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar	Të tjera	Gjithsej
Të ardhurat e shtyera nga grantet më 1 Janar 2005	386	26	58	470
Grantet e pranuar gjatë vitit	-	-	112	112
Të hyrat nga grantet për vitin	(164)	(26)	(9)	(199)
Të ardhurat e shtyera nga grantet më 31 Dhjetor 2006	222	-	161	383
Të ardhurat e shtyera nga grantet më 1 Janar 2006	222	-	161	383
Grantet e pranuar gjatë vitit	-	-	42	42
Të hyrat nga grantet për vitin	(73)	-	(51)	(124)
Të ardhurat e shtyera nga grantet më 31 Dhjetor 2006	149	-	152	301

17. Fondi statutor

Fondi statutor fillestar i AQBK-së në shumë prej 5,000 mijë DEM (2,556 mijë Euro) është kontribuar nga Autoriteti Qendror Fiskal më 31 Mars 2000. Më 8 Qershor 2004, në bazë të vendimit të ZPSSP-së (Zëvendës Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm) të Shtyllës së IV-të, fondi statutor është rritur nga 2,556 mijë euro në 10,000 mijë euro. AQBK-ja i raporton drejtpërdrejt Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

18. Fondi i rezervave

Fondi i rezervave u krijua gjatë periudhës deri më 31 Dhjetor 2006, në përputhje me Rregulloren 1999/20 të zëvendësuar me Rregulloren 2006/47 të datës 24 Gusht 2006 dhe me vendimin e Bordit Drejtues të AQBK-së. I gjithë neto fitimi për vitin 2005 ishte transferuar në fondin e rezervave. Sa i përket vitit 2006, vendimi nuk është marrë ende, por pasi që rezervat janë nën kufirin e përcaktuar në rregullore, atëherë i gjithë fitimi për vitin do të transferohet në fondin e rezervave.

Në vitin 2006, AQBK-ja i ka paguar Ministrisë për Ekonomi dhe Financa një shumë prej 785 mijë euro (2005: 382 mijë euro), që përfaqëson tepicën mbi kufirin e fondit të rezervave të saj i përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/20, të aprovuar më 15 Nëntor 1999 (e amenduar më 1 Tetor 2001) “mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës”.

19. Te ardhurat neto nga interesi

Të ardhurat neto nga interesi përbëhen si në vazhdim:

	2006	2005
Te ardhurat nga interesi		
Nga plasmanet e periudhave fikse	9,493	3,999
Nga bonot e thesarit	5,099	3,052
Nga plasmanët e llogarive rrjedhëse (bilancet)	594	318
	15,186	7,369
Shpenzimet e interesit		
Nga depozitat e llogarive rrjedhëse të entiteteve jo bankare	8,116	3,121
Nga depozitat e bankave në llogari rrjedhëse	491	233
Nga depozitat e periudhave fikse	123	78
	8,730	3,432
Neto të ardhurat nga interesi	6,456	3,937

20. Neto të ardhurat nga tarifat dhe komisioni

Neto të ardhurat nga tarifat dhe komisioni përbëhen si në vazhdim:

	2006	2005
Të ardhurat nga tarifat		
Nga depozitat në para të gatshme	116	117
Nga transfertat e jashtme ardhëse	196	165
Nga transfertat e jashtme dalëse	291	282
Nga sistemi i kliringut ndër-bankar	127	91
Tarifa të tjera	14	50
	744	705
Shpenzimet sipas tarifave		
Për eksport/import të parave të gatshme	204	544

Për transaksione me bankat korrespondente	42	13
Tarifa të tjera	4	-
	250	557
Neto të ardhurat nga interesi	494	148

21. Të ardhurat nga grantet

Të ardhurat nga grantet përbëhen si në vazhdim:

	2006	2005
AQF	-	167
USAID-i	-	25
MEF- Banka Botërore	142	26
BE	175	250
Gjithsej	317	468

22. Të ardhura të tjera operative

Të ardhurat tjera operative përfshijnë kryesisht tarifaf të cilat u vendosen institucioneve financiare në Kosovë si rezultat i lëshimit ose ripërtëritjes së licencave si dhe tarifaf tjera statutore të lidhura më aktivitetet e tyre.

23. Shpenzimet për personelin

	2006	2005
Pagat e punonjësve	904	808
Shpenzimet e sigurimit shoqëror dhe shëndetësor	224	225
Trajnimi i personelit	86	19
Shpërblimi për Bordin Drejtues	22	22
Të tjera	18	11
Gjithsej	1,254	1,085

Numri i punonjësve të AQBK-së më 31 Dhjetor 2006 ishte 143 (31 Dhjetor 2005: 135).

24. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

	2006	2005
Shpenzimet për sigurimin	240	49
Riparimet dhe mirëmbajtja	89	23
Mirëmbajtja e softuerit	88	85
Shpenzimet e komunikimit (telefon, teleks dhe internet)	85	94
Shërbimet publike	76	83
Shpenzimet për auditim dhe konsulencë	58	203
Shpenzimet për sigurimin dhe transporti e <i>cash-it</i> (shërbimet e rojeve)	53	48
Udhëtime dhe transporte	42	102
Shpenzimet operative të automjeteve	15	17
Material për zyrë	12	25
Shpenzimet për ushqim dhe të restorantit	11	9
Shpenzimet për materiale kompjuterike	10	9

Të tjera	91	75
Gjithsej	870	822

25. Paraja *cash* dhe ekuivalentët e saj

Paraja *cash* dhe ekuivalentët e saj përbëhet si në vazhdim:

	Shënim	2006	2005
Paraja e gatshme	6	11,136	24,464
Llogaritë rrjedhëse me bankat jorezidente	7	22,480	23,765
Bonot e thesarit	8	101,616	114,665
Llogaritë depozituese me bankat jorezidente	9	373,766	185,940
Gjithsej		508,998	348,834

26. Zotimet dhe rezervimet

Ligjore

AQBK-ja është e përfshirë në procedura rutinore ligjore në drejtim të biznesit të saj të zakonshëm. Mendimi i menaxhmentit është se rezultati final i këtyre procedurave ligjore nuk do të këtë ndikim material mbi rezultatet e AQBK-së.

Zotimet lidhur me kreditë

Sipas gjendjes më 31 Dhjetor 2006, AQBK-ja kishte zotime ndaj vendosjes së depozitave në shumë gjithsej 30,916 mijë euro (31 Dhjetor 2005 15,315 mijë euro).

Zotime të tjera

Zotimet tjera përbëhen si në vazhdim:

	Jo më shumë se një vit	Më shumë se një vit por jo më shumë se pesë vite
Përmirësimi i sigurisë së ndërtesës (punimet dhe konsulenca)	941	29
Blerja e pajisjeve	51	-
Gjithsej	992	29

27. Menaxhimi i rrezikut financiar

Duke marrë parasysh natyrën e operacioneve të AQBK-së, aktivitetet e menaxhimit të rrezikut financiar kryesisht lidhen me përdorimin e instrumenteve financiare. Një instrument financiar është çdo kontratë e cila jap të drejtën për të pranuar para ose mjete tjera financiare nga një palë tjetër (mjet financiar) ose obligimi për të shpërndarë para ose mjete tjera financiare ke pala tjetër (detyrim financiar). Instrumentet financiare mund të rezultojnë në rreziqe specifike ndaj AQBK-së. Rreziqet më të rëndësishme më të cilat ballafaqohet AQBK-ja janë përmendur më poshtë.

(i) Rreziku i normës së interesit

Operacionet e AQBK-së i nënshtrohen rrezikut të ndryshimit të normës së interesit deri në atë masë që mjetet interes-fituese dhe detyrimet interes-prurëse maturojnë ose ri-çmimohen në kohë të ndryshme ose në shuma të ndryshme. AQBK-ja përpiqet të pakësoj këtë rrezik duke vëzhguar datat e ri-çmimit të mjeteve dhe detyrimeve të saj. Veç kësaj, efekti aktual do të varet nga një numër i faktorëve të tjerë, duke përfshirë edhe masën në të cilën bëhen ri-pagesat më herët ose më vonë se datat e kontraktuara dhe variacionet në ndjeshmërinë e normave të interesit brenda periudhës së ri-çmimit dhe ndërmjet valutave.

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(i) Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

(a) Informacion mbi rendimentin mesatar

Rendimentet mesatare të kategorive të rëndësishme të mjeteve dhe obligimeve financiare të AQBK-së deri më 31 Dhjetor 2006 dhe 2005 ishin si në vazhdim:

31 Dhjetor	Norma mesatare e interesit e ponderuar (në %)	
	2006	2005
Mjetet		
Llogaritë rrjedhëse me bankat jorezidente	2.75	1.08
Bonot e thesarit	3.02	2.1
Llogaritë depozituese me bankat jorezidente	<u>2.85</u>	<u>2.03</u>
Detyrimet		
Ndaj bankave vendore	2.25	1.00
Ndaj institucioneve qeveritare	2.25	1.00
Ndaj entiteteve publike dhe tregtare	2.43	1.00
Detyrime të tjera vendore	1.78	1.84

(b) Shqyrtimi i ri-çmimit të normës së interesit

Tabela në vazhdim paraqet datat e ri-çmimit të normave të interesit për mjetet dhe obligimet monetare të AQBK-së. Mjetet dhe obligimet me normë fikse janë raportuar sipas datave të përcaktuara për ri-pagimin kryesor të tyre.

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(i) Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

(b) shqyrtimi i ri-çmimit të normës së interesit (vazhdim)

2006	Deri në 1 Muaj	Deri në 3 Muaj	3-12 Muaj	1-5 vite	Jo interes prurëse	Gjithsej
Mjetet						
Paraja <i>cash</i>	-	-	-	-	11,136	11,136
Ll. rrjedh.-bankat jorezid.	22,480	-	-	-	-	22,480
Ll.depoz.- bankat jorezid.	343,035	47,807	13,183	-	-	404,025
Bonot e thesarit	39,941	61,675	101,782	-	-	203,398
Mjetet tjera	-	-	-	-	117	177
Mjetet gjithsej	405,456	109,482	114,965	-	11,313	641,216
Detyrimet						
Ndaj bankave vendore	94,477	-	-	-	-	94,477
Ndaj instit.vend.qeveri.	475,821	-	-	-	-	475,821
Ndaj entit.publike & treg.	45,076	-	-	-	-	45,076
Detyrime të tjera	-	550	1,231	-	877	2,658
Gjithsej detyrimet	615,374	550	1,231	-	877	618,032
Gepi më 31						
Dhjetor 2006	(209,918)	108,932	113,734	-	10,436	23,184
Gepi Kumulativ	(209,918)	(100,986)	12,748	12,748	23,184	

2005	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Jo interes prurëse	Gjithsej
Mjetet						
Paraja <i>cash</i>	-	-	-	-	24,464	24,464
Llogarite rrjedhëse me bankat jorezidente	23,765	-	-	-	-	23,765
Llogaritë depozituese me bankat jorezidente	190,633	-	-	-	-	190,633
Bonot e thesarit	44,943	69,722	44,604	-	-	159,269
Mjetet të tjera	-	-	-	-	377	377
Mjetet Gjithsej	259,341	69,722	44,604	-	24,841	398,508
Detyrimet						
Ndaj bankave vendore	82,518	-	-	-	-	82,518
Ndaj institucioneve vendore qeveritare	229,891	-	-	-	-	229,891
Ndaj entiteteve						

publike dhe tregtare	60,026	4,100	-	-	-	64,126
Detyrime të tjera	2,717	-	-	-	28	2,745
Detyrimet Gjithsej	375,152	4,100	-	-	28	379,280
Gepi më						
31 Dhjetor 2006	(115,811)	65,622	44,604	-	24,813	19,228
Gepi kumulativ	(115,811)	(50,189)	(5,585)	(5,585)	19,228	

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(ii) Rreziku i valutës

Rreziku i valutës është rreziku që mund të ndodhë nëse vlera e instrumenteve financiare do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e këmbimit valutor.

Përveç svlerave të papërfillshme, mjetet dhe detyrimet e AQBK-së përgjithësisht denominojnë në euro; për këtë arsye AQBK-ja nuk është me ndonjë rëndësi e ekspozuar ndaj rrezikut valutor.

(iii) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku ndaj humbjes financiare për AQBK-në nëse një palë e instrumentit financiar dështon në përmbushjen e obligimeve të saj kontraktuese, dhe kryesisht vjen nga llogaritë e AQBK-së si ato rrjedhëse ashtu edhe të, depozitave me bankat jorezidente si dhe bonot e thesarit. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut, AQBK-ja merrë në konsideratë dhe konsolidon të gjitha elementet e ekspozimit të rrezikut ndaj kredisë (siç është rreziku i dështimit individual të obliguesit, rreziku shtetëror dhe ai sipas sektorëve).

Rreziku i kredisë menaxhohet përmes miratimit të transaksioneve dhe fondeve të plasmanit, përcaktimit të limiteve të cilat kufizojnë rrezikun dhe përmes monitorimit të vazhdueshëm të gjendjeve.

Palët pranohen vetëm kur ato kanë vlerësimet më të mira lidhur me kreditin dhe nëse iu nënshtrohen inspektimeve të rregullta të kreditit.

(iv) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku me të cilin AQBK-ja mund të ballafaqohet në përmbushjen e obligimeve ndaj detyrimeve të saja financiare dhe si i tillë del nga financimi i veprimtarisë së përgjithshme të AQBK-së dhe menaxhimit të gjendjeve.

Politikat për monitorimin dhe adresimin e rrezikut të likuiditetit vendosen nga Bordi Drejtues. AQBK-ja menaxhon rrezikun e likuiditetit të saj duke investuar në depozita afat shkurtëra me bankat jorezidente. Politikat për menaxhimin e likuiditetit janë të hartuara për të siguruar që edhe në kushte të padëshiruara AQBK-ja të jetë në pozitë për të përmbushur obligimet e saja.

Departamenti i AQBK-së për Menaxhimin e Mjeteve monitoron rrezikun e likuiditetit mbi baza të vazhdueshme duke analizuar treguesit e likuiditetit, gëpin dhe skenarët ekonomik.

Tabela në vazhdim ofron një shqyrtim të mjeteve dhe obligimeve financiare të AQBK-së të vendosur në grupe përkatëse të maturitetit bazuar në periudhat e mbetura të ri-pagesës.

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(iv) Rreziku ndaj likuiditetit (vazhdim)

2006	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Gjithsej
Mjetet					
Paraja <i>cash</i>	11,136	-	-	-	11,136
Llogarite rrjedhëse me bankat jorezidente	22,480	-	-	-	22,480
Llogarite depozituese me bankat jorezidente	343,035	47,807	13,183	-	404,025
Bonot e thesarit	39,941	61,675	101,782	-	203,398
Mjete të tjera	177	-	-	-	177
Mjetet Gjithsej	416,769	109,482	114,965	-	641,216
Detyrimet					
Ndaj bankave vendore	94,477				94,477
Ndaj institucioneve qeveritare	475,821				475,821
Ndaj entiteteve publike dhe tregtare	37,108				37,108
Ndaj entiteteve publike dhe tregtare (afatizuar)	5,400	550	2,018	-	7,968
Detyrime të tjera	2,658				2,658
Gjithsej Detyrimet	615,464	550	2,018	-	618,032
Gepi më					
31 Dhjetor 2006	(198,695)	108,932	112,947	-	23,184
Gepi kumulativ	(198,695)	(89,763)	23,184	23,184	

2005	Deri ne 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	1 deri 5 vite	Totali
Mjetet					

Paraja <i>cash</i>	24,464	-	-	-	24,464
Llogaritë rrjedhëse me bankat jorezidente	23,765	-	-	-	23,765
Llogaritë depozituese me bankat jorezidente	190,633				190,633
Bonot e thesarit	44,943	69,722	44,604		159,269
Mjete të tjera	377	-	-		377
Gjithsej Mjetet	284,182	69,722	44,604		398,508
Detyrimet					
Ndaj bankave vendore	82,518	-	-		82,518
Ndaj institucioneve qeveritare	229,891	-	-		229,891
Ndaj entiteteve publike dhe tregtare	60,026	4,100	-		64,126
Detyrime të tjera	2,745	-	-		2,745
Gjithsej Detyrimet	375,180	4,100			379,280
Gepi më 31					
Dhjetor 2005	(90,988)	65,622	44,604		19,228
Gepi Kumulativ	(90,998)	(25,376)	(19,228)		19,228

28. Vlerësimi dhe shpalosja e vlerës reale

Vlerësimet e vlerës reale bazohen në instrumentet ekzistuese financiare në bilancin e gjendjes pa bërë përpjekje për të vlerësuar vlerën e biznesit të ardhshëm të anticipuar dhe vlerën e mjeteve dhe detyrimeve që nuk konsiderohet si instrumente financiare.

Bonot e thesarit

Vlera reale e vlerësuar e bono thesarit përcaktohet duke përdorur e çmimet e tregut ose kuotimet e ndërmjetësuesve/shitësve. Kur ky informacion nuk është i disponueshëm, vlera reale është vlerësuar duke përdorur fluksin e parasë të skontuar me përdorim të normave valide të interesit për instrumentet me rrezik të ngjashëm ndaj kredisë dhe maturitetit të mbetur. Vlera reale e bono thesarit më 31 Dhjetor 2006 është 203,184 mijë euro (31 Dhjetor 2005: 159,269 mijë euro).

Instrumente të tjera financiare

Kostoja e amortizuar e plasmaneve dhe depozitave me afate fikse në tregun e parasë i afrohet vlerës së tyre reale pasi ato kanë maturitete afatshkurtëra (më pak së një vit) dhe janë të konvertueshme në *cash* si dhe mund të përmbillen pa ndonjë kosto të lartë transkasioni. Gjithashtu, edhe vlera në kosto e *cash-it* dhe depozitave e plasmaneve të llogarive rrjedhëse supozohet të jetë përafërsisht e njëjtë me vlerën e tyre reale, për shkak të këmbyeshmërisë së tyre ndaj koston.

29. Transaksionet me palët e lidhura

Ashtu siç është përcaktuar në SNK 24 “Shpalosjet mbi Palët e Lidhura”, një palë e lidhur është çdo palë e cila ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtroj ndikim me rëndësi mbi palën tjetër në vendimmarrjet financiare dhe operative.

Palët e lidhura përfshijnë menaxhmentin dhe Bordin Drejtues.

Një përmbledhje e transaksioneve të palëve të lidhura në fund të vitit 31 Dhjetor 2006 dhe 2005 është si në vazhdim:

	2006	2005
Shpërblimi për Bordin Drejtues	14	16
Shpërblimi për menaxhmentin	50	30
Gjithsej	64	46

